



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:088906

Datë: 07.08.2023

Numri i dokumentit: 04560478

**PKR.nr. 233/21**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Krime të Rënda**, Trupi gjykues në përbërjet prej, Kryetarit të trupit gjykues Ngadhujim Arni dhe anëtarëve të trupit gjykyes – gjyqëtarëve profesional Medije Bytyqi dhe Agim Kuqi, me zyrtarën ligjore Kaltrina Qollaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B.B. dhe B.B. që të dy nga L., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje e parparë me nenin 179 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082), tutje (KPRK), si dhe secili veç e veç vepën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të parashikuar me nein 374 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.86/2015 të datës 12.10.2025, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur me datë 05.06.2023, në prezencën e Prokurorit të Shtetit – Departamenti për Krime të Rënda Bukuriye Gjonbalaj, si dhe të akuzuarve B.B. me mbrojtësin e tij Avokat Berat Tmava me autorizim në shkresat e lëndës, të akuzuarit B.B. me mbrojtësin e tij Avokat Skender Musa me autorizim në shkresat e lëndës, me datë 08.06.2023 publikisht shpalli, ndërsa pas kërkjes për vazhdim të afatit për përpilimin e aktgjykimit, në afatin e lejuar ligjor, me datë 07.08.2023 përpiloj këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**B.B.** i biri i R. dhe H., e gjinisë H., i lindur me datë //, në fshatin Q. Komuna e L., me vendbanim në L. rr. “Adem Jashari” i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

**I.Me** datë 14.02.2015, rreth orës 02:00, në Restorant “Agoni” në fshatin Banull të Lipjanit, duke vepruar ne tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, i akuzuari B.B. ka privuar nga jeta tani të ndjerin U.D dhe ka rrezikuar jetën e të tjerëve, në atë mënyrë që deri sa tani i ndjeri U.D. i cili ishte duke festuar bashkë me shokë lindjen e vajzës në këtë lokal, ku i ndjeri me shokët e tij kishin

konsumuar alkool dhe kishin thyer gota e shishe, fillimisht i akuzuari B.B. kishte shkuar të tavolina ku ka qëndruar tani i ndjeri Urim me shokët dhe ka kërkuar që të dalë nga lokali, ashtu që me të dalë nga dera e lokalit fillimisht i ndjeri e fton të akuzuarin B. që i njëjti të dalë jashtë tek dera dhe me të dalë i akuzuari B. tek dera, tani i ndjeri Urim e përdorë armën e tipit “Pjetro Bereta“ model 92 FS, kalibri 9x19 mm, me numër serik K187027 të cilën e ka pas brenda në xhepin e djathtë të xhaketës së tij, duke shtënë një herë në drejtim të te akuzuarit B.B., kurse i akuzuari B.B. arrin t’ia kapë xhaketën në xhep ku e kishte dorën në arme duke e ndaluar që të shtinë prapë me armë, dhe deri sa i akuzuari B.B. dhe i ndjeri Urim ishin te kapur për arme duke rënë për toke, i akuzuari B.B. B.B. me revolen e tij të tipit “Ceska Zbrojoka” model 75 e kalibrimit 9x19 mm, me numër serik 154865, në afërsi rreth një metër shtinë në drejtim të tani të ndjerit Urim katër herë, duke e goditur në pjesët vitale të trupit, me ç’rast nga plagët e marra tani i ndjeri Urim vdes në vendin e ngjarjes, ndërkaq në këtë rast i akuzuari B.B. B.B. duke vepruar në dashje eventuale rrezikohet edhe jeta e të dëmtuarit Agim Selmani, i cili është goditur me një predhë në krahun e djathtë, me ç’rast ka pësuar thyerje shumë pjesësh në kockën e krahut të djathtë si pasojë e plagës nga arma e zjarrit dhe në këtë rast i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore.

-me këtë është vërtetuar përtej çdo dyshimi, se i akuzuari B.B. B.B. ka kryer veprën penale Vrasja e rëndë, në tejkalim të mbrojtës së nevojshme, të parashikuar nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082).

**II.** Me datë 14.02.2015, i akuzuari B.B. B.B. ka mbajtur një revole të tipit “Ceska Zbrojovka model 75”, e kalibrit 9x19mm, me numër serik 154865, me një karikator dhe 11 fishekë, të kalibrit 9 mm, pa lejen e organeve kompetente e në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022, e cila armë është përdorë në datën, kohën dhe vendin sikurse është përshkruar në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi.

- me këtë veprim, i akuzuari B.B. B.B. ka kryer edhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082), tutje (KPRK).

Andaj gjykata konform neneve: 4, 7, 17, 21, 41, 45, 74, 80, 83 të KPRK-së, si dhe neneve, 360, 364 dhe 365 KPPRK-së, të njëjtin e gjykon me:

## **PËRCAKTON**

Për veprën penale nga dispozitivi i parë **(I)**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vite.

Për veprën penale nga dispozitivi i dytë **(II)**, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e katër (4) muaj.

Konform nenit 80 të KPRK-së gjykata të njëjtin e gjykon me:

### **DËNIM UNIK ME BURGIM**

Ashtu që të akuzuarin B.B. B.B., për veprat penale nga dispozitivi I dhe II, e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej **11 (njëmbëdhjetë) vite** burgim, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 15.02.2015 e deri me datën 08.06.2023, do ti llogaritet në dënimit e lartcekur me burgim.

**Obligohet** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **50.00€ (pesëdhjetë euro)**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Të dëmtuarit: Përfaqësuesit e familjes së të ndjerit U.D., si dhe i dëmtuari Agim Selmani, lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

-Konfiskohet: Arma – “ Ceska Zbrojovka” model 75 me numër serik 1548865, si dhe pistoleta “Pjetro Bereta“ model 92 FS, kalibri 9x19 mm, me numër serik K187027.

#### **I akuzuari:**

**B.B.**, i biri i R. dhe E., e gjinisë I., i lindur me datë //, në fshatin Q. K. e L., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Konform nenit 363 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të KPPRK-së,**

### **LIROHET NGA AKUZA**

#### **Sepse:**

**III.**Në bashkëkryerje, me dashje e kanë privuar nga jeta tani të ndjerin U.D. dhe kanë rrezikuar jetën e të tjerëve, në atë mënyrë që me datën 14 shkurt 2015, rreth orës 02.00, në restorantin "Agoni", në fshatin B., komuna e L.as një mosmarrëveshjeje mes tyre dhe tani të ndjerit U. i cili kishte festuar bashkë me shokë, në atë lokal ku edhe kishin konsumuar alkool, me të dalë nga dera e lokalit, të njëjtit fillimisht fjalosen e pastaj i sulmojnë tani të ndjerin U. dhe të dëmtuarin E. Q. dhe S.A , me mjete të forta dhe kondak të revoles ku tani i ndjeri e përdor armën e tij për ta evituar sulmin mirëpo i akuzuari B.B. e kap për dore, ndërsa i akuzuari B.B. me revolen e tij të tipit "Bereta",model 75, e kalibrit 9mm., me nr. serik 154865, në afërsi rreth një metër, shtinë në drejtim të tani të ndjerit katër herë në pjesë vitale të trupit me ç’rast nga plagët e marra tani i ndjeri vdes në vendin e ngjarjes, ndërkaq me këtë rast goditet edhe i dëmtuari A.S. i cili pëson lëndime të rënda trupore , ku pas kësaj të pandehurit ikin nga vendi i ngjarjes.

Me këto veprime, i akuzari i B.B., kishte për të kryer veprën penale Vrasjes e rëndë e parashikuar nga neni 179 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082).

#### **IV.**

I akuzuari B.B. po ashtu akuzohet se prej kohës së pavërtetuar e deri me datën 14.02.2015, i akuzuari B.B. , ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022 armën e tipit të panjohur.

-me këto veprime i akuzuari B.B. kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 374 paragrafi 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082).

-Pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**-Të dëmtuarit:** Përfaqësuesit e familjes së të ndjerit U.D., E.Q., S.A. dhe A.S., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

### **A r s y e t i m**

#### **Historiku i procedurës dhe pretendimet e palëve në procedurë**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të rënda, ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr.86/15 e datës 12.10.2025, ndaj të akuzuarit të akuzuarve B.B. dhe B.B. B.B. që të dy nga Lipjani, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje e paraparë me nenin 179 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi 04/L-082), tutje (KPRK), si dhe secili veç e veç vepën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të parashikuar me nenin 374 paragrafi 1 të KPRK-së

#### **Rasti në ri-gjykim.**

Kjo gjykatë fillimisht lidhur me aktakuzën e lartcekur kishte nxjerrë Aktgjykimin PKR.nr.590/15 të datës 27.11.2018, ku kishte gjetur fajtor të akuzuarit B.B. B.B. e B.B.n për të dy veprat penale të cilat u vihen në barrë. Me aktgjykimin e lartshenuar gjykata kishte dënuar të akuzuarin Besnik B.B. me denim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 viteve, ndërsa të akuzuarin B.B. me denim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 viteve.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin PAKR.nr.90/19 të datës 13.03.2019 kishte prishur aktgjykimin e gjykatës themelore dhe rastin e kishte kthyer në ri-gjykim. Gjykata e Apelit kishte gjetur një mori shkeljesh procedurale e po ashtu edhe kishte kosntatauar se gjykata gabimisht kishte vërtetuar gjendjen faktike, duke rekomanduar që të bëhet edhe një here rikonsultimi i vendit të ngjarjes ku do të jenë prezent të akuzuarit, të dëmtuarit dhe dëshmitarët okular, në mënyrë që të shiqohet pozita e gjithë se cilit pjesëmarrës e pastaj të nxjerren edhe përfundimet. Gjykata e Apelit po ashtu kishte dhënë vërejtje se pse gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë fare për bazë deklaratimet e të akuzuarve e po ashtu ka specifikuar se duhet të vërtetohet fakti se a ka shtënë i pari me armë i ndjeri pasi që edhe ai kishte armë, apo i akuzuari B.B., pasi që pa sqarimin e këtyre fakteve nuk mund të vërtetohet po që se i akuzuari B.B. B.B. veperoi me qëllim që ta privoj nga jeta tani të ndjerin U.D., apo për ta mbrojtur të akuzuarin B.B., e pastaj të

vërtetohet po që se i akuzuari B.B. e ndihmoi të akuzuarin B.B. të kryej veprën penale apo nuk kreu fare veprën penale.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin PKR.nr.99/19 të datës 24.07.2023 të akuzuarin B.B. B.B. e kishte gjetur fajtor për veprën penale Vrasje të rreme, por në tejkallim të mbrojtës së nevojshme e po ashtu fajtor për veprën penale të mbajtjes së armës pa leje dhe të njejtin e kishte gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 vite.

Sa i përket të akuzuarit B.B., i njejtin ishte liruar nga akuza për veprën penale të vrasjes së rëndë dhe ishte dënuar për veprën penale lëndimi i lehtë trupor e po ashtu ishte gjetur fajtor edhe për veprën penale të mbajtjes së armës pa leje, me ç' rast ishte dënuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite e 10 muaj burg.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin PAKR.nr.462/2020 të datës 11.03.2021 kishte prishur përsëri aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kishte kthyer në r-gjykim.

Gjykata Aelit përsëri kishte gjeur shkëlqje procedurale, por edhe vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike duke specifikuar se gjykata e shkallës së parë përsëri nuk ka arritur të nxjerrë përfundimet se kush kishte shtënë i pari me armë e as nuk kishte dhënë arsytim përkitazi me pozitën e kryesur të viktimës. Po ashtu Gjykata e Apelit vë theks të veçantë në faktin se në vendin e ngjarjes janë gjetur tri lloje të gzhøjave dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye se cilat armë në çfarë forme janë përdorur dhe këto kundërthënje pamundësojnë nxjerrjen e konkludimeve të sakta. Gjykata e Apelit ka rekomanduar gjykatën e shkallës së parë që në rigjykim të sqaroj pozitën e të dëmtuarit dhe shenjat të cilat i njejtin ka psaur në fytyrë përtej plagëve vdekjepruresë. Po ashtu është kërkuar që të determinohet se sa armë janë përdorur në vendin e ngjarjes, e pastaj përsëri në ndërlidhje me gjitha provat të kosnatohet se kush kishte shtënë i pari me armën e zjarit, pozita e secilit të përfshirë në këtë rast e pastaj të nxirren konkludimet.

### **Shqyrtimi gjyqësor – në gjykimin e tretë**

Kjo gjykatë kishte proceduar përsëri me shqyrtimin gjyqësor pasi që, gjykata e Apelit edhe një here e kishte kthyer çështjen në ri-gjykim. Gjykata kishte trajtuar tutje me seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit kishte ftuar përsëri në seancë ekspertin e forenzikës, balistikës dhe të mjekësisë ligjore për të sqaruar pikat e kërkuara nga Gjykata e Apelit. Deklarimet e tyre do të specifikohen më tutje për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi.

Në gjykimin për të tretën here radhazi, kishte ardhur edhe deri tek ndryshimi i trupit gjyqësor, për çka gjykimin kishte filluar përsëri rishtazi.

### **Fjala hyrëse e palëve**

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj hyrëse ishte deklaruar si vijon: pasi që fjalën hyrëse e kemi paraqitur nga ana e prokurorisë në seancën e më pasme un mbes në tërësi pranë asaj fjale hyrëse dhe rreth kësaj nuk kam se çka të shtoj tjetër.

Avokati Berat Tmava, mbrojtës i të akuzuarit B.B. B.B. në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: po ashtu edhe un mbes në tërësi pranë fjalës hyrëse të mëparshme të cilën e kemi dorëzuar në këtë gjykatë në formë të shkruar me datën 09.03.2022, dhe pa mëdyshje se edhe në këtë proces gjyqësor do të vërtetohet se i mbrojturi im B.B. B.B. ka kryer veprën penale Vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 12 të KPRK-se duke vepruar në mbrojtje të nevojshme e cila ka qenë

domosdoshme për te zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe te atëçastshëm ndaj vetes dhe personit tjetër pasi që karakteri mbrojtës ka qene ne proporcion me shkallen e rrezikut që ka paraqitur viktima. Ndërkaq sa i përket veprës se dyte penale Mbajtja ne kontroll pronësi dhe posedim te paautorizuar te armeve neni 366 par 1 te KPRK-se klienti im për ketë vepër që ne fillim te procedurës e ka pranuar fajësinë, dhe krejt ne fund rezervoj te drejtën që konform dispozitës se nenit 348 dhe 329 te KPPRK-se deri ne mbyllje te shqyrtimit gjyqësor varësisht nga rrjedha e procedurës po nëse është e nevojshme gjykatës do ti propozojmë edhe prova tjera.

I akuzuari B.B. B.B. në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështes në tërësi fjalën e avokatit tim.

Avokat Skender Musa në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: mbesim në tërësi pranë fjalës hyrëse nga seancat e kaluara dhe gjate këtij procesi gjyqësor do te vërtetohet që i mbrojturi im nuk ka kryer veprën penale të Vrasjes, dhe as veprën penale te ndihmës siç është shpallur fajtor si dhe nuk e ka kryer veprën penale lëndim i lehte siç e ka përcaktuar aktgjykimi i fundit. Nga ky shqyrtim gjyqësor presim që te behet ricilsimi i sakte i veprës penale siç ka kërkuar gjykata e Apelit te ndahen dispozitivat e qarte, te eliminohen shkeljet procedurale dhe ato te ligjit penal, sepse jemi te bindur se me shqyrtimin edhe te mëhershëm te provave materiale dhe personale ne mënyre analitike dhe profesionale do te vërtetohet se B.B. fare nuk është dashur te jete ne bankën e te akuzuarit por është dashur te trajtohet si pale e dëmtuar pasi që viktima ka shtëne i pari për te vrare B.B.in.

I akuzuari B.B. në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e mbështes ne tërësi fjalën e avokatit tim.

#### Procedimi i provave personale

Tutje gjykata edhe njëherë do të përmbledhë deklaratat e gjithë dëshmitarëve dhe eksperteve për gjatë seancave të mbajtura marr parasysh faktin se për shkak vështirësive për ti siguruar të njëjtit dhe për shkak të ekonomizimit të procedurës, pas propozimit të të gjitha palëve në procedurë gjykata kishte lexuar deklaratat e të njëjtëve.

Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar A.D., njëherit vëllai i tani të ndjerit U.D., në deklarinimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: natën kritike nuk kam qenë prezent në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur ngjarja, por kam qenë në dijeni se vëllai im tani i ndjeri U. ka shkuar në restorantin “Agoni”, të festojë me shokë lindjen e vajzës së tij pas tetë viteve martesë dhe se për vrasjen e kam kuptuar të nesërmen nga familjarët. Ka shtuar se vëllai i tij U. ka qenë mirë i pranuar në familje dhe rrethin e tij social. I ndjeri kurrë nuk ka pasur armë dhe përveç plagëve nga predhat, ka pasur edhe prerje me mjet të mprehtë thike në anën e djathtë.

I dëmtuari E.Q., në cilësinë e dëshmitarit, në deklarinimet e tij në mes tjerash kishte përshkruar ngjarjen deri tek vrasja, ku ka theksuar se mbrëmjen kritike, para se të shkonin në restorantin “Agoni” kanë qëndruar në një kafiteri në lagjen e Muhaxherve në Prishtinë e me pas rreth orës 24, së bashku me tani të ndjerin Urim dhe disa shokë me qëllim që të festojnë lindjen e vajzës së të ndjerit Urim kanë shkuar në Restorantin “Agoni” ku kishte muzike dhe se në tavolinën e tyre është konsumuar alkool dhe me sa i kujtohet është thyer vetëm një gotë apo shishe dhe aty rreth orës 01:00 pas mesnate, e ka parë të akuzuarin B.B., që kishte shkuar tek tavolina e tyre, pasi që i dëmtuari E. ishte në banjo dhe pasi që është kthyer, e ka dëgjuar të akuzuarin B.B. që i ka thënë te ndjerit Urim : “paguani faturën dhe dilni jashtë”, dhe kur vet e ka pyetur se a është gjithçka në rregull? i akuzuari B.B. i është përgjigjur “Po”. Pastaj ka filluar të dalë nga lokali me

tani të ndjerin Urim dhe me pronarët tani të akuzuarit B.B. dhe B.B., (por ka theksuar se të akuzuarin B.B. nuk e ka njohur më parë) dhe posa kanë dalë në derë, është dëgjuar krisma e armëve dhe i dëmtuari E. në atë moment e ka kapur kokën me të dy duart dhe nuk e di a ka shtënë i ndjeri Urim apo të akuzuarit B.B. ose B.B.i, por ka theksuar se ky i fundit e ka goditur me kondak të revoles dy herë në kokë dhe ja ka parë në dorë revolen të akuzuarit B.B.. I dëmtuari E. ka theksuar se ka dalur i pari nga lokali kurse pas tij ishte tani i ndjeri U. dhe në pushimoren e parë të shkallëve, i ka dëgjuar të shtënat me armë dhe ka shtuar se e ka parë kur i akuzuari B.B. B.B. e ka shtyrë me dorë të ndjerin Urim, i cili nuk e kishte provokuar diçka që të veprojë në atë mënyrë edhe pse i ndjeri dorën e djathtë e ka pasur në xhep të jaknes. Po ashtu edhe me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes, të dt. 12.06.2020, për dallim nga deklarata e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ka theksuar se duke dalur jashtë lokalit, ka dëgjuar dy krisma, e që në shqyrtimin gjyqësor nuk ka saktësuar numrin e krismave që ka dëgjuar, ku pas kësaj kishte marrë goditje në kokë me revole nga i akuzuari B.B., e që në shqyrtimin gjyqësor kishte deklaruar se i akuzuari B.B., e kishte goditur dy herë në kokë me revole me ngjyrë të bardhë, e që pas kësaj goditje nuk i kujtohet se çfarë kishte ndodhur më pas dhe vetëm në mëngjes ka kuptuar se i ndjeri U. kishte vdekur. Po ashtu në rikonstruimin e vendit të ngjarjes ka deklaruar se nuk ka parë asgjë tjetër dhe se nuk e din kush nga të pranishmit ka shtënë me armë e po ashtu nuk ka përmendur fare se ka parë ndonjë veprim të akuzuarit B.B. e as që ka pasur ndonjë problem por përnjëherë me të dalë nga lokali vetëm i ka dëgjuar krismat, nuk ka parë asgjë dhe ka ikë nga vendi i ngjarjes.

I dëmtuari S.A. në cilësi të dëshmitarit në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: se ka qenë në lokalin A. bashkë me shokët e tij S. dhe E. dhe tani të ndjerin U., dhe me disa shokë të tjerë. Aty kanë konsumuar pije alkoolike dhe për një moment te tavolina e tyre ka shkuar pronari i lokalit së bashku me një person tjetër për të biseduar lidhur me thyerjen e disa gotave. Pas kësaj njeri prej atyre personave e ka kapur për krahu tani të ndjerin U. dhe kanë dalë jashtë lokalit. I njëjti e ka thirrë kamerierin për ta bërë pagesën dhe gjatë pagesës ka dëgjuar një krismë arme, por nuk ishte në dijeni se sa krisma kanë qenë dhe e njëjta nuk është bërë brenda sallës, kur ka filluar që të dalë nga lokali, një person me trupë të madh, me shkop bejzbolli i ka rënë në kokë në pjesën e përparme në ballë dhe pas kësaj një person tjetër me kondak të armës me ngjyrë të bardhë i ka rënë në pjesën e pasme të kokës dhe pas kësaj e ka humbur vetëdijen dhe këto lëndime i janë shkaktuar sapo ka dalë në derë të lokalit. Në Rikon-strumin e vendit të ngjarjes ka specifikuar se ka qenë aç shumë i dehur sa nuk i kujtohet asgjë lidhur me rastin dhe ka përsëritur disa here se ka qenë tejet i dehur dhe asgjë nuk i kujtohet dhe nuk din as kush me kënd ka dalë nga lokali as si dhe as që ka vërejtur ndonjë problem, veç se ka theksuar se pasi që ka dëgjuar disa krisma jashtë lokalit ka qenë duke e bërë pagesën dhe me të dalë jashtë dikush e ka goditur me një stupc dhe është alivanosur.

I dëmtuari A.S. në cilësi të dëshmitarit, në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: në mbrëmjen kritike ka shkuar rreth orës 23:00, në Restorantin “Agoni”, së bashku me E.K dhe duke marrë parasysht pozitën ku kanë qenë ulur brenda në restorant, nuk kanë pasur mundësinë që të vërejnë personat që kanë qenë të ulur në tavolinën ku ka qenë i ulur i ndjeri Urim, pasi që kanë qenë të penguar nga shtyllat, por se e ka parë të akuzuarin B.B.n, kurë ka shkuar tek tavolina e tyre, por nuk ka mundur që të dëgjoj se çka kanë biseduar. Me të parë se situata ka filluar të tensionohej, me dëshmitarin Enver kanë filluar të dalin nga restoranti si dhe duke dalur, e ka dëgjuar të akuzuarin - pronarin e restorantit B.B.in, duke i thënë të ndjerit Urim, të bëjnë pagesën dhe të dalin nga restoranti dhe e ka dëgjuar të ndjerin U. ti ketë thënë të akuzuarit B.B., a ka mundësi me dalë jashtë? ndërsa ky i fundit i është përgjigjur - jo nuk dal jashtë, dhe ka cekur se dera ka qenë e bllokuar pasi që i akuzuari B.B. ka qenë në derë së bashku me të ndjerin U. duke biseduar, në momentin kur i dëmtuari ishte në pushimoren e shkallëve para derës hyrëse të

lokalit, ka dëgjuar të shtëna armësh dhe ka vërejtur se i është nxehur trupi, pastaj është rrëzuar në tokë sepse kishte humbur vetëdijen.

Dëshmitari Enver Kastrati, në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: në restorantin “Agoni” kanë qëndruar deri në ora 01:00, pas mesnate dhe pasi që ka vërejtur se këngëtarët e kanë ndërprerë muzikën, sipas tij ka vërejtur se diçka nuk është në rregull dhe kanë filluar të largohen së bashku me të dëmtuarin A.S.. Kurë kanë zbritur poshtë shkallëve, në pushimore e ka dëgjuar të dëmtuarin A. Ti i ketë thënë “mu këput krahu”, dhe e ka marrë pa vetëdije dhe e ka dërguar në Prishtinë. Për atë kohë sa ka qëndruar aty në restorant, nuk ka vërejtur parregullsi dhe nuk i ka parë armë askujt.

Dëshmitari E.SH., në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: nuk i kujtohen shumë gjëra pasi që i njëjti natën kritike ka qenë nën ndikim të alkoolit, por ka treguar se atë natë së bashku me të ndjerin Urim dhe me disa shokë të tjerë kanë shkuar në restorantin “Agoni” dhe aty kanë pirë pije alkoolike, pasi ka shkuar në toalet dhe kur është kthyer, ka vërejtur të ndjerin U. i cili kishte shkuar për të biseduar me të akuzuarit dhe i njëjti është kthyer i shqetësuar, i ka parë personat tek sa kanë ikur nga restoranti por nuk i kujtohet ta ketë parë të ndjerin të shtrirë në tokë jashtë tek hyrja e lokalit. Nuk ka mundur as në gjykatë ti identifikojë të akuzuarit dhe për të ndjerin ka treguar se asnjëherë nuk e ka parë të ketë mbajtur armë me vete, po ashtu se nuk ka pasur asnjë problem me asnjë person.

Dëshmitari Sh.R., në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: se atë natë e ka zëvendësuar Bardhyl B.B.n, i cili kishte punuar si shankist atë natë. Natën kritike tek tavolina ku ishte i ndjeri me shokë, janë thyer gota dhe shishe dhe i akuzuari B.B. pasi ka shkuar tek tavolina e tyre, ua ka tërhequr vërejtjen që të mos bëjnë probleme, pastaj është larguar. Ndërsa sipas dëshmitarit personi i cili kishte armë nuk është kthyer brenda, por së bashku me një shok të tij kanë dalur jashtë dhe e kanë thirrë të akuzuarin jashtë. I akuzuari B.B. ka qëndruar në restorant deri në orës 01:30, ndërsa kurë janë dëgjuar të shtënat me armë, nuk e di se ku ka qenë.

Dëshmitari S.S., në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: e ka përshkruar tani të ndjerin si person të qetë dhe të mirë si dhe ka përshkruar se i ndjeri asnjëherë nuk ka bërë probleme me askend dhe derisa ka qëndruar i njëjti në restorant nuk ka pasur asnjë parregullsi dhe nuk e di se si ka ardhur deri te konflikti.

Dëshmitari V.S., në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: por kishte ca dallime mes deklaratimeve të tij, sepse në prokurori kishte deklaruar se tek tavolina ku ishin tani i ndjeri me shokë, ka shkuar i akuzuari B.B. për t’ua tërhequr vërejtjen dhe pas tij edhe i akuzuari B.B., ndërkaq në gjykatë ka deklaruar se te tavolina e tyre ka shkuar vetëm i akuzuari B.B. duke rënë në kundërshtim me deklaratat e tij. Në funde ka pranuar se ajo që ka thënë në prokurori është e vërtetë. Duke i kryer disa pagesa kishte dëgjuar tri të shtëna arme dhe kur ka dalur jashtë lokalit ka vërejtur një personi të mbuluar me qarqaf tavoline dhe i njëjti ka shtuar se pasi pronari B.B. ka biseduar me ata persona në atë tavolinë nuk janë thyer më gota.

Dëshmitari F.J., në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori, ku ka deklaruar se kur ka dëgjuar të shtënat me armë, e ka ndaluar muzikën dhe pasi që është zbrazur i gjithë restoranti, ka vërejtur kur ka dalur te dera se parë një person të shtrirë në tokë i mbuluar me qarqaf por nuk e ka ditur se kush ishte. Vlen të ceket se dëshmitari në prokurori ka deklaruar se kur i ka dëgjuar të shtënat, të akuzuarit nuk kanë qenë në restorant dhe i njëjti ka pohuar se ajo çka ka deklaruar në prokurori është e vërtetë.



Dëshmitarja Kadensha Ferati, me rastin e ri-konstruimit të vendit të ngjarjes, të datës 12.06.2020, në pyetjen e mbrojtëses Myrvete Qollaku ndër të tjera ka deklaruar se: natën kritike ka qenë brenda në lokal së bashku me stafin e saj 5/6 persona, dy shkankista dhe katër kamarier, e që kishin shkuar pas orës 23:00, dhe në tavolinën ku ka qëndruar i ndjeri me shokët e tij, ka vërejtur se kishin thyer shumë sepse vërehej në bazë të copëzave të xhamave, e po ashtu edhe gjatë kohës derisa ajo ka qëndruar me stafin e saj, ata kishin vazhduar të thejnë. Njëri nga personat që gjendeshin në atë tavolinë i cili kishte të veshur një xhaketë të zezë, mbante dorën në xhepin e xhaketës dhe endej hapësirës së lokalit mes tavolinave. Njëri nga personat i cili njihej si Çarli, i cili kishte pasur të përvjelura mëngët e këmishës, i cili qëndronte në këmbë në afërsi të tavolinës se ku gjendej me stafin e saj, në ato çaste ka dëgjuar këngëtaren Xhemile, kurë ajo ka bërtitur me zë të lartë, e që mysafirët të cilët gjendeshin në lokal të panikuar kanë ikur dhe kanë dalur jashtë lokalit, ndërsa të akuzuarin B.B. e ka parë duke shkuar tek tavolina ku ndodhej tani i ndjeri me shokët e tij dhe e ka parë duke biseduar diçka me ta, e të cilët po ashtu kanë dalur jashtë lokalit dhe pas kësaj më nuk e di se çfarë kishte ndodhur. Në pyetjen e prokurores e njëjta shton se nuk i ka parë dikuj në dorë pistoletë vetëm se në momentin kurë mysafirët ishin në panik, dikë e kishte dëgjuar të ketë përmendur pistoletë dhe kishte dëgjuar këngëtaren Xhemile të ketë thënë "A e patë se ke tu më vra". Pastaj ka dëgjuar të shtënat, ndërsa kurë ka dalë nga lokali, kishte parë një person të mbuluar me çarçaf në dalje të lokalit.

Dëshmitari H.B., me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes, të datës 12.06.2020, në pyetje të mbrojtëses së të akuzuarit B.B., av. Myrvete Qollaku, ndër të tjera ishte deklaruar se: natën kritike ka qenë në restorantin "Agoni" si mysafir së bashku me djalin e tij, ku ka shkuar rreth orës 00:00. Kishte vërejtur se diçka nuk shkonte mirë, sepse në një tavolinë aty ku ndodheshin një grup personash, të njëjtit thenin vazhdimisht gota e shishe dhe ka parë B.B.in së paku dy herë të ketë shkuar tek ajo tavolinë për të qetësuar situatën, mirëpo përkundër kësaj personat në fjalë kishin vazhduar të thenin. Në ndërkohë kishte parë tani të ndjerin, i cili ishte ngritur dhe mbante në dorë një telefon dhe dorën e djathtë në xhepin e xhaketës, të ekspozuar sikur mbante diçka brenda xhepit dhe ectë nëpër hapësirën e lokalit. Të akuzuarin B.B. e ka parë natën kritike kurse të akuzuarin B.B. nuk e ka parë. Në një moment ka dëgjuar dy të shtëna dhe në atë moment B.B.i ka qenë jashtë lokalit.

Eksperti i Balistikës Ilir Kukaj, në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: ka treguar se distanca nga arma prej të cilës është shtënë në të ndjerin ka qenë 30-50 cm. Eksperti ka treguar se numri i saktë i gëzhjave dhe predhave të sjellura për ekspertimë në AKF, janë në raportin e ekspertimit balistik me nr. AKF/2015-1094/2015 -932, i dt. 15.05.2015, dhe janë: një gëzhjoj e kalibrit 7.65x17mm, e evidentuar me shifrat VN#9, VN#10, VN#11, VN#13, VN#20, pastaj 4 predha të evidentuara me shifra VN#14, VN#15, UD#1 dhe U#2.2, si dhe një xhaketë apo këmishëz e predhës dhe një bërthamë predhe, të evidentuara me shifrat A.S#1. Sipas ekspertit në vendin e ngjarjes janë përdorur 3 armë prej të cilave dy kanë qenë të kalibrit 9x19mm, dhe njëra ka qenë 7.65x17mm, ku ka konstatuar se janë dorëzuar vetëm dy armë, ndërsa arma e kalibrit 7.65x17mm, e fiksuar me shifrën VN#2, ku sipas skicës së vendit të ngjarjes është gjetur gëzhjoja në oborrin e lokalit, nuk është dorëzuar për ekzaminim. Eksperti ka shtuar se në tani të ndjerin Urim, është shkrepur me armë gjysmë automatike "Ceska Zbrojovka" model 75, me nr. serik 154865, e fiksuar me shifrën B.B#1. Në dy predhat që janë gjetur në trupin e tani të ndjerit të evidentuara në dëshmitë U.2 #1 dhe U.2#2, janë shkrepur nga arma e cekur më lartë. Personi i cili ka shtënë me armë me të cilën është shkrepur gëzhjoja e fiksuar me shifrën VN#2, ka qenë jashtë në oborrin e lokalit në një distancë rreth 1 m. Eksperti ka sqaruar se bazuar në procesverbalin e vendit të ngjarjes dhe fotografive, se gëzhjoja e kalibrit 9x19mm, evidentuar me shifrën VN#13, ka qenë pranë trupit të tani të ndjerit.

Me rastin e rigjykimit, eksperti i lartcekur ka sqaruar se gëzhoja e trete e armës e cila nuk ka qenë në kalibrim, rezulton të jetë gëzhoje e vjetër e baltosur dhe e dryshkur që rezulton të jetë përdorur kohë më pare, por që nuk lidhet me natën kritike.

Eksperti i mjekësisë ligjore Dr.Arsim Gerxhaliu, në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: ka treguar se si është bërë ekspertiza mjeko-ligjore si dhe shkaku i shkaktimit të vdekjes e të ndjerit. Në pyetjen e prokurorit se nëse i ndjeri ka pasur edhe ndonjë dëmtim të vjetër? eksperti përgjigjet se është përshkruar edhe një dërmishje shiritore e cila ndërlihet nga dëmtimi në kokë, vazhdon poshtë kah ana e majtë në qafë e deri te dëmtimi i cili ndodhet në pjesën e epërme të ekstremitetit apo në krah, e gjatësia e këtij dëmtimi është 3-30 cm në gjerësi dhe i lidhur faktikisht si shirit të tre plagëve. Çdo ndryshim në organizëm paraqet dëmtim, por nëse pyetni për etiologjinë e saj, e njëjta ka të bëjë si dëmtim i cili mund të jete si pasojë e veprimit të armës e cila është përdorur në atë moment. Ndryshimet sipërfaqësore në pjesën e shikuar të shalës së hundës janë gërvishtje të shprehura me minus epidermë si dhe dy skuqjet në pjesën ballore që gjithashtu i përkasin pjesëve më të shqitura të kokës, nuk janë të shkaktuara nga ndonjë goditje, por si pasojë e ramjes në dysHEME, me siguri e cila nuk ka qenë në interesin e përshkrimit të terthortë sikurse është bërë përshkrimi i plagëve, i predhave. Eksperti ka shpjeguar gjithashtu se vrima hyrëse ka disa lloje të unazave, ajo e para rreth dëmtimit quhet (unaza e mbretjes) e cila është pasojë e stërzgjatje së lëkurës dhe në momentin kur predha kalon për shkak të rrotullimit rreth boshtit të vet, merrë një pjesë të lëkurës që në mjekësinë ligjore quhet “Ninusind”, derisa e merrë atë pjesë të lëkurës, pjesa e zgjatur e lëkurës e cila ndodhet për milisekonda rikthehet në pozicionin e saj normal, por si pasojë e shkëputjes së enëve të vogla të gjakut krijohet unaza e parë që e quhet unaza e mbretjes, rreth asaj ndodhet në rastin konkret edhe unaza tjetër e cila është shkaktuar si pasojë e përcjelljes së blozës së barotit, gazrave që në aspektin mjeko ligjor kur ka të bëjë me armë të vogla të dorës quhet afërsi që nënkupton largësinë deri në maksimum 1 m. Eksperti është pyetur nëse është kryer goditja nga mbrapa kokës? dhe i njëjti është përgjigjur se standardet operative profesionale me rastin e përshkrimit të plagëve bazohen edhe përshkruhen në pozicione normal anatomike dhe drejtimi i kanalit të dëmtimit përshkruhet për këtë pozicion. Goditja ka qenë nga ana e majtë lehtë mbrapa. E dyta ka qenë në atë pjesë të epërme të shpinës, pjesa e pasme e saj anësore. Distanca e qitjes ka qenë e shpejtë dhe lidhur me pozitën e të ndjerit në raport me personin që ka gjuajtur për të vërtetuar pozitën duhet të shiqohen fotot e vendit të ngjarjes dhe rrethanat tjera të nevojshme sepse doemos pozita e viktimës me gjuajtësin ai ka qenë në pjesën e majtë të pasme dhe lartë. Në aspektin mjeko ligjor në momentin kur gjejmë ndryshime plotësuese apo tjera përveç vrimës hyrëse të clën e shpjeguar më lartë, falet besueshmëria e lartë për goditje nga afërsia që tek armët e vogla të dorës nënkupton maksimumin deri 1 m, prej tytës deri te plaga, kurse nga aspekti mjeko ligjor largësia është gjithçka mbi 1 m e pa kufi. Eksperti ka treguar se vdekja e tani të ndjerit ka qenë shumë e shpejtë pasi që janë atakuar organet super vitale, zemra, baza e kafkës dhe melqia. Vrimat hyrëse dhe dalëse kanë bërë që gjaku të delë edhe jashtë, meqenëse janë 5 vrima dhe ediomë se pompa kryesore e zemrës është e dëmtuar për shkak të kalimit të predhës dhe në momentin kur kemi gjakderdhje të madhe sikurse që është përshkruar atëherë themi se 1/3 (një e treta) e gjakut kur të humbet, thuhet se është dëmtim i rëndë trupor në momentin, por i rrezikshëm në momentin e shkaktimit. Në trupin e tani të ndjerit me rastin e obduksionit janë gjetur dy predha dhe të njëjtat pastrohen dhe i dorëzohen policisë për analizë balistike.

Eksperti i forenzikës Milazim Tahirukaj, në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: ka theksuar se vetë e ka bërë ekzaminimin e jaknes “Emporio” me ngjyrë të kaltër dhe se në jaknen e tani të ndjerit, pas ekzaminimit janë gjetur nitrite dhe nitrate dhe po ashtu këto të fundit janë gjetur edhe në dorën e majtë dhe në dorën e djathtë tani të ndjerit të përshkruara në dëshmitë 1.1,2.1,dhe 3.1 . Mbetjet dhe qitjet e armës me prejardhje nga baruti, të evidentuara në

jakne nuk mundë të përcaktohen se në cilën pjes të jaknes janë pasi që jakna merret si tërësi dhe pasi e njëjta mbështjelllet nga policia në vendin e ngjarjes dhe vendoset në qese najlloni, ato grimca mundë të përhapen në gjithë jaknen. Eksperti ka përmendur tri lloje të barutit në tri baza 1. nitroceluloza, 2. nitroceluloza dhe nitroglicerina dhe 3. nitroceluloza, nitroglicerina dhe nitroguanidina, dhe këto tri baza janë gjetur në dëshmitë e evidentuara.

### Procedimi i provave materiale

Në shqyrtimin gjyqësor edhe në r-gjykim me pëlqimin e palëve dhe pa kundërshtime ishin administruar provat si vijon: Raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes me zingjirin e ruajtjes së dëshmimeve me skic dhe foto dokumentacioni i datës 14.02.2015, Raporti i ekspertizës balistike i datës 15.05.2015, Raporti i autopsisë për të ndjerin U.D. me numër MA 15-042, Ekspertiza mjekoligjore lidhur me natyrën e lëndimeve për të dëmtuarit A.S., E.Q. dhe S.A., Raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes së bashku me CD që janë bërë për gjatë rikonstruimit të vendit të ngjarjes, është fjala për dy ri-konsumime të vendit të ngjarjes.

### Deklarimi i të akuzuarve

Në shqyrtimin e fundit gjyqësor, të akuzuarit kishin shfrytëzuar të drejtën e tyre për tu mbrojtur në heshtje mirëpo duke i mbështetur deklaratimet e tyre të më hershme.

Në deklaratimet e tyre të më hershme I akuzuari B.B. B.B. në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: ka mohuar të ketë kryer veprën penale si në dispozitivin (I) të aktakuzës, ndërsa për veprën penale si në pikën (II) të aktakuzës ka pranuar fajësinë dhe qëndron pranë deklaratimeve të tij të dhëna në shqyrtimin gjyqësor të dt. 08.11.2018, në të cilin ka deklaruar se: veprën penale si në pikën (I) të aktakuzës e ka kryer në vetëmbrojtje pasi ka menduar se i ndjeri e ka vrarë tani të akuzuarin B.B., pasi i ndjeri ka shkrepur dy herë me revolen e tij. I akuzuari ka deklaruar se nuk e ka shtyrë tani të ndjerin Urim dhe nuk e ka parë nëse i akuzuari B.B. ka arritur t'ia marrë armën nga dora tani të ndjerit, dhe pasi që e ka parë se tani i ndjeri e ka nxjerrë armën nga xhepi dhe ka shkrepur me të në drejtim të tyre, i akuzuari ka shtënë 2-3 herë në drejtim të tani të ndjerit duke e goditur në gjoks.

I akuzuari B.B., në deklaratimet e tij në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: ka mohuar të ketë kryer veprat penale me të cilat e ngarkon prokuroria në aktakuzë, qëndron pranë deklaratimeve të tij të dhëna në shqyrtimin të mbajtur me dt. 08.11.2018, në të cilin ndër të tjera ka deklaruar se: natën kritike ka shkuar në lokalit "Agoni" rreth orës 20:00, ku është bashkëpronar me tani të akuzuarin B.B. B.B.n, rreth orës 23:00, ka shkuar tani i ndjeri U.D. me shoqërinë e tij dhe të njëjtit kanë konsumuar alkool dhe kanë filluar të thyejnë gota dhe shishe. Posa ka shkuar dhe ua ka tërhequr vërejtjen dhe ka kërkuar nga ata që ta lirojnë lokalit, kur ka dalë tani i ndjeri U. jashtë lokalit, ia ka bërë me shenjë që të dalë jashtë dhe i akuzuari ka cekur se arsyeja pse ka dalë ka qenë pasi që ka menduar se i ndjeri do ti kërkojë falje. I akuzuari B.B. e ka mohuar se ka pasur armë me veti pasi sipas tij arma të cilën dëshmitarët ja kanë parë në dorë ka qenë e tani të ndjerit U. dhe ka pranuar se tani të dëmtuarin E.Q. e ka goditur me kondak të armës duke u arsyetuar se e ka bërë për vetëmbrojtje. Pasi që i njëjti është ballafaquar me një deklaratë të dhënë në polici lidhur me shkopin e bejsbollit i cili kishte deklaruar se nuk e ka parë, ndërsa në gjykatë ka deklaruar se shkopin e ka marrë pasi që ka ndodhur rasti dhe e vërteta është që ajo që ka deklaruar në gjykatë. I akuzuari ka deklaruar se kurë ja ka parë të ndjerit dorën në xhep, ka tentuar t'ia marrë armën nga dora si dhe ka deklaruar se nuk e ka parë të akuzuarin B.B. kur ka gjuajtur me armë.

### Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e shtetit, Bukurije Gjonbalaj në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se mbështetë fajlët përfundimtare të dhëna më parë, ndera në fjalën përdundimtare të mbajtur me datë 08.07.2020, ka deklaruar se mbetet pranë fjalës përfundimtare të parashtruar në shqyrtimin e mëhershëm të datës 23.11.2018, në të cilin ka deklaruar: Se me rastin e prezantimit të provave gjatë shqyrtimeve gjyqësore u argumentua se të akuzuarit B.B. B.B. dhe B.B. në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën-par 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe secili veç e veç veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Në shqyrtimet gjyqësore para trupit gjykues, në cilësinë e të dëmtuarve ka dëshmuar Admir Dushullovc -përfaqësuesi i të ndjerit U.D., A.S., E.Q. dhe S.A., po ashtu në cilësinë e dëshmitarëve janë ndëgjuar:, S.S., F.J. K.G. V.S., E.K., E.SH., Xh.V. dhe janë administruar provat materiale të parashtruar nga prokuroria, e që nga gjykata, në bazë të këtyre dëshmimeve është vërtetuar gjendja faktike lidhur me këto vepra penale të kryera. Prokuroria ka kundërshtuar mbrojtjen e të akuzuarve, ngase gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, bazuar në provat materiale dhe personale të administruara. Trupi gjykues pas vlerësimit të gjitha provave do të vërtetojë këtë gjendje faktike: se të akuzuarit fillimisht janë fjalosur me të dëmtuarit, pra kanë pasur një mosmarrëveshje mes tyre rreth thyerjes së gotave në lokal, më pas të akuzuarit kanë kërkuar që i ndjeri dhe të dëmtuarit ta bëjnë pagesën dhe të largohen nga lokali dhe posa të akuzuarit e nxjerrin jashtë të ndjerin U. e sulmojnë atë dhe shokët e tij tani të dëmtuar me shkop dhe me armë, që tregojnë se të akuzuarit kishin plan paraprak pasi ishin pajisur me armë dhe shkop ashtu që fillimisht e sulmojnë të ndjerin U. dhe derisa i akuzuari B.B. e ka mbajtur për dore, i akuzuari B.B. shtin katër herë në drejtim të ndjerit U. ga një afërsi rreth 1m, po ashtu nga trajektorja e plumbave dhe pozita përfundimtare e rënies së të ndjerit vërtetohet se i ndjeri në momentin e gjuajtjes në të, ka qenë i kërrusur duke e mbrojtur veten e tij, pra ka qenë i pa rrezikshëm për të akuzuarit, këtë e kanë vërtetuar si ekspertët mjeko ligjor ashtu edhe eksperti i balistikës. Po ashtu është vërtetuar se sulmi ka qenë i shpejtë ndaj të ndjerit sa që i ndjeri U. nuk ka pasur ta nxjerrë armën nga xhepi edhe pse me të shtënë njëherë derisa armën e kishte në xhep me qëllim të evitimit të sulmit, po ashtu nëse shikohet foto dokumentacioni, vërehet se i ndjeri U., përveç dëmtimeve në trup nga vrimat e predhave ka pasur edhe lëndime trupore në ballë, në hundë, në hapësirën mes ballit dhe hundës, që vërteton faktin se i ndjeri Urim është sulmuar nga të akuzuarit dhe me në këtë rast nga gjuajtja me armë vdes në vendin e ngjarjes, sikur që rrezikohet edhe jeta e tani të dëmtuarit A.S. i cili goditet me një predhë në krahun e djathtë, me ç ‘rast pëso lëndime të rënda trupore e më pas i akuzuari B.B., me kondak të revoles me ngjyrë të bardhe, e ka goditur në kokë dy herë të dëmtuarin E.Q., ndërsa të dëmtuarin S.A. e ka goditur i akuzuari B.B., me një stupc bejsbolli në kokë, sikurse i akuzuari B.B., me kondak të revoles së njëjtë e godet në kokë edhe të dëmtuarin S.A. edhe pse tani më të dëmtuarit të lënduar largohen nga vendi i ngjarjes, kurse të akuzuarit nuk lajmërohen në polici me qëllim të largimit të mbetjeve të gjurmëve të mbetjeve të barotit në duar dhe trupin e tyre si dhe organizimit të mbrojtjes mes tyre. Po ashtu vlen të theksohet se në këtë situatë të krijuar, një person humb jetën, një person tjetër pëson lëndime të rënda trupore dhe dy të tjerë lëndime të lehta trupore, ndërsa dy të akuzuarit nuk kanë asnjë lëndim të vetëm. Në rastin konkret, përveç faktit që është vërtetuar çartë se tani të akuzuarit kanë kryer veprat penale të lartcekura në bashkëkryerje, e që elementet e bashkëkryerjes në rastin konkret janë shumë të qarta ashtu siç precizohen në nenin 31 të KPRK-së, sipas të cilit nen: “nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë vepra penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale”. Pra, referuar kësaj dispozite, është i qartë fakti se të akuzuarit B.B. dhe B.B., në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale që u vihen në barrë. Ekziston elementi i konsumuar i bashkëkryerjes se kanë qenë dy persona, se të dytë thelbësisht

i kanë kontribuar kryerjes së kësaj vepre penale, qëllimi i të cilëve ka qenë vrasja e të ndjerit U.D. dhe shkaktimi i lëndimeve për tani të dëmtuarit. Secili nga të akuzuarit e ka përdorur forcën (mbajtjes për dore), cili ka shtënë me armë janë fakte të cilat nuk e zbehin elementin e bashkëkryerjes, ngase është i pamohueshëm fakti se që të dytë kanë marrë pjesë aktive në kryerjen e kësaj vepre penale, ngase me përdorimin e armës së zjarrit, e kanë privuar nga jeta të ndjerin Urim dhe kanë shkakuar lëndime për tani të dëmtuarit, të përshkruara si në dispozitivin I të aktakuzës. Në rastin konkret është plotësuar elementi subjekti i bashkëkryerjes i cili konsiston në vendimin e përbashkët të të akuzuarve për kryerjen e veprave penale. Në kontekst të kësaj rezulton se të akuzuarit ,bashkë kryesit kanë qenë të vetëdijshëm dhe kanë dëshiruar së bashku kryerjen e veprës penale. Përveç elementit subjektiv, është plotësuar edhe elementi objektiv i bashkëkryerjes që konsiston në faktin se vepra penale është kryer pikërisht nga dy të akuzuarit në fjalë. Pra, që të dy të akuzuarit pavarësisht veprimeve individuale, i kontribuuan thelbësisht kryerjes së veprës penale si në aktakuzë. Bazuar në veprimet e tyre rezulton se plani i përbashkët ishte që të dy bashkë të kryejnë veprimet që i kanë kryer, andaj prokuroria mbetet pranë aktakuzës së ushtruar dhe propozon që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas KPRK-

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B. B.B., Avokati Berat Tmava, në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim, në mes tjerash ishte deklaruar si vijon: e ka përgatitur ne forme te shkruar, një kopje ja dorëzon prokurores se shtetit dhe do ta elaboroj për procesverbal. Meqenëse ne fjalën përfundimtar e me shkrim nuk e kam përfshire këtë pjese, dua ta parashtroj këtë çështje për procesverbal. Sipas raportit te ekspertimit nga agresioni i Kosovës për faranike, ne faqen 4 nga konstatimi përfundimtar rezulton se dëmtimi i shkakuar ne xhepin e djathte te xhaketës te sjellur për ekspertim e cila i ka takuar te ndjerit është shkakuar nga e shtëna ne drejtim nga brenda jashtë, apo nga brenda xhepit ne drejtim te brendshëm te xhaketës, po ashtu edhe demonstrimi i jaknes se te ndjerit qe është bere nga eksperti Ilir Kukaj , është konstatuar se kemi te bëjmë me vrime nga arma e zjarrit, nga brenda- jashtë, e nga ky fakt është vërtetuar se nga ana e te ndjerit ka pasur te shtëna me arme zjarri dhe është vërtetuar se kjo e shtëna është përdorur para se i mbrojturi im te përdor armen e tij. Nga kjo gjendje faktike e qe nuk është kontestuese dhe është e bazuar ne prova dhe fakte rrjedh se veprimet e klientit tim B.B. B.B. pa mëdyshje se duhet te trajtohen si veprime te ndërmarra ne kuadër te mbrojtjes se nevojshme e te parashikuara me nenin 12 te KPPRK-se. Nga e tera qe është thëne ne këtë fjale përfundimtare gjykatës i propozojmë qe ex officio ta ri cilësoje veprën penale dhe klientin tim ta gjeje fajtor për veprën penale Vrasje ne mbrojtje te nevojshme te parashikuara me nenin 178 lidhur me neni 12 par 2 te KPPRK-se si dhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll apo posedim te paautorizuar te armeve te cilën vepër e ka pranuar qe ne fillim te procesit gjyqësor. Ne momentin e matjes dhe lartësisë se sanksionit penal i gjykuar ti këtë parasysh rrethanat lehtësuese e posaçërisht si rrethane lehtësuese ta trajtoje edhe faktin se klienti im është njeri familjar është baba i dy fëmijëve dhe prej kohës sa ka qëndruar ne paraburgim, gjegjësisht prej dt. 15.02.2015 asnjëherë nuk ka rene ndesh as me ligjin e as me rendin shtëpiak ne qendrën e paraburgimit. Pjese te tjera te fjalës përfundimtare janë te cekura ne fjalën përfundimtare me shkrim.

I akuzuari B.B. B.B. në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B., Avokat Skender Musa, kishte mbështetur fjalën tij përfundimtare nga gjykimi i kaluar e në të cilën ishte deklaruar si vijon: në këtë shqyrtim gjyqësor pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve dhe ekspertëve të propozuar nga Prokurori i Shtetit, është vërtetuar plotësisht se i mbrojturi i tij B.B., është i pa fajshëm dhe nuk ka kryer

veprën penale “Vrasja e rëndë” nga neni 179 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, e as veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Aktakuza e prokurorisë nuk ka respektuar parimet bazë të dispozitave të KPPRK-së, dhe atë nenin 7 par. 1 dhe 2 për shkak se prokuroria ka qenë e obliguar ti vërtetojë saktësisht provat dhe faktet si dhe ka qenë e obliguar që ti trajtoj në të njëjtën mënyrë që kanë qenë në favor të mbrojturit të tij dhe të cilat prova duke përfshirë edhe dëshmitarët e prokurorisë kanë dëshmuar fuqishëm se i mbrojturi i tij nuk i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Aktakuza është e pa mbështetur në prova dhe nuk specifikohen detajet e veprimeve individuale të mbrojturit të tij e që do të kishin lidhje logjike dhe praktike me veprat penale. Në këtë rast provat e pretenduara bazohen në spekulime dhe thashetheme. Këtë pretendim mbrojtja e mbështetë në deklaratat e dëshmitarëve të prokurorisë sepse asnjëri nga ta nuk ka deklaruar se e ka parë B.B.n duke shtënë në drejtim të ndjerit, asnjëri nga dëshmitarët nuk ka deklaruar se i ka parë armë natën kritike të mbrojturit të tij, me përjashtim të dëshmitarit E.Q.i cili spekulon se kinse i mbrojturi i tij e ka goditur në kokë me armë me dorezë të bardhë. Deklarimi i këtij dëshmitari është i pa vërtetë dhe i pa mbështetshëm dhe kjo deklaratë e tillë lidhet me dispozitën e nenit 19 par. 1 nën par. 1.29 dhe 1.30 të KPPRK-së, për shkak se nuk ka asnjë provë që mbështet pohimin e tij dhe nuk ka asnjë dëshmitar tjetër që e pohon këtë informatë dhe në këtë çështje penale janë konfiskuar dy armë me ngjyrë të zezë por asnjëra me ngjyrë të bardhë. Prokuroria nuk e ka sqaruar me asnjë fjalë bashkëkryerjen dhe dashjen se të akuzuarit B.B. B.B. dhe B.B., për të kryer veprën penale. Prokuroria ka dështuar të përshkruajë veprimet e të mbrojturit të tij B.B., dhe veprimet e të akuzuarit B.B.. Nuk ekziston bashkëkryerja pasi që për veprat penale të kryera në bashkëkryerje duhet të përshkruhet kontributi i secilit të akuzuar, marrëveshja paraprake, në mes të kryesve nuk ka pasur marrëveshje të tillë për të kryer veprën penale. Nuk ka pasur lidhje objektive në këtë çështje penale sepse nuk ka pasur marrëveshje për kryerjen e ndonjë veprimi nga ana e të mbrojturit të tij i cili është sulmuar fizikisht nga i ndjeri, por ka pasur edhe tentativë për ta privuar nga jeta duke shkrepur dy herë me revolen e tij dhe atë çast – shumë në afekt nga frika se u vra B.B.i, brenda pak sekondave ka shtënë B.B.u në drejtim të te ndjerit dhe e ka qëlluar për vdekje. Veprimet e të mbrojturit të tij për ta evituar rrezikun nga vetja pasi që ka vërejtur se i ndjeri ka armë dhe tentimin për ta vrarë B.B.n, nuk mundë të lidhet me asnjë veprim të te pandehurit B.B. B.B., pasi që i mbrojturi i tij nuk e ka parë fare B.B.un kur ka shkrepur me armë dhe nuk ka qenë në dijeni se do të gjuajë në drejtim të te ndjerit. Në bazë të kësaj nuk kemi lidhje në mes të veprimeve të te mbrojturit të tij dhe vrasjes së të ndjerit, nuk ekziston lidhje objektive në këtë çështje penale për të ekzistuar bashkëkryerja. Mbrojtja në këtë çështje penale është e sigurve se nuk ekziston lidhja subjektive e bashkëkryerjes pasi që kusht themelor për të ekzistuar ky element është fakti se pjesëmarrësit duhet të jenë të ve dijshëm se në kryerjen e veprës penale do të marrin pjesë. I mbrojturi i tij nuk ka qenë në dijeni se do të ndodhë vrasja, e cila ka ndodhur prapa shpinës së tij, i cili nuk e ka parë fare pozicionin e të akuzuarit B.B. B.B., por vetëm i ka dëgjuar të shtënëat nga revolja të cilat kanë qenë të menjëhershme dhe të atëçastshme. Nuk ekziston dashja direkte dhe dashja eventuale e as pakujdesia si formë e fajit. Prokuroria vetëm në dispozitiv përmend dashjen pa sqaruar se a bëhet fjalë për dashje direkte apo dashje eventuale dhe nuk e sqaron se në bazë të cilave prova ka dëshmuar se i mbrojturi i tij B.B. ka dashur që i ndjeri të privohet nga jeta. Në aktakuzë nuk është sqaruar mënyra se si prokuroria e ka vërtetuar se i mbrojturi i tij ka qenë i vetëdijshëm se do të ketë vrasje me dt. 14.02.2015, cili ka qenë faji i të mbrojturit të tij në rastin konkret duke pasur parasysh pozicionin e tij në momentin e ndodhjes së rastit. I mbrojturi i tij nuk ka dashur që të kryhet vrasja dhe as nga i akuzuari tjetër, nuk ka qenë në dijeni se mund të ndodhë vrasja, andaj nuk ka ekzistuar dashja direkte apo eventuale dhe as pakujdesia, për shkak se i njëjti nuk ka dashur që të ketë asnjë lloj sulmi, rrahje apo vrasje. Fakti se i mbrojturi i tij nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, e bazon në nenin 7 të KPPRK-së, në të cilin parashihen elementet themelore të veprës penale: veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fajësia.

Për të konstatuar se është kryer një veprë penale duhet të plotësohen në mënyrë komulative 4 elementet e theksuara më lartë. Me asnjë provë nuk është dëshmuar se i mbrojturi i tij ka ndërmarrë veprime për të kryer veprën penale të vrasjes apo veprën penale të armëmbajtjes. Sa i përket gjendjes faktike të përshkruar në aktakuzë, janë dëgjuar dëshmitarët, ekspertët, janë administruar provat dhe është bërë ri-konstruimi i vendit të ngjarjes dhe në bazë të te gjitha dëshmimeve është vërtetuar se i mbrojturi i tij B.B., nuk i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar A.D.i, nuk ka paraqitur ndonjë detaj që ndërlihet me të mbrojturin e tij. Dëshmitari A.S. ka dëshmuar se natën kritike ka qenë në lokalitetin Agoni në fshatin Banullë, së bashku me E.K., i njëjti dëshmitar vërteton dëshminë e të mbrojturit të tij para trupit gjykues se i ndjeri e ka ftuar të dalë jashtë lokalitetit të mbrojturin e tij. Dëshmitari në fjalë ka dëshmuar se ngjarja ka ndodhur brenda një kohe shumë të shkurtër dhe për shkak të plagosjes së tij, nuk ka arritur që të shoh se cili person e ka kryer vrasjen. Dëshmitari tjetër E.Q., ka dëshmuar se ka qenë në lokalitetin e përmendur së bashku me të ndjerin Urim dhe disa shokë tjerë, i cili ka theksuar se nuk i ka parë personat që kanë shtënë me armë dhe më vonë ka kuptuar se kishte vdekur i ndjeri U. Dëshmitari E.Sh., ka pohuar se ka qenë prezent natën kritike në lokalitetin e përmendur, por në kohën e ndodhjes së rastit ka qenë në toalet dhe nuk i ka dëgjuar fare të shtënat me armë dhe as nuk e ka kuptuar se tani i ndjeri U. kishte vdekur. Edhe dëshmitarët E.K., V.S., K.G., F.J., që kanë dëshmuar në këtë proces gjyqësorë, kanë deklaruar se nuk kanë parë se kush ka shtënë me armë natën kritike, kurse dëshmitarja Xh.V., ka deklaruar se natën kritike ka qenë duke kënduar dhe në tavolinën ku ka qenë i ndjeri e ka parë një armë dhe nga frika e ka ndërprerë muzikën dhe ka shkuar në dhomën për këngëtar. Asnjëri nga dëshmitarët e propozuar nga prokuroria nuk ka dëshmuar se kanë parë B.B.n të ketë ndërmarrë ndonjë veprim për ta kryer veprën penale të vrasjes. Me rastin e daljes në vendin e ngjarjes, beson se trupi gjykues në mënyrë të mjaftueshme ka vërtetuar se vrasja është kryer nga i akuzuari B.B. B.B. dhe atë pas të shtënave dy herë radhazi nga i ndjeri në drejtim të të mbrojturit të tij B.B.. Vrasja nga B.B. B.B. ka ndodhur në bazë të institutit të mbrojtjes së nevojshme, pasi që i njëjti ka shtënë me armë nga frika se i ndjeri ka vrarë të mbrojturin e tij B.B.in, në një distancë kohore shumë të shkurtër rreth disa sekondave pas të shtënave të të ndjerit. Pasi i ndjeri me shokët e tij janë larguar nga lokali, i mbrojturi i tij ka shkuar afër banakut dhe ka menduar se ata kanë shkuar, por i ndjeri me veprime konkludente (me dorë) e ka thirre të mbrojturin e tij që të shkojë tek dera jashtë lokalitetit dhe pasi është ofruar ka vërejtur se në dorë, konkretisht në xhepin e xhakëtës posedon armë të cilën e ka drejtuar në drejtim të të mbrojturit të tij B.B.t dhe pasi që ka vërejtur të ndjerin Urim se ja ka drejtuar armën, ju ka gjuajtur me të dy duartë në dorën e të ndjerit i cili ka shkrepur dy herë dhe plumbat i kanë shkuar të mbrojturit të tij në afërsi të dorës së djathtë, dhe brenda disa sekondave ka dëgjuar disa të shtëna të armës të cilat e kanë goditur të ndjerin i cili ka rënë në tokë. Faktin se i mbrojturi i tij nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të vrasjes së tani të ndjerit, fuqishëm e ka dëshmuar edhe i akuzuari B.B. në deklaratat e tij të dhëna në polici, prokurori dhe para trupit gjykues, i cili e ka pranuar se e ka kryer vrasjen në rrethana të mbrojtjes së nevojshme nga neni 12 i KPRK-së. B.B. B.B. shumë qartë e përshkruan momentin kurë kanë ndodhur dy të shtëna me armë nga i ndjeri në drejtim të të mbrojturit të tij dhe si rezultat i frikës së madhe në një distancë prej 1m, ka shtënë në drejtim të të ndjerit duke besuar se i ndjeri e ka vrarë B.B.in. Mbrojtja beson se në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari B.B. nuk i ka kryer veprat penale dhe këtë e mbështetë në faktin se nuk ka pasur asnjë fotografi, video, dëshmitar i cili ka deklaruar se e ka parë të njëjtin duke shtënë me armë në drejtim të të ndjerit dhe në anën tjetër edhe dëgjimi i ekspertëve si ekspertit mjeko ligjor dhe ekspertit të eksplozivëve nuk kanë dëshmuar se B.B., ka ndërmarrë ndonjë veprim për ta kryer vrasjen. Sa i përket veprës penale nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, prokuroria nuk ka paraqitur prova në të cilat do të dëshmojë se i mbrojturi i tij natën kritike ka pasur armë dhe për të ekzistuar kjo veprë penale është dashur të përcaktohet saktë lloji i armës, të behet konfiskimi i armës, ndërsa i mbrojturi i tij e ka sqaruar se pas vdekjes së të ndjerit, arma e të ndjerit i ka mbetur në dorë të cilën e ka

leshur në afërsi të trupit të të ndjerit. Bazuar në lartshënuarat, provat që gjenden në shkresat e lëndës, propozon që trupi gjykues në pajtim me nenin 364 par. 1 nenpar. 1.3 të KPPRK-së, ndaj të mbrojturit të tij B.B., të merrë Aktgjykim lirues, sepse nuk është provuar se i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

I akuzuari B.B. në fjalën e tij përfundimtare kishte mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit të tij.

### **VLERËSIMI I PROVAVE**

Gjykata në vazhdim do të analizoj secilën provë si vijon:

#### **Provat personale dhe materiale**

- 1.Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – A.D.
- 2.Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – E.Q.
- 3.Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit – A.S.
- 4.Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit – S.A.
- 5.Dëshmia e dëshmitarit – S.S.
- 6.Dëshmia e dëshmitarit – V.S.
- 7.Dëshmia e dëshmitarit – K.G.
- 8.Dëshmia e dëshmitarit – E.K.
- 9.Dëshmia e dëshmitarit – E.SH.
- 10.Dëshmia e dëshmitarit – Xh.V.
- 11.Dëshmia e dëshmitarit – F.J.
- 12.Dëshmia e dëshmitarit – Sh.R.
- 13.Dëshmia e dëshmitarit – K.F.
- 14.Dëshmia e dëshmitarit – H.B.
- 15.Deklarimi i ekspertit – I.lir Kukaj
- 16.Deklarimi i ekspertit – Arsim Gërxhaliu
17. Deklarimi i ekspertit – Milazim Tahirukaj
  
18. Raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes me zingjirin e ruajtjes se dëshmimeve me skic dhe foto dokumentacion i datës 14.02.2015
19. Raporti i ekspertizës balistike i datës 15.05.2015,
20. Raporti i autopsisë për te ndjerin U.D. me numër MA 15-042,
21. Ekspertiza mjekoligjore lidhur me natyrën e lëndimeve për te dëmtuarit A.S., E.Q. dhe S.A.,
- 22.Raporti i ri-konstruimit të vendit te ngjarjes se bashku me CD qe janë ber për gjate ri-konstruimit te vendit te ngjarjes, është fjala për dy ri-konsumime te vendit te ngjarjes

Gjykata në vazhdim do të trajtoj se cilën provë veç e veç dhe do nxjerr përfundimet për çështjet dhe faktet që i ka vërtetuar për gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë lidhur me rastin, gjykata gjatë analizimit të deklaratave, si dhe administrimit të të gjitha provave tjera do të koncentrohet në fragmentet të cilat ndriçojnë objektin e çështjes

#### **Faktet jo kontestuese**



Për të mos krijuar huti, përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë fillimisht konstaton se për gjykatën nuk ishte kontestueses fakti se me datën datë 14.02.2015, rreth orës 02:00, në Restorant “Agoni” në fshatin Banull të Lipjan ishte goditur me armë zjarri tani i ndjeri U.D. i cili kishte ndërruar jetë në vendin e ngjarjes. Për gjykatën nuk ishte kontestuese as fakti se tani i ndjeri ishte në shoqëri me E.Q., S.A. e E.Sh. dhe ishte duke festuar lindjen e vajzës së tij. Nga provat e administruara rezultoi të jetë jo-kontestueses edhe fakti se të dëmtuarit kishin qenë mjaft të dehur dhe kishin shkaktuar probleme në lokal duke thyer shishe dhe gota e madje duke kërcënuar edhe këngëtarin.

Për gjykatën rezultoi të jetë jo-kontestueses edhe fakti se tani i ndjeri U.D. ishte privuar nga jeta me armën Ceska Zbrojovka model 75”, e kalibrit 9x19mm, me numër serik 154865 ku ishte goditur me 4 plumba në afërsi prej një metre.

Madje për gjykatën nuk rezultoi të jetë kontestueses as fakti se armën e lartcekur e kishte përdorur tani i akuzuari B.B. B.B..

Për gjykatën rezultoi të jetë kontestuese se cili ishte qëllimi i të akuzuarit B.B. B.B. që privoju nga jeta tani të ndjerin U.D., se a e privoju nga jeta për shkak të problemit që kishte ndodhur në lokal, apo këtë veprim e kishte ndërmarrë për të shmangur sulmin e tani të ndjerit ndaj të akuzuarit B.B.. Tutje për gjykatën rezultoi të jetë kontestuese veprimet e të akuzuarit B.B. se a kishte kryer veprën penale në bashkë kryerje i akuzuari B.B. me të akuzuarin B.B. kur ishte privuar nga jeta tani i ndjeri U.D., pra cilat ishin veprimet e tija, po që se i njëjti ka kryer veprën penale të vrasjes ashtu siç e ngarkon prokuroria, e kishte ndihmuar të akuzuarin B.B. në kryerjen e veprës penale të vrasjes siç e kishte gjykuar shkalla e parë herën e parë, apo nuk kishte kontribut fare në kryerjen e veprës penale të vrasjes, apo kishte kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor siç e kishte gjykuar shkalla e parë për herën e dytë, apo i njëjti nuk ka kryer fare veprë penale siç pretendon mbrrotja.

Arsyetimi i aktgjykimit fillimisht do të trajtoj faktet kryesore që kanë të bëjnë vetëm me dispozitivin I të akuzës pra duke argumentuar provat që kanë të bëjnë me veprën penale të vrasjes, ndërsa sa i përket veprave penale të armëmbajtjeve do të trajtohen në mënyrë të ndarë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Para se kjo gjykatë të trajtoj faktet kontestuese dhe elaborimin e të gjitha provave një nga një, të gjithave sbashhku dhe nxjerjen e perfundimeve, kjo gjykatë specifikon faktin se Prokurorori i shtetit në aktakuzë i ka konstatuar si të dëmtuar, E.Q. dhe S.A. duke konstatuar se të njëjtit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, por prokurori i shtetit asnjëherë nuk ka ngritur aktakuzë ndaj ndonjërit prej të akuzuarve se kanë kryer veprë penale të Lëndimit të lehtë trupor, ku Gjykata e Apelit e përmend edhe këtë fakt në vendimet e anuluar. Tutje edhe kjo gjykatë kishte shpallur fajtor të akuzuarin B.B. për veprë penale të lëndimit të lehtë trupor para se gjykata e Apelit ta prishte përsëri rastin.

Andaj vazhdimi i arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe nxjeraja e përfundimeve i përket vetëm objektit të akuzës, respektivisht veprave penale për të cilën janë akuzuar tani të akuzuarit, ndërsa për pjesën e lëndimeve trupore që u janë shkaktuar të dëmtuarve, gjykata në fund të këtij aktgjykimi do të jap arsyet se pse nuk është lëshuar fare në këtë pjesë sa i përket lëndimeve trupore të të lartcekurve.

#### Faktet kontestuese

Lidhur me faktet kontesutese, se cili ishte qëllimi i të akuzuarit B.B. B.B. që privoju nga jeta tani të ndjerin U.D., se a e privoju nga jeta për shkak të problemit që kishte ndodhur në lokal, apo këtë veprim e kishte ndërmarrë për të shmangur sulmin e tani të ndjerit ndaj të akuzuarit B.B., po ashtu për të determinuar veprimet e të akuzuarit B.B. se a kishte kryer veprën penale në bashkë kryerje i akuzuari B.B. me të akuzuarin B.B. kur ishte privuar nga jeta tani i ndjeri U.D., pra cilat ishin veprimet e tija, po që se i njejt ka kryer veprën penale të vrasjes ashtu siç e ngarkon prokuroria, e kishte ndihmuar të akuzuarin B.B. në kryerjen e veprës penale të vrasjes siç e kishte gjykuar shkalla e parë herën e parë, apo nuk kishte kontribut fare në kryerjen e veprës penale të vrasjes, apo kishte kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor siç e kishte gjykuar shkalla e parë per herën e dytë, apo i njejt nuk ka kryer fare vepër penale siç pretendon mbrotja, kjo gjykatë në vijm do të jap arsye se si e ka trajtuar gjykata çdo provë veç e veç, cilës provë ja ka falur besimin dhe cilës jo dhe arsyet mbi këto shkaqe, e po ashtu do të nxjeren përfundimet në lidhsmëri të të gjitha provave sëbashku.

Përgjatë arsyetimit të aktgjykimit, përveç se do të trajtohet secila provë veç e veç, gjykata do ti jap theks të veçantë rekomandimve të Gjykatës së Apelit ku kjo gjykatë vë theks të veçant në faktin se në vendin e ngjarjes janë gjetur tri lloje të gzhøjave dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye se cilat armë në çfarë forme janë përdorur dhe këto kundërthënje pamundësojnë nxjerrjen e konkludimeve të sakta. Gjykata e Apelit ka rekomanduar gjykatën e shkallës së parë që në ri-gjykim të sqaroj pozitën e të dëmtuarit dhe shenjat të cilat i njejt ka psaur në fytyrë përtej plagëve vdekjeprurese. Po ashtu është kërkuar që të determinohet se sa armë janë përdorur në vendin e ngjarjes, e pastaj përsëri në ndërlidhje me gjitha provat të kosnatohet se kush kishte shtënë i pari me armën e zjarit, pozita e secilit të përfshirë në këtë rast e pastaj të nxirren konkludimet.

Kerkesat e tilla të Gjykatës së Apelit, kjo gjykatë do ti trajtoj në mënyrë të veçantë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata fillimisht do ti analizoj deklaratat e të gjithë dëshmitarëve një nga një.

Sa i përket deklaratës së përfaqësuesit së familjes së tani të ndjerit, i cili po ashtu ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit (dëshmitari A.D.) deklarata e tij nuk kishte ndonjë relevanc lidhur me rastin dhe provat e administruara, për faktin se i njëjti nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes dhe vetëm se është njoftuar për vdekjen e familjarit të tij, fakt ky jo-kontestues, andaj gjykata nuk do të lëshohet më tej në elaborimin e deklaratës se tije për faktin se nga deklarata e tije nuk mund të zbardhen çështjet kontestuese.

Kjo gjykatë ka analizuar me kujdes edhe dëshminë e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit E.Q. i cili për gjykatën, ka qenë dëshmitar i rëndësishëm për ta kuptuar rrjedhën e ngjarjes por edhe për të determinuar momentet kritike. Fillimisht nga deklarata e të lartcekurit nënkuptohet arsyeja se pse kanë qenë natën kritike në vendin e ngjarjes të dëmtuarit dhe se arsyeja ka qenë që të festojnë bashkë me të ndjerin dhe shokë të tjerë lindjen e vajzës së tani të ndjerit. Tutje nga deklarata e të lartcekurit gjykata vërteton faktin se të gjithë personat që kanë qenë në këtë tavolinë është fjala për personat që kanë mbetur deri në momentin kritik kanë qenë shumë të dehur (gjë që gjykata zbeh edhe besueshmërinë e tyre për momentet kritike për faktin se edhe deklaratat e tyre nga deklarata në deklaratë kanë dallime substanciale). Dëshmitari E.Q. ka shpjeguar se pronari i lokalit duke iu referuar të akuzuarit B.B. ka qenë disa here te tavolina e tyre. Një fakt tjetër me rëndësi që gjykata arrin të vërtetoj nga dëshmia e dëshmitarit E.Q. është fakti se dëshmitari E.Q. bashkë me tani të ndjerin U.D. kanë qenë edhe herë të tjera në këtë lokal dhe madje kanë qenë edhe të mirëseardhur dhe se me pronarin e lokalit tani të akuzuarin B.B. kanë pasur raporte të mira pasi siç ka shpjeguar dëshmitari kur ka pasur më pak mysafir, i akuzuari B.ka shkuar e edhe

ka qëndruar në tavolinë me ta madje i ka qarrosur edhe me pije. Një fakt i tillë nënkupton faktin se të akuzuarit dhe të dëmtuarit nuk kanë pasur raporte armiqësore mes vete, përkundrazi kanë pasur raporte të mira dhe se gjithçka që ka ndodhur natën kritike ka ndodhur aty për aty. Dëshmitari më tej shpjegon se para daljes nga lokali ka qenë në banjo dhe kur është ofruar tek tavolina e ka parë tani të ndjerin U.D. dhe të akuzuarin B.B. duke biseduar dhe i është afruar të akuzuarit B.B. dhe e ka pyetur a ka ndonjë problem dhe se i njëjti i është përgjigjur se nuk ka asnjë problem dhe vetëm bëjani pagesën dhe dilni jashtë. Tutje deklarata e dëshmitarit E.Q. pikërisht në momentet kritike fillon të ketë ndryshime, sepse në disa deklarata thekson se kanë filluar të dalin bashkë me B.B.in dhe U. dhe se ata dy kanë qenë para tij ndërsa ky mbas, ndërsa në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes thekson se i pari ka qenë vetë dëshmitari dhe mbrapa tije ka qenë i akuzuari B.B. ndërsa fare nuk e përmend të akuzuarin B.B. se ka parë ndonjë veprim të tij, ndërsa në deklaratat e më hershme kishte deklaruar se e ka parë të akuzuarin B.B. se e ka shty me dorë të dëmtuarin U. ndërsa pastaj edhe në shqyrtim gjyqësor edhe në dy ri-konstruimet e vendit të ngjarjes shpjegon se ky ka qenë i pari dhe si ka dalë nga dera e lokalit i ka dëgjuar krismat me armë dhe se ka qenë i akuzuari B.B. që ka pas një armë të bardhë në dorë ku e ka goditur me kondak të armës dhe se dëshmitari ka ikur nga vendi ngjarjes dhe nuk di asgjë tjetër. Fakti i armës së bardhë gjene kontradikta mes deklaratës së dëshmitarit E.Q. dhe dëshmitarit tjetër S.A. i cili po ashtu thekson se e ka parë një armë të bardhë por atë e ka pasur në dorë i akuzuari B.B. B.B. ndërsa i akuzuari B.B. ka pasur një stupc në dorë, që rezulton pastaj jo kontestuese, sepse i njëjti stupc është gjete edhe në vendin e ngjarjes dhe një fakt të tillë e ka pohuar edhe i akuzuari B.B.. Nga deklaratat e dëshmitarit E.Q. po ashtu vërtetohet fakti se tani i ndjeri U.D. po ashtu ka qenë i armatosur.

Me deklaratën e dëshmitarit E.Q., gjykata ka arritur ta vërtetoj-kuptoj rrjedhën e ngjarjes, por momentet kritike se kush ka shtënë dhe se për çfarë arsye, gjykata nuk ka arritur të vërtetoj këtë fakt, e as tezen e akuzës se të akuzuarit e kanë marrë të ndjerin U. e kanë nxjerrë jashtë duke e rrahur e pastaj e kanë ekzekutuar, një fakte të tillë gjykata nuk e kupton se nga e ka ndërtuar prokuroria dhe një fakt të tillë në asnjë moment nuk e thotë dëshmitari i lartcekur.

Kjo gjykatë duke trajtuar deklaratën e të dëmtuarit- dëshmitarit S.A. ka vërtetuar edhe një here faktin tani të pa-kontestueshëm se i ndjeri ishte me shokët e tij duke festuar lindjen e vajzës së tij. Dëshmitari S.A. fillimisht në deklaratat e tij ka specifikuar se e ka parë njërin nga të akuzuarit ta ketë kapur për dore të ndjerin U.për të dalë jashtë ndërsa vet dëshmitari ka shkuar për ta bërë pagesën dhe pastaj ka dëgjuar krisma armësh dhe se duke dalë nga lokali një person shtatgjate duke iu referuar të akuzuarit B.B. e ka goditur me stupc të bejsbollit dhe se dëshmitari e ka humbur vetëdijen. Tutje siç u specifikua edhe më sipër në deklaratat e tij të mëhershme i njëjti dëshmitar ka specifikuar se e ka parë të akuzuarin B.B. B.B. me një armë të bardhë në dorë.

Në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes dëshmitari S.A. ka specifikuar se ka qenë aç shumë i dehur natën krikë sa që nuk i kujtohet asgjë dhe se vetëm e din faktin se kur ka dalë nga dera dikush e ka goditur me stupc të bejsbollit.

Në vështrim të deklaratave të dëshmitarit të lartcekur, përsëri nuk mund të vërtetohet faktet se si ka ndodhur momenti kritik i gjuajtës me armë e po ashtu deklarata e dëshmitarit zbeh besimin e tij për faktin se vet dëshmitari specifikon se ka qenë aç i dehur sa nuk i kujtohet asgjë e që lidhet edhe një here me faktin se personat që ishin duke festuar në këtë tavolinë ishin shumë të dehur për çka ishte edhe zanafilla e problemit. Krahasimi i deklaratave të këtij dëshmitari në përputhje me provat tjera do të trajtohet përsëri për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi. Megjithatë kjo gjykatë edhe një here ri-përsërit faktin se edhe në shqyrtime gjyqësore edhe në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes dëshmitari i lartcekur nuk specifikon se e ka parë dikë ta ketë kapur për dore të ndjerin e as që ka parë as edhe një problem, madje i njëjti kishte deklaruar se kam qenë aç i dehur sa nuk mbaj mend asgjë dhe se sa do pyetje që të më parashtrihen mua përsëri nuk më kujtohet asgjë, andaj nga deklarata e të lartcekurit gjykata në asnjë moment nuk gjen bazë për të

mbështetur pretendimet e prokurorisë, respektivisht përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të dispozitivit I të aktakuzës.

Në kuptim të provave të drejtpërdrejta, respektivisht dëgjimit të dëshmitarëve të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes e që kanë qenë dëshmitar okular, gjykata si provë veçanërisht të rëndësishme e cruciale për zbardhjen e të vërtetës e morri për bazë deklaratën e të dëmtuarit A.S. në cilësinë e dëshmitarit. Dëshmitari A.S. kishte qenë në lokalit ku kishte ndodhur ngjarja bashkë me shokun e tij E.K. dhe nuk kishte të bënte as me të dëmtuarit e as me të akuzuarit. I njëjti shpjegon se i kishte përballë tavolinën e të dëmtuarve e po ashtu shpjegon se vërehej se ata kishin një festë pasi që edhe muzika e lokalit këndonte për atë tavolinë dhe se aty në atë tavolinë thaheshin gota dhe shihe. Dëshmitari shpjegon rrjedhën e ngjarjes se e kishte parë se pronari i lokalit tani i akuzuari B.B. kishte shkuar disa here tek ajo tavolinë për të kërkuar që të njëjtit të qetësohen. Tani kjo deklaratë e dëshmitarit A.S. lidhet me vet deklaratat e të dëmtuarve E.Q. e S.A., E.SH. që specifikojnë faktin se kanë qenë shumë të dehur e që rezultoi të jetë zanafilla e problemit. Nga deklarata e dëshmitarit A.S., gjykata arrin të fillon të zbardhë edhe momentet kritike, ku dëshmitari shpjegon se për shkak se në tavolinën ku qëndronte i dëmtuari kishte probleme kjo ishte edhe arsyeja pse e shihte situatën, sepse ia tërheqte vërejtjen dhe shton se pasi që disa here pronari i lokalit B.B. ua kishte tërheqë vërejtjen e ka vërejtur se për një moment këngëtarja ka ndalur muzikën dhe ka ikur nga bina por nuk e ka ditë se çka ka ndodhur. Në ato momente përsëri ka shkuar i akuzuari B.B. dhe atëherë dëshmitari e ka vërejtur se diçka nuk është në rregull dhe ka filluar të dalë jashtë. Dëshmitari ka parë thajse të gjitha momentet kritike të rrjedhës së ngjarjes që zbardh të vërtetën se po që se të akuzuarit B.B. dhe B.B. B.B. e kishin nxjerrë me dhunë jashtë të akuzuarin dhe pastaj e kanë ekzekutuar siç pretendon prokuroria apo rrjedha e ngjarjes ishte ndryshe. Dëshmitari shpjegon se ka dëgjuar të akuzuarin B.B. duke i thënë tani të ndjerit U. se bëjeni pagesën dhe dilni jashtë, që gjen përputhje të plotë edhe me deklaratën e dëshmitarit E.Q., por më tej dëshmitari nuk e ka dëgjuar bisedën. Nga deklarata e dëshmitarit tutje vërtetohet fakti më me rëndësi në këtë çështje në bindjen e kësaj gjykate, respektivisht vërtetohet fakti se si kanë dalë jashtë i akuzuari B.B. dhe tani i ndjeri U.D.. Dëshmitari shpjegon se rrugës për të dalë tek dera nuk kishte pasur asnjë incident dhe se kur kanë arritur tek dera për të dalë jashtë, dera e lokalit ishte e bllokuar dhe se B.B.i ka qenë tek dera dhe se ka qenë tani i ndjeri U. cili ka kërkuar nga B.B.i që të dalin jashtë dhe se kishte qenë pikërisht i akuzuari B.B. i cili kishte refuzuar një gjë të tillë dhe pasi që dëshmitari kishte kaluar nga dera ku B.B.i kishte refuzuar të dalë jashtë me tani të ndjerin Urim deri sa dëshmitari A.S. tani kishte arritur vetëm ti kaloj shkallët e para e që nga rikonstrimi i vendit të ngjarjes vërehet se është çështje pak sekondash, rezultoi se kanë filluar krismat e armës me ç' rast është plagosur edhe vet i dëmtuari A.S..

Nga kjo deklaratë e dëshmitarit rezultoi se nuk ka pasur ndonjë zënkë apo rrahje paraprake mes të akuzuarve dhe të ndjerit ashtu siç pretendon prokuroria dhe se gjithçka ka ndodhur në pak sekonda. Fakti se dëmtimet tjera të dëshmitarit që kanë qenë në fytyrë nuk janë rezultat i përleshjes, por rezultat i përplasjes me fytyrë për toke pas goditjes me armë e ka determinuar edhe Dr.Arsim Gërxhaliu ekspert i mjekësisë ligjore, konstatimet e të cilit do të elabrohen edhe më vonë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi. Po ashtu vendi se ku është goditur me armë i dëmtuari A.S. vërehet qartë trajektorja e plumbave që i ka shkrepur i akuzuari B.B. në drejtim të të ndjerit, e me ç' rast është plagosur edhe tani i dëmtuari A.S.

Gjykata ia fali në tërësi besimin deklaratës së këtij dëshmitari për dy arsye. Së pari deklaratat e tij nuk gjenin shpërputhje me njëra tjetrën ashtu siç ka ndodhur tek dëshmitaret E.Q. e S.A., e po ashtu për faktin se e vetmja kjo deklaratë mund të lidhet me hallkën zingjirore të provave në mënyrë të pa-shkëputur për të nxjerrë kronologjinë e saktë të rrjedhës së ngjarjes dhe nxjerrjen e konstatimeve edhe me provat e tjera. Siç u tha edhe më sipër kronologjia e ngjarjes e shpjeguar nga dëshmitari A.S. gjen përputhje me deklaratën e dëshmitarit E. deri tek momenti kritik, e kjo

deklaratë e tij gjen përputhje edhe me konstatimet e ekspertit mjeko ligjor që nuk kishte pasur ndonjë përleshje para se të gjuhen me armë. Tutje deklarata e dëshmitarit A gjene përputhje edhe me deklarinimin e dëshmitares që është dëgjuar në ri-konstruimin e dytë të vendit të ngjarjes, dëshmitarja Kadensha Ferati, ku kishte specifikuar se tani i ndjeri U.D. e ftonte me dorë të akuzuarin B.B. që të dalin jashtë lokalit dhe se B.B. nuk kishte dashur të dalë, gjë që e specifikon dëshmitari A ku e ka dëgjuar të ndjerin U duke i thënë tani të akuzuarit B.B. se të dalin jashtë dhe ai kishte refuzuar duke i thënë se nuk dal dhe pas pak sekondave kishin ndodhur të shtënat me armë.

Deklarata e dëshmitarit A.S., gjen përputhje edhe me deklarinimet e vet të akuzuarve në stadet e ndryshme të procedurës, ku edhe vet i akuzuari B.B. specifikon se ka qenë pikërisht tani i ndjeri që e ka ftuar të dalin jashtë dhe se ky ka hezitur të dalë por kur ai ka insistuar i është afruar dhe aty ka filluar gjithçka.

Andaj mbi bazën e përputhshmërisë së deklaratës së dëshmitarit A me provat tjera, gjykata ia ka falur besimin këtij deklarinimi dhe përmes këtij deklarinimi ka arritur edhe të ndërtoj në përpikëri rrjedhën e ngjarjes për çka do të arsyetohet edhe njëherë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi në nxjerrjen e konkludimeve.

Gjykata me kujdes ka analizuar edhe deklaratën e dëshmitarit E.K. i cili ka qenë në shoqëri me të dëmtuarin – dëshmitarin A.S. Për dallim nga dëshmitari A dëshmitari E. nuk është që ka dhënë ndonjë kontribut të posaçëm në zbardhjen e fakteve të pa kontestueshme, sepse i njëjti ka qenë i kthyer me shpinë dhe se nuk është se e ka parë gjithë rrjedhën e ngjarjes, andaj nga deklarata e dëshmitarit E.K. vetëm është ri-konstatuar fakti se e ka vërejtur se muzika është ndalur dhe atëherë e ka kuptuar se diçka nuk është në rregull dhe kanë filluar të dalin jashtë me shokun e tij A.S. dhe në atë moment ka dëgjuar disa krisma dhe A. i ka thënë se mu ka nxe trupi, pra të njëjtin e kishte goditur plumbi dhe e ka marrë e ka hip në veturë dhe e ka dërguar në spital. Pra nga kjo deklaratë edhe një here vërtetohet fakti se nga gjuajtja me armë është plagosur edhe i dëmtuari A.S. por nuk vërtetohen asnjë nga pretendimet tjera të akuzës.

Gjykata ka analizuar edhe deklaratën e dëshmitarit E.SH. i cili ka qenë natën kritike në shoqëri gjatë tërë ditës me tani të ndjerin U.D.. Dëshmitari, viktimën e kishte familjar dhe nga deklarata e tij vërtetohet fakti se E. dhe U. kshin filluar të konsumonin alkohol gjatë ditës në Prizren e pastaj kishin shkuar në një kafe në Lagjen e Muhaxherëve ku kishin vazhduar të pinin e festonin dhe pastaj kishin përfunduar në lokalin ku kishte ndodhur ngjarja. Vetë dëshmitari Ertan Shatri specifikon se ka qenë i dehur dhe nuk i kujtohet asgjë dhe se i ka parë personat vetëm kur kanë ikur nga lokali, por pa qenë në dijeni se çfarë ka ndodhur madje i njëjti specifikon se kur ka dalë nga lokali nuk e ka parë as viktimën ani pse i njëjti ka qenë i shtrirë në pragun e lokalit, e që nga deklarata e këtij dëshmitari mund të konkludohet vetëm niveli i dehjes që e kanë pasur i ndjeri Urim, si dhe dëshmitarët E., E. e S., andaj deklarata e dëshmitarit E. ishte jo kredibile dhe nuk zbardhi diçka tek momentet kritike, e aq më pak pretendimet e akuzës.

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh.R. i cili natën kritike ishte duke punuar si zëvendësimit në shank në lokalin ku kishte ndodhur ngjarja edhe njëherë ri-konfirmohet fakti se në tavolinën ku ishte duke qëndruar i ndjeri kishte pasur gota dhe shihe të thyera me ç'rast pronari i lokalit tani i akuzuar B.B. kishte shkuar tek ta që ti qetësoj. Po ashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari është vërtetuar fakti se dikush nga personat që kanë qenë në atë tavolinë ka pasur armë e ku një fakt i tillë gjene mbështetje edhe në deklaratën e dëshmitares së ftuar në ri-konstruimin e dytë të vendit të ngjarjes, dëshmitares K.F. e cila po ashtu specifikon se ka parë persona të armatosur në atë tavolinë, respektivisht njëri nga ata persona ka lëvizur në këmbë dhe ka mbajtur dorën brenda në jakne duke aluduar se kishte armë. Nga kjo deklaratë e dëshmitarit që gjen mbështetjet edhe tek deklarata e dëshmitares K., edhe një here vërtetohet fakti se si kishte ardhur deri tek momenti,

kur pronari i lokalit B.B. ishte detyruar të shkonte te tavolina e të ndjerit dhe të kërkonte nga i njëjti që ta lironin lokalin. Nga deklarata e këtij dëshmitari në asnjë moment nuk ka ndonjë fragment që mund të nxirret nga i cili mund të konkludohet rrjedha e ngjarjes ashtu siç e përshkruan prokurori i shtetit në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktakuzës.

Sa i përket deklaramit të dëshmitarit S.S., kjo gjykatë edhe pse të njëjtën e ka administruar si provë, në bindjen e kësaj gjykate kjo deklaratë nuk ka asnjë relevancë lidhur me ngjarjen kritike dhe momentet kritike, për faktin se edhe pse dëshmitari S. ka qenë së bashku me të ndjerin natën kritike, i njëjti është larguar më herët nga tavolina – ndeja, për në shtëpi, andaj nuk ka qenë në dijeni se çfarë kishte ndodhur për faktin se deri sa i njëjti kishte qenë duke qëndruar me të ndjerin Urim dhe të tjerët nuk kishte pasur asnjë problem, andaj i njëjti nuk ka qenë në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur incidenti dhe rrjedhimisht nuk pati ndonjë rëndësi në vendosjen e kësaj çështje penale, e aç më pak në pretendimet e prokurorisë së shtetit.

Sa i përket deklaramit të dëshmitarit V.S., gjykata konstaton se i njëjti ka qenë duke punuar natën kritike në vendin e ngjarjes dhe nga deklarata e tij edhe njëherë është ri-theksuar –vërtetuar fakti se në tavolinën ku ka qenë duke qëndruar tani i ndjeri ka pasur thyerje të gotave dhe shisheve. Dëshmitari përgjatë deklarimeve të tij ka pasur deklarata kontradiktore, sepse ndonjëherë ka thënë se tek tavolina e të ndjerit ka qenë vetëm i akuzuari B.B., ndërsa disa here ka thënë se aty kishte shkuar edhe i akuzuari B.B.. Tutje dëshmitari po ashtu në disa deklarata deklaroi se nuk ka dëgjuar të shtëna, ndërsa tutje deklaroi se deri sa ka qenë duke i kryer disa pagesa ka dëgjuar tri të shtëna. Por as nga ky dëshmitar gjykata nuk ka arritur të nxjerrë ndonjë konkludim për momentet kritike e aç më pak përderisa deklaratat e tija ishin kundërthënëse për momentet vendimtare, andaj deklarata e tij nuk kishte ndonjë përputhje me ndonjë provë tjetër nga e cila gjykata do të mund të gjente lidhshmëri për momentet kritike. Dëshmia e tij në asnjë moment nuk mbështet tezen e akuzës, respektivisht përshkrimin faktik të përpiluar nga prokurori i shtetit.

Gjykata duke trajtuar dëshminë e dëshmitarit F.J. po ashtu konstaton se i njëjti në deklaratat e tij të dhëna në gjitha stadet e procedurës ka specifikuar se në pozitën ku ka qenë i ulur duke bërë muzikë nuk ka parë asgjë vetëm e din se këngëtarja e ka lënë muzikën dhe se dëshmitari ka menduar se këngëtarët do të nderohen dhe ka vazhduar me muzikë e pastaj kur e ka vërejtë se këngëtarët nuk po nderohen atëherë e ka kuptuar se ka diçka problem dhe ka dëgjuar të shtëna armësh jashtë lokalit, e ka ndërpre muzikën dhe ka dalë jashtë pasi kanë dalë të gjithë dhe tek dera e lokalit ka parë një person të shtrirë në tokë. Andaj nga deklarata e dëshmitarit të lartcekur nuk është se zbardhet ndonjë fakt kontestues, por në as edhe një formë nga deklarata e të lartcekurit nuk mbështeten pretendimet e prokurorisë së shtetit.

Gjykata duke trajtuar dëshminë e dëshmitarit K.G. po ashtu konstaton se në tavolinën ku ka qëndruar tani i ndjeri kanë thyer gota dhe shishe dhe se ka qenë i akuzuari B.B. i cili ka shkuar disa here për tu ju tërhequr vërejtjen. Tutje dëshmitari po ashtu specifikon se deri sa ka qenë duke kryer disa pagesa ka dëgjuar disa të shtëna armësh dhe kur ka dalë jashtë ka vërejtur tek dera e lokalit një person të mbuluar me qarqaf. Siç mund të vërehet se edhe nga dëshmia e këtij dëshmitari nuk zbardhen çështjet kontestuese e as pretendimet e prokurorit të shtetit.

Gjykata ka analizuar edhe dëshminë e dëshmitares Xh. e cila ka qenë duke kënduar natën kritike. E njëjta ka specifikuar se i ka njohur personat në tavolinën e tani të ndjerit pasi për të njëjtit ka kënduar edhe më parë. E ka njohur të ndjerin U.D. e po ashtu edhe dy persona tjerë me nofkën “Carlli” dhe “Karagja”.

Dëshmitarja në fjalë ka sqaruar se e ka parë njërin nga ata persona duke drejtuar amën kah muzika dhe e njëjta e shqetësuar ka ikur në dhomën e paraparë për këngëtar dhe nga frika është alivanosur.

Nga dëshmia e dëshmitares së lartcekur vërtetohet edhe njëherë fakti se personat e ulur në tavolinën ku ka qenë tani i ndjeri, por edhe i ndjeri kanë vizituar edhe here të tjera lokalit në fjalë që rezulton se nuk kanë pasur asnjë problem paraprak apo të keqe me pronarin e lokalit gjë që ndërlidhet edhe me deklaratën e dëshmitarit E. që ka specifikuar se në këto lokal kanë shkuar edhe here të tjera dhe se kanë pasur raporte shoqërore me pronarin e lokalit B.B.n. Nga deklarata e dëshmitares po ashtu rikonfirmohet edhe njëherë fakti se personat në këtë tavolinë kanë qenë të armatosur gjë që është specifikuar edhe nga dëshmitarët e lartcekur e ku për këtë shkak ka filluar edhe të tensionohet situata, sepse këngëtarja është frikësuar kur e ka parë armën në drejtimin e saj dhe ka ndalur muzikën, gjë që ndërlidhet edhe me deklaratën e dëshmitares K. e po ashtu edhe me deklaratën e dëshmitarit A.S.

Lidhshmëria e deklaratave të dëshmitareve në vështrim të zbardhjes së gjendjes faktike do të ipet edhe në konkluzionet e kësaj gjykate.

Për gjatë ri-konstruimit të dytë të vendit të ngjarjes, gjykata kishte dëgjuar edhe dëshmitaren K.F., e cila kishte qenë prezent natën kritike. Nga deklarata e dëshmitares K. edhe njëherë rikonfirmohet fakti se në tavolinën ku kishte qëndruar i ndjeri, pa ndërprerë ishin thyer shishe dhe gota, ndërsa një person që qëndronte në këmbë sillej rreth tavolinave të mysafireve e po ashtu kishte diçka brenda jaknes dhe në ato momente ishte këngëtarja Xh. që kishte bërë titur dhe ka lëshuar mikrofonin dhe kishte thënë a e patë se ke tu me vra dhe kishte ikur nga skena. Edhe nga kjo dëshmi e dëshmitares K. e që është në përputhje me dëshminë e dëshmitares Xh rezulton dhe vërtetohet fakti se deri tek zanafilla e problemit ka ardhur për shkak problemeve që i kanë krijuar personat e ulur në tavolinë bashkë me tani të ndjerin U. ardhur deri tek momenti kur pronari i lokalit tani i akuzuari B.B.B. ka kërkuar nga ata që ta bëjnë pagesën dhe ta lirojnë lokalit.

Tutje dëshmitarja K. thekson se ka dëgjuar krismat por nuk e ka vërejtur se kush kënd e ka gjuajtur me armë. Edhe nga kjo deklaratë e dëshmitares e cila ka parë rrjedhën e ngjarjes deri kur i ndjeri U. dhe i akuzuari B.B. kanë dalë jashtë nuk vërtetohet teza e akuzës se të njëjtit janë përleshur mes vete. Tutje një fakt shumë me rëndësi që gjykata ka vërtetuar me rastin e dëgjimit të kësaj dëshmitare rezulton fakti se deklarata e saj gjen mbështetjet të plotë me deklarinimin e të dëmtuarit-dëshmitarit A.S. e po ashtu edhe me deklarinimin e të akuzuarit B.B., se ka qenë tani i ndjeri U. ka kërkuar nga i akuzuari B.B. që të dalë jashtë. Në ri-konstruim të vendit të ngjarjes dëshmitarja K. ka shpjeguar se si i ndjeri U. është ndalë tek dera e lokalit duke ia bërë me dorë – thirre me dorë të akuzuarin B.B. që të dalë jashtë. Deklarimi i dëshmitares K. ka qar në bindjen e kësaj gjykate që ka qenë i ndjeri U. që e ka ftuar të akuzuarin B.B. që të dalë jashtë dhe po sa i njëjti ka dalë jashtë i ndjeri Urim ka shtënë në drejtim të tij gjë që është ndërlidhur edhe me deklarinimin e dëshmitarit H. B. i cili e ka parë të ndjerin Urim duke ecur dhe duke e mbajtur dorën brenda jaknës së tij e ku është vërejtur që ka pasur diçka e që pastaj këto prova ndërlidhen edhe me provat materiale nga të cilat rezulton se tani i ndjeri Urim ka shtënë nga brenda jaknes së tij në drejtim të tani akuzuarit B.B..

As dëshmia e dëshmitares K. në asnjë formë nuk vërteton pretendimet e prokurorit të shtetit përkitazi me përshkrimin faktik të dispoizivit të akuzës.

Për gjatë ri-konstruimit të vendit të ngjarjes, gjykata kishte dëgjuar edhe dëshmitarin H.B. i cili kishte qenë si mysafir në vendin e ngjarjes bashkë me djalin e tij. Dëshmitari për gjatë ri-konstruimit të vendit të ngjarjes edhe një here ka specifikuar faktin që e kanë specifikuar edhe dëshmitaret e tjerë dhe pa mëdyshje vërtetohet fakti se në tavolinën ku ka qëndruar i ndjeri U.D. ka pasur thyerje të mëdha të gotave dhe shisheve dhe ka qenë i akuzuari B.B. që së paku tri here ka shkuar tek tavolina e tyre për të kërkuar që të qetësohen. Më tej nga dëshmia e dëshmitarit

rezulton se edhe i ndjeri U.D. kishte armë me vete ku dëshmitari e ka parë të njëjtin se është quar në këmbë dhe ka shti dorën në xhep dhe është vërejtur se brenda ka një armë. Siç u theksua më sipër deklarimi i dëshmitarit H. gjene përputhje të plotë me provat materiale nga të cilat është konstatuar shkrepja me armë nga i ndjeri U e po ashtu kjo deklaratë përputhet edhe me deklarimin e tani të akuzuarit B.B..

Megjithatë nga dëshmia e dëshmitarit edhe pse vërtetohet edhe një here fakti se çfarë kishte ndodhur për brenda lokalit, dëshmitari vetëm ka dëgjuar krismat e armëve, por nuk e ka parë se kush, në drejtim të kujt ka shtënë, andaj as dëshmia e këtij dëshmitari nuk shkon në favorin e akuzës.

E një rëndësie të veçantë në zbardhjen e rrjedhjes se ngjarjes dhe konstatimit të gjendjes faktike ishte pa dyshim deklarimi i Ekspertit Ilir Ukaj i cili kishte sqaruar se arma prej të cilës është shtënë në të ndjerin ka qenë në distancë 30-50 cm. Eksperti ka treguar se numri i saktë i gëzhjave dhe predhave të sjellura për ekspertimë në AKF, janë në raportin e ekspertimit balistik me nr. AKF/2015-1094/2015 -932, i dt. 15.05.2015, dhe janë: një gëzhoje e kalibrit 7.65x17mm, e evidentuar me shifrat VN#9, VN#10, VN#11, VN#13, VN#20, pastaj 4 predha të evidentuara me shifra VN#14, VN#15, UD#1 dhe U#2.2, si dhe një xhakëtë apo këmishëz e predhës dhe një bërthamë predhe, të evidentuara me shifrat A.S#1. Sipas ekspertit në vendin e ngjarjes janë përdorur 3 armë prej të cilave dy kanë qenë të kalibrit 9x19mm, dhe njëra ka qenë 7.65x17mm, ku ka konstatuar se janë dorëzuar vetëm dy armë, ndërsa arma e kalibrit 7.65x17mm, e fiksuar me shifrën VN#2, ku sipas skicës së vendit të ngjarjes është gjetur gëzhoja në oborrin e lokalit, nuk është dorëzuar për ekzaminim. Eksperti ka shtuar se në tani të ndjerin Urim, është shkrepur me armë gjysmë automatike “Ceska Zbrojovka” model 75, me nr. serik 154865, e fiksuar me shifrën B.B#1 . Në dy predhat që janë gjetur në trupin e tani të ndjerit të evidentuara në dëshmitë U.2 #1 dhe U.2#2, janë shkrepur nga arma e cekur më lartë. Personi i cili ka shtënë me armë me të cilën është shkrepur gëzhoja e fiksuar me shifrën VN#2, ka qenë jashtë në oborrin e lokalit në një distancë rreth 1 m. Eksperti ka sqaruar se bazuar në procesverbalin e vendit të ngjarjes dhe fotografive, se gëzhoja e kalibrit 9x19mm, evidentuar me shifrën VN#13, ka qenë pranë trupit të tani të ndjerit.

Nga deklarimi i lartcekur i ekspertit fillimisht konstatohet se plagët e marra tani i ndjeri i ka marrë nga me armë gjysmë automatike “Ceska Zbrojovka” model 75, me nr. serik 154865 e që është tani jo-kontestuese se nga kjo armë ka shkrepur tani i akuzuari B.B. B.B..

Tutje nga deklarimi i ekspertit te lartcekur te cilën i njëjti e ka shpjeguar edhe në ri-konstruimin e dytë të vendit të ngjarjes rezulton se arma tjetër që ka shkrepur ka qenë arma që është shkrepur nga brenda i xhepit të jaknës së viktimës dhe ka rezultuar të gjendet afër trupit të tij. Fakti se viktima ka pasur armë me vete rezulton të jetë e pa kontestueshme qoftë nga provat personale-deklarimet të dëshmitarëve, qoftë nga provat materiale dhe vet deklarimi i ekspertit.

Siç u pa nga deklarimi i ekspertit, në deklaratat e tij në shqyrtimet gjyqësore, i njëjti në deklarimet e më hershme, por edhe në ekspertizë kishte konstatuar se në vendin e ngjarjes janë gjetur tri lloje të gëzhjave, e që rrjedhimisht rezultonte se janë përdorur tri armë.

Në vërejtjet e Gjykatës së Apelit për të cilën ishte prishur rasti herën e dytë dhe ishte kthyer në ri-gjykim, njëra nga vërejtjet kryesore ishte të determinohet fakti se sa armë janë përdorur në vendin e ngjarjes dhe se çka ka ndodhur me armën e tretë e cila nuk është gjetur në vendin e ngjarjes.

Për këto qëllime në gjykimin e tretë, respektivisht pasi që gjykata e Apelit e kishte kthyer për herë të dytë rastin për r-gjykim në shkallën e parë, gjykata kishte ftuar përsëri ekspertin Ilir Ukaj për të dhënë sqarime lidhur me gëzhjën e armës e cila nuk është gjetur.



Eksperti Ilir Ukaj ka dhënë sqarime të nevojshme dhe të mjaftueshme për gjykatën, duke konstatuar se nga përvoja e tij profesionale, gëzhoja e gjetur në oborrin e lokalit pra më larg se ku kishte ndodhur vrasja, kishte qenë një gëzhoje e pluhurosur dhe nga këndvështrimi i tij profesional rezulton se ajo armë nuk është përdorur natën kritike, por është përdorur më herët, sepse gëzhoja ka qenë e vjetruar dhe e ndryshkur dhe nuk përkon me mundësinë që të jetë shkrepur natën kritike.

Nga ky sqarim i ri i ekspertit i dhënë në shqyrtimin gjyqësor, kjo gjykatë ka hequr dilemën e parë të cilën e ka ngritur Gjykata e Apelit se sa armë janë përdorur në vendin e ngjarjes dhe se kush e ka përdorur armën e gëzhojës së tretë.

Tani nga sqarimet e lartcekura të ekspertit, gjykata ka nxjerrë konkludimin se në vendin e ngjarjes, në natën kritike janë përdorur vetëm dy armë dhe atë arma që e ka përdorur i akuzuari B.B. B.B. dhe arma që e ka përdorur tani i ndjeri U.D. duke hequr kështu përfundimisht dilemat po që se është përdorur ose jo ndonjë armë e tretë, pasi që gëzhoja e tretë e gjetur në oborrin e lokalit nuk rezulton se është shkrepur natën kritike. Andaj nga deklarimi i ekspertit, gjykata përfundimisht ka nxjerrë përfundimin dhe ka vërtetuar faktin se natën kritike janë përdorur vetëm dy armë.

Gjykata tutje ka analizuar deklaramet e ekspertit mjeko ligjor, Dr.Arsim Gëxhaliu. Sqarimet e zgjeruara te ekspertit janë të përshkruara në arsyetimin e këtij aktgjykimi, ndërsa edhe më të zgjeruara gjinden në procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, ndërsa sqarimet e tij i njëjti i ka dhënë edhe për gjatë-rikonstruimit te vendit te ngjarjes. Tani nuk është kontestuese se si ka ardhur deri tek vdekja e tani të ndjerit, por gjykata tani do të arsyetoj vetëm mbi vërejtjet që i kishte evidentuar Gjykata e Apelit. Gjykata e Apelit kishte kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të determinohen edhe shenjat tjera që janë gjetur në trupin e të dëmtuarit, por edhe shenjat në fytyrën e tij për të determinuar faktin se a kishte pasur përleshje mes të akuzuarve dhe të dëmtuarve para se i dëmtuari të goditej me armë zjarri.

Në bindjen e kësaj gjykate, sqarimet e tilla i ka dhënë eksperti i cili lidhur me këtë çështje ka sqaruar si vijon: Çdo ndryshim në organizëm paraqet dëmtim, por nëse pyetni për etiologjinë e saj, e njëjta ka të bëjë si dëmtim i cili mund të jete si pasojë e veprimit të armës e cila është përdorur në atë moment. Ndryshimet sipërfaqësore në pjesën e shikuar të shalës së hundës janë gërvishtje të shprehura me minus epidermë si dhe dy skuqjet në pjesën ballore që gjithashtu i përkasin pjesëve më të shqitura të kokës, nuk janë të shkaktuara nga ndonjë goditje, por si pasojë e ramjes në dysheme, me siguri e cila nuk ka qenë në interesin e përshkrimit të tërthortë sikurse është bërë përshkrimi i plagëve, i predhave.

Nga sqarimi i lartcekur i ekspertit rezulton i qartë fakti se viktimia nuk ka pasur asnjë dëmtim para se të goditet me armë dhe gjitha dëmtimet sipërfaqësore janë shkaktuar nga arma e zjarrit dhe dëmtimet tjera në pjesën ballore të fytyrës i janë shkaktuar kur ka rra në dysheme.

Një fakt tjetër qe po ashtu ka qenë kërkesë e Gjykatës së Apelit, ka qenë të determinohet pozita e viktimës se pse i njëjti ka qenë në pozitë të krysur.

Sa i përket pozitës së krysur, eksperti mjeko ligjor nuk ka mundur ta determinoj ne mënyre eksplicite se pse ka qenë në formë të krysur, por në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes duke u ndërlidhur edhe me provat e tjera, respektivisht deklaramet edhe të të akuzuarve rezulton se tani i ndjeri ka gjuajtur me armë në drejtim të të akuzuarit B.B. të cilët kanë qenë afër njëri tjetrit dhe i akuzuari B.B. ka kcyer dhe është kapë për arme me të ndjerin për çka të njëjtit kanë rra gati në gjunjë (të kapur për arme) e që nxirret edhe përfundimi se pozita e krysur e të ndjerit ka ardhur si pasojë kur i ndjeri dhe i akuzuari B.B. janë kapur për arme dhe kanë qenë duke rënë për toke. Lidhur me këtë konkludim gjykata do ta trajtoj edhe njëherë në lidhshmëri me gjitha provat. Po ashtu nga deklarimi i ekspertit është vërtetuar fakti se distanca mes të akuzuarit B.B. B.B. i cili ka gjuajtur me armë në tani të ndjerin U.D. ka qenë më pak se 1 meter dhe tyta e armës ka qenë gati pshtetur me trupin e të ndjerit dhe qitjet kanë qenë rafal në mënyrë të pa ndërprerë.

Nga deklarimi i sipër shënuar i ekspertit gjykata ka vërtetuar faktin se i ndjeri nuk ka pasur asnjë plagë tjetër përveç plagëve që ka marrë nga arma e zjarrit dhe se dëmtimet sipërfaqësore janë shkaktuar nga predhat, ndërsa dëmtimet në kokë janë shkaktuar kur i njëjti ka rënë në tokë, gjë që nuk vërteton pretendimet e prokurorisë se të njëjtit fillimisht janë përleshur e pastaj i ndjeri është ekzekutuar.

Sa i përket pozitës së krysur të të ndjerit, gjykata përfundimet e saja i nxjerrë vetëm kur gjene lidhshmëri prej provës në provë dhe në rastin konkret as një provë e vetme nuk ka qar në konkludimin se i ndjeri është rrahur paraprakisht dhe pozita e tij e krysur ka ardhur si pasojë e frikës ashtu siç ka pretenduar prokuroia, por gjykata kokludimin se si ka ardhur deri tek pozita e krysur e të ndjerit e ka nxjerrë nga provat tjera si si ka ardhur deri tek momenti që i akuzuari dhe i ndjeri të dalin jashtë, mbështetur në deklaratimet e dëshmitareve A.S. dhe K.F., e pastaj lidhshmëria me deklaratimet e të akuzuarve B.B. e B.B. B.B., kur është nxjerrë përfundimi se pozita e krysur e të ndjerit ka ardhur pasi që ai ka shkrepur fillimisht me arme e pastaj për armën e tij janë kapur i ndjeri dhe tani i akuzuari B.B..

Kjo gjykatë edhe në shqyrtimin gjyqësor edhe në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes ka dëgjuar edhe ekspertin e forenzikës Milazim Tahirukaj, i cili ka bërë ekzaminimin e gjaketës Armani të cilën e ka pasur të veshur tani i ndjeri. Nga këto ekzaminime ka rezultuar dhe është vërtetuar se arma të cilën e ka poseduar tani i ndjeri ka shkrepur nga brenda gjepit të tij të jankes dhe plumbi ka dalë jashtë, pra i njëjti ka shtënë nga brenda jashtë, gjë që ndërlidhet përsëri me deklaratimin e të akuzuarit B.B., por edhe me deklaratimin e dëshmitarit H.B. që e ka parë që i ndjeri e ka mbajtur dorën brenda jaknes dhe është parë që e ka doren në revole. Tutje nga eksperti i lartcekur i forenzikes është vërtetuar se edhe grimcat e barutit nga kjo armë kanë qenë në të dy duart e tani të ndjerit. Andaj nga deklarimi i ekspertit Milazim Tahirukaj vërtetohet se i ndjeri ka poseduar me vete armen natën kritike dhe të njëjtën e ka mbajtur në gjepin e brendshëm të jaknes ku nga ajo pozitë nga brenda jankes ka shkrepur me armen e tij nga brenda jashtë.

Gjykata duke analizuar provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht Nga raporti i këqyrjes në vendin e ngjarjes, i dt. 14.02.2015, si provë e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet se në fshatin Banullë Komuna e Lipjanit, në restorant “Agoni”, është konstatuar se ka ndodhur një rast vrasje, dhe është vërtetuar se viktima apo personi i vrarë në vendin e ngjarjes është i ndjeri U.D., i privuar nga jeta si pasojë e marrjes së plagëve nga arma e zjarrit. Po ashtu ky raport vërteton pozicionin e tani të ndjerit i cili ishte i shtrirë para derës hyrëse të katit të dytë të Restoranit “Agoni”. Nga ky raport vërtetohet edhe fakti se në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe prova tjera materiale, gëzhoja dhe disa predha të fishekëve, me të cilat është vrarë i ndjeri Urim, po ashtu nga i njëjti raport është vërtetuar se nga i akuzuari B.B. B.B. është konfiskuar pistoletë me nr. serik 154865, model 75, kalibri 9mm, 1 kalikator dhe 5 fishekë, po ashtu në vendin e ngjarjes është gjetur edhe shkopi i bejzbollit i cili është përdorur për të goditur të dëmtuarit.

Po ashtu në fotografitë për brenda lokalit ri-konstatohet edhe njëhere se tek tavolina e të dëmtuarve kishte shumë gota dhe shishe të theyra.

Tutje nga prova tjetër materiale e administruar në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht nga Raporti i ekspertizës balistike i dt. 15.05.2015, është nxjerrë dhe siguruar nga AKF, është vërtetuar se dëshmitë e gjetura në vendin e ngjarjes janë marrë për ekspertim dhe të njëjtat janë në përputhje të plotë me shënjestimin sipas raportit mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes. Është me rëndësi që të potencohet fakti se AKF, me rastin e ekzaminimit ka përdorur metoda dhe pajisje që janë të aprovuara nga AKF, është aplikuar procedura teknike standarde e operimit, duke përfshirë laboratorin e armëve të zjarrit, ekzaminimin fizik dhe klasifikimin e armëve të zjarrit, ekzaminimin e predhave dhe gëzhojave dhe krahasimin mikroskopik të tyre. Duke u bazuar në

konstatimin dhe mendimin e ekspertit, është vërtetuar fakti se pistoleta “Pietro Bereta” model 92 FS, kalibri 9x19mm, me numër serik K187027, e gjetur në vendin e ngjarjes afër trupit të pa jetë të të ndjerit U. ka qenë funksionale gjatë testeve. Po ashtu nga kjo provë është vërtetuar fakti se edhe pistoleta “Ceska Zbrojovka model 75” e kalibrit 9x19mm, ka qenë funksionale gjatë gjuajtjeve testuese, nga kjo provë është vërtetuar fakti se 5 gëzhoja të gjetura në vendin e ngjarjes, të evidentuara si dëshmiya VN#9, VN#10, VN#11, VN#13, VN#20, janë pjesë e fishekëve të kalibrit 9x19mm, po ashtu është vërtetuar qartë se 4 gëzhoja të lartcekura janë shkrepur nga pistoleta “Ceska Zbrojovka model 75” e kalibrit 9x19mm, me numër serik 154865, e përcaktuar sipas ekzaminimit të vendit të ngjarjes, si dëshmi B.B#1, ndërsa gëzhoja tjetër është shkrepur prej pistoletës “Bereta” të përshkruar si më lartë me numër serik e përshkruar si dëshmi VN #7, përveç kësaj nga kjo provë vërtetohet fakti se predhat e gjetura në rroba dhe trupin e të ndjerit Urim, janë pjesë e fishekëve të kalibrit 9x19mm, të shkrepura nga pistoleta “Ceska Zbrojovka model 75” e kalibrit 9x19mm, me numër serik 154865, e konfiskuar nga i akuzuari B.B. B.B..

Nga raporti i autopsisë, vërtetohet se para dhe gjatë autopsisë janë përdorur rreze X, ku janë detektuar predha në brendësi dhe jashtë organizimit të kufomës. Eksperti mjeko ligjor, sipas këtij raporti ka bërë ekzaminimin e jashtëm të trupit të pa jetë të tani të ndjerit U.D., duke bërë përshkrimin e detajuar të trupit, është me rëndësi të potencohet se nga eksperti është konstatuar se koka dhe fytyra e të ndjerit kanë dëmtime duke përfshirë hundën, veshët, mjekrën, krahërorin, abdomenin, shpinën si dhe ekstremitetet e sipërme dhe të poshtme që nënkupton duarë dhe këmbët, ndërsa si ka ardhur deri tek këto dëmtime gjykata veç se i sqaroj konstatimet e mësipërme të ekspertit.. Tek i ndjeri U.D., janë gjetur dëshmi mbi lëndimet e freskëta të evidentuara në faqën 3 të Raportit të autopsisë, duke përcaktuar me radhë plagët me numra dhe duke i sqaruar në mënyrë të qartë karakteristikat e plagëve si hyrëse ashtu edhe dalëse si dhe trajektoren e plagëve. Nga ky raport, bazuar në të gjeturat nga autopsia është vërtetuar se shkak i vdekjes së tani të ndjerit U. ka ardhur si rezultat i veprimit dinamik të predhave si pasojë e goditjes më armë zjarri në kokë dhe kraharor, ku janë dëmtuar organet vitale të përcjellura me gjakderdhje masive të brendshme dhe të jashtme dhe se predhat e kanë goditur menjëherë njëra pas tjetrës dhe se vdekja ka qenë e menjëhershme.

Nga Raporti i ri-konstruimit të vendit të ngjarjes rezulton se duke u bazuar në analizat e kryera të dokumentacionit në dispozicion, është ardhur deri te konstatimi se armët e përdorura në vendin e ngjarjes kanë qenë 1. Pistolet gjysmë automatike “Ceska Zbrojovka”, model 75 me nr. serik 154865, dhe një pistolet gjysmë automatike “Pietro Bereta” model 92 FS, me nr. serik K187027, e prodhuar në Itali. Bazuar në dëshmitë materiale të fiksuara në vendin e ngjarjes, gëzhoja dhe plumbat rezulton se janë përdorur dy lloje të ndryshme të kalibrave dhe atë 9x19mm dhe 7.65x17mm. Dëshmitë e kalibrit 9x19mm, të gjetura rezulton se janë shkrepur nga dy armët e kalibrit të lartshënuar, kurse një gëzhojë e kalibrit 7.65x17mm është shkrepur nga një armë tjetër. Pistoleta “Ceska Zbrojovka” pas shkrepjes në pozitë normale gëzhojat i hedhë në anën e djathtë të gjuajtësit në një kënd 76 deri në 126 shkallë, ndërsa pistoleta “Pietro Bereta” pas shkrepjes në pozitë normale gëzhojat i hedhë në anën e djathtë të gjuajtësit në një kënd prej 106-127 shkallë. Vlen të theksohet se nuk mundë të përcaktohen pozitat e gjuajtësve në momentin kur kanë gjuajtur me armë kjo pasi që gëzhojat e fiksuara në vendin e ngjarjes pas shkrepjes janë rikoshetuar nga xhamat dhe muret e hyrjes së lokalit dhe pozitat e fiksuara nuk janë pozita ku kanë rënë fillimisht gëzhojat pas shkrepjes. Bazuar në fotografitë nga autopsia e të ndjerit, rezulton se ai i ka 6 plagë, prej tyre dy janë tej shkuese, dy janë plagë depërtuese ndërsa dy janë tangjenciale. Plaga tejshkuese është në pjesën e pasme të kokës së të ndjerit, plaga tangjenciale në faqen e majtë të të ndjerit dhe plaga tejshkuese në pjesën e përparme të supit, afër klavikulës janë shkaktuar derisa i ndjeri ka pasur kokën të përkulur nga ana e majtë, apo me trup të kthyer nga ana e majtë në raport me boshtin e tërthortë të tytës së armës. Plagët tangjenciale në faqen

e majtë të te ndjerit dhe plaga tejshkuese në pjesën e përparme të supit me besueshmëri janë shkaktuar nga e njëjta e shtënë.

Sa i përket ri-konstruimeve të vendit të ngjarjes, gjykata për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi ka marrë për bazë të gjitha deklaratat e pjesëmarrësve në ri-konstruimet e vendit të ngjarjes për të nxjerrë përfundimet, andaj arsyetimet mbi gjetjet në ri-konstruim janë të arsyetuara në të gjitha arsyetimet ku janë deklaruar dëshmitarët dhe të akuzuarit për gjatë ri-konstruimit.

Nga raporti i ekspertimit të dt. 16.11.2018, është konstatuar ndër të tjera se është bërë një e shtënë nga arma e zjarrit nga xhepi i xhakëtës nga brenda në drejtim jashtë, ndërsa 4 shtëna nga jashtë në drejtim brenda në xhaketë. Duke e lidhur këtë provë materiale me deklarin e ekspertit të forenzikës siç është theksuar edhe më sipër rezulton se një predhë është shkrepur nga xhepi i brendshëm i xhakëtës se tani të ndjerit ku rezulton se i njëjti ka pasur edhe grimcat e barutit në dorë dhe edhe dëshmitarët e kanë parë se aj e ka mbajtur armën brenda në xhaketë dhe përputhet edhe me deklarin e tani të akuzuarit B.B. se i ndjeri ka shkrepur nga brenda xhakëtës se tij, ndërsa goditjet tjera kanë ardhur nga arma e tani të akuzuarit B.B. B.B..

Në bazë të ekspertimit mjeko ligjor, për të dëmtuarit A.S. E.Q. dhe S.A. konstatohet se të dëmtuarit E.Q. dhe S.A. janë sulmuar fizikisht bazuar edhe në provat tjera të administruara në gjykatë dhe si pasojë e sulmit kanë pësuar lëndime të lehta trupore. I dëmtuari A.S. ka pësuar thyerje shumë pjesësh në kockën e krahut të djathtë si pasojë e plagës nga arma e zjarrit dhe në këtë rast i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore, po ashtu kjo ekspertizë e dt 30.07.2015, vërteton faktin se i dëmtuari E.Q., pas sulmit fizik ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të shkaktuara nga një mjet i fortë mbretës, si pasojë ka marrë plagë shquese dhe ndrydhëse nga ana e pasme e kokës, ndërsa nga ekspertiza e dt. 14.06.2015, vërtetohet se i dëmtuari S.A. ka pësuar lëndime të lehta trupore si pasojë e sulmit fizik.

Siç është specifikuar për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi një ndër vërejtjet e gjykatës së Apelit ka qenë edhe fakti se as një i akuzuar nuk është akuzuar nga Prokuroria lidhur me lëndimet e lehta trupore ndaj të dëmtuarve E.Q. dhe S.A. dhe se kjo gjykatë në vijim të këtij arsyetimi të këtij aktgjykimi do të japë arsye se pse nuk u lëshua më tepër në këto konstatime.

Gjykata duke i dhënë të drejtë fundamentale barazisë së palëve në procedurë, me prioritet të veçantë ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, respektivisht, deklarin e të akuzuarve të dhëna në seancat e më hershme gjyqësore si dhe në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes.

Gjykata do ti trajtoj vetëm në pika të shkurta fragmentet kryesore që lidhen me çështjen, respektivisht faktet kontestuese nga deklaratat e me hershme te te akuzuarve.

I akuzuari B.B. B.B. nuk e ka mohuar faktin se ka poseduar armen e zjarrit dhe për këtë çështje edhe e ka pranuar fajësinë. Tutje i akuzuari B.B. B.B. po ashtu nuk ka mohuar faktin se edhe ka shtënë në drejtim të tani të ndjerit U.D. dhe se të njëjtin e ka privuar nga jeta. I akuzuari ka mohuar faktin se ka pasur ndonjë përleshje me te ndjerin e pastaj e ka ekzekutuar, por i njëjti ka specifikuar se i ndjeri ka gjuajtur në drejtim te te akuzuarit B.B. dhe se B.B.i ia ka kapur armen dhe kanë qenë duke rënë për toke dhe duke menduar se aj po e vret B.B.in pa menduar ka shtënë në drejtim të tij.

Gjykata përkitazi me këtë pjesë të deklaratës së tij në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes ia ka falë besimin të akuzuarit për faktin se një deklarin i tij lidhet edhe me pozitën ku ka qenë i akuzuari B.B., i akuzuari B.B. dhe tani i ndjeri U.D.. Tutje deklarata e tij gjen përputhje edhe me provat tjera të administruara dhe përputhet pikërisht me pozitën e krysur të tani të ndjerit Urim të cilën e ka shpjeguar Dr.Arsim Gërxhaliu e po ashtu një deklaratë e tillë gjen përputhje të plotë

edhe me deklaratën e të akuzuarit B.B. i cili ka shpjeguar se ja ka kapur armen te ndjerit Urim pasi që i njëjti ka shtënë dhe ka qenë duke rënë për toke me të.

Kjo gjykatë po ashtu konstaton se nuk ka prova tjera që qojnë në konkludime tjera sa i përket gjendjes faktike përveç versionit që ka dhënë tani i akuzuari e që përputhet me provat tjera të lartcekura, ndërsa sa i përket konditave po që se i njëjti ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, kjo gjykatë këtë çështje do ta trajtoj në pjesë të veçantë përgjatë arsytimit të këtij aktgjykimi.

I akuzuari B.B. në mbrojtjen e tij kishte specifikuar se tek tavolina e tani të ndjerit ka shkuar disa here natën kritike që të kërkoj nga të njëjtit që të qetësohen pasi ata në vazhdimësi kanë thyer gota dhe shishe. Këtë fragment të deklaratës se tij kjo gjykatë e akcepton në tërësi për faktin se të gjithë dëshmitaret që kanë qenë në vendin e ngjarjes i kanë specifikuar veprimet e të dëmtuarve në tavolinën e tyre e po ashtu edhe faktin se i akuzuari B.B. ka bërë përpjekje disa here ti qetësoj. Tutje deklarimi i të akuzuarit B.B. përputhet edhe me deklaratimet e dëshmitarit E.Q. që ka shpjeguar se i akuzuari B.B. ju ka thënë ta bëjnë pagesën dhe ta lirojnë lokalin dhe se kur dëshmitari E. e ka pyetur B.B.in se a ka ndonjë problem i njëjti i ka thënë asnjë problem nuk ka vetëm paguani faturën dhe lirojeni lokalin. Tutje çështja kryesore se a kishte dalë jashtë i akuzuari B.B. me qëllim që ti shkaktoj ndonjë të keqe tani të ndjerit U., kjo gjykatë ia ka falur besimin të akuzuarit B.B. për arsyet si në vijim. Asnjëri nga dëshmitaret nuk ka arritur te shoh momentin kritik se si ka ndodhur rasti dhe se gjykata nuk ka pasur asnjë provë që mbështet argumentet e prokurorisë. Tutje deklarata e të akuzuarit B.B. është në përputhje me dëshmitarin e vetëm i cili ka kaluar ngjitur me të akuzuarin B. dhe tani të ndjerin U. e i cili është i dëmtuari tjetër A.S. i cili ka specifikuar se duke dalë jashtë tek dera e lokalit dera ka qenë e bllokuar dhe se i akuzuari B.B. ka qenë tek dera ndërsa i ndjeri U. ka qenë po ashtu tek sokaku i lokalit duke dalë jashtë dhe ka qenë i ndjeri U. që e ka ftuar B.B.in të dalin jashtë, por B.B.i i kishte thënë se jo nuk dalë jashtë. Një version të tillë e ka dhënë në mënyrë identike edhe i akuzuari B.B. e i cili ka specifikuar se pastaj pas insistimit te te ndjerit i njëjti ka filluar te dal jashtë dhe po sa ka dalë i akuzuari jashtë, menjëhere i ndjeri ka shtënë me armë dhe pastaj i akuzuari iu ka gjuajtur në armë ja ka kapur armen kanë qenë duke u rrezuar dhe pastaj e ka parë të ndjerin te shtrirë për toke. Kjo deklaratë lidhet edhe me periudhën se sa ka arritur te zbres poshtë shkallëve i dëmtuari A. që argumentohet fakti se gjithçka ka ndodhur brenda pak sekondave. Fakti se ka qenë i ndjeri U. që ka isnsituar që i akuzuari B.B. të dalë jashtë është vërtetuar edhe nga dëshmitarja tjetër që ka dëshmuar në ri-konstruimin e vendit të ngjarjes e që është dëshmitarja K. e cila po ashtu ka specifikuar se ka qenë i ndjeri U. që ia ka bërë me dorë B.B.it që të dalin jashtë, andaj mbi këto shkaqe dhe mbi përputhshmërinë e provave mes vete, gjykata ia ka falur besimin deklaratimit të tani të akuzuarit B.B..

Tutje i akuzuari B.B. ka pasur mos përputhje me deklaratat e tij se me çka e kishte goditur të dëmtuarin E. por siç është specifikuar më sipër prokuroria nuk ka ngrit aktakuzë në këtë drejtim dhe se gjykata do jap një arsyetim të veçantë përkitazi me këtë çështje, ndërsa i akuzuari B.B. kishte pranuar se nga frika e asaj që ndodhi kishte kapur një stupc të bejsbollit qe ishte tek shanku ne mënyrë që të mbrohej nga shokët e tani të ndjerit dhe se e kishte goditur edhe tani të dëmtuarin S.A.

#### *Provat qe nuk janë marr për bazë me rastin e vendosjes dhe që nuk kanë qenë determinuese*

Për të qenë ky arsyetim i aktgjykimit më i kuptueshëm, për të mos lënë pa-qartësi dhe dykuptueshmëri, kjo gjykatë specifikon faktin se përgjatë administrimit të provave shumica e dëshmitarëve nuk i kanë parë momentet kritike, respektivisht momentin e të shtënave me armë dhe shumica e deklaratimeve janë identike vetëm përkitazi me problemet që i kanë shkaktuar të dëmtuarit në lokal, andaj edhe pse ka pasur dëshmitar që janë dëgjuar dhe deklaratimet e tyre janë administruar si provë, të njëjtave deklarata nuk do tu ipet ndonjë fuqi e madhe provuese për

faktin se nuk zbardhin çështjet kontestuese, andaj tek lidhshmëria provave, gjykata nuk do të lëshohet edhe në lidhshmërinë e të gjitha provave, por vetëm atyre që mund të ndërlidhen njëra me tjetrën dhe mbi bazën e të cilave mund të nxirën përfundime të sakta mbi rrjedhën e ngjarjes dhe mbi zbardhjen e gjendjes faktike. Tutje nga shkresat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se pas ngjarjes ka edhe shumë persona të tjerë që janë marrë në pyetje por të cilët asnjëherë nuk janë propozuar për tu dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve për shkak se nuk kanë dhënë asnjë kontribut lidhur me zbardhjen e rastit, andaj edhe nuk janë propozuar asnjëherë që të administrohen si prove as nga prokuroria e as nga palët tjera e që rrjedhimisht gjykata nuk i trajtoji të njëjtat.

### **Nxjerrja e përfundimeve sa i përket veprimeve të të akuzuarit B.B. B.B., arsyetimi i aktgjykimit, sa i përket aktgjykimit dënues.**

Kjo gjykatë tani do të trajtoj vetëm pjesën e dispozitivit sa i përket aktgjykimit dënues lidhur me të akuzuarin B.B. B.B. dhe arsyetimi i aktgjykimit do të prek vetëm çështjet kontestuese dhe duke i trajtuar në përpikri vërejtjet e Gjykatës së Apelit.

Fillimisht konstatojm faktin se nga provat e administruara dhe gjykimet e deri tanishme rezulton i pa-kontestueshem fakti se personi që me armën e tij e ka privuar nga jeta tani të ndjerin U.D. i është tani i akuzuari B.B. B.B.. Kontestuese kishte mbetur fakti të determinohet po qe se i akuzuari B.B. bashke me të akuzuarin B.B. e kishin privuar nga jeta tani të ndjerrn, apo i akuzuari B.B. kishte vepruar në vetembrotje për të zbratur sulmin nga i akuzuari B.B..

Lidhur me këto çështje, për të nxjerrë këto konstatime gjykata do të trajtoj një nga një vërejtjet – rekomandimet e Gjykatës së Apelit.

#### Vërejtjet – rekomandimet e Gjykatës së Apelit.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin PAKR.nr.462/2020 të datës 11.03.2021 kishte prishur përsëri aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kishte kthyer në r-gjykim.

Gjykata e Apelit përsëri kishte gjeutur shkelje procedurale, por edhe vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike duke specifikuar se gjykata e shkallës së parë përsëri nuk ka arritur të nxjerrë përfundimet se kush kishte shtënë i pari me armë e as nuk kishte dhënë arsyetim përkitazi me pozitën e kryesur dhe shenjat e viktimës. Po ashtu Gjykata e Apelit vë theks të veçantë në faktin se në vendin e ngjarjes janë gjetur tri lloje të gzhovave dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye se cilat armë në çfarë forme janë përdorur dhe këto kundërthënje pamundësojnë nxjerrjen e konkludimeve të sakta. Gjykata e Apelit ka rekomanduar gjykatën e shkallës së parë që në ri-gjykim të sqaroj pozitën e të dëmtuarit dhe shenjat të cilat i njejtë ka psaur në fytyrë përtej plagëve vdekjepruresë. Po ashtu është kërkuar që të determinohet se sa armë janë përdorur në vendin e ngjarjes, e pastaj përsëri në ndërlidhje me gjitha provat të konsultohet se kush kishte shtënë i pari me armën e zjarit, pozita e secilit të përfshirë në këtë rast e pastaj të nxirren konkludimet dhe të vërtetohet fakti se a ka shtënë i pari me armë i ndjeri pasi që edhe ai kishte armë, apo i akuzuari B.B., pasi që pa sqarimin e këtyre fakteve nuk mund të vërtetohet po qe se i akuzuari B.B. B.B. veperoi me qëllim që ta privoj nga jeta tani të ndjerin U.D., apo për ta mbrojtur të akuzuarin B.B., e pastaj të vërtetohet po qe se i akuzuari B.B. e ndihmoi të akuzuarin B.B. të kryej veprën penale apo nuk kreu fare veprë penale.

Kjo gjykatë fillimisht konstaton se dilema që me të drejtë drejtë ka ngritur Gjykata e Apelit se në rastin konkret sa armë janë përdorur, me rastin e këtij ri-gjykimi kjo dilemë tani është hequr.

Siç është specifikuar më lartë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, në këtë ri-gjykim, ekspertit Ilir Ukaj ka hequr dilemat se sa armë janë përdorur natën kritike, duke konstatuar se natën kritike janë përdorur vetëm dy armë, arma të cilën e ka përdorur tani i ndjeri dhe arma të cilën e ka përdorur i akuzuari B.B. B.B.. Sa i përket gëzhgjës që nuk ka pasur të bëjë me këto armë e që është gjetur më larg në oborrin e lokalit, sipas ekspertit është gëzhgjës e vjetër-ndryshkur që nuk është përdorur natën kritike e që rrjedhimisht nuk lidhet me këtë rast.

Duke hequr këtë dilemë që ka ngritur Gjykata e Apelit, për këtë gjykatë ka qenë shumë më e thjeshtë të vihet deri tek zbardhja e gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit ka kërkuar nga kjo gjykatë që të konstatohet edhe arsyeja se pse viktimja ka qenë e krysur kur i akuzuari B.B. ka shkrepur me armë në drejtimin e tij dhe po ashtu të sqarohen lëndimet tjera trupore që i ka pasur tani i ndjeri dhe po ashtu kërkesa kryesore ka qenë të determinohet fakti se kush ka shtënë i pari me armë në mënyrë që të nxirren konkludimet.

Kjo gjykatë edhe më lartë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi ka specifikuar se në bazë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor e të cilave kjo gjykatë ua ka folur besimin, rezulton se pozita e krysur e të ndjerit në atë moment ka qenë për faktin se i ndjeri dhe i akuzuari B.B. janë kapur për arme dhe kanë qenë duke rënë në tokë.

Sa i përket faktit se po që se ka pasur përleshje paraprake mes të akuzuarve dhe të ndjerit edhe këtë dilemë e ka hequr Dr.Arsim Gërxhaliu e ku siç është arsyetuar me sipër, viktimja nuk ka pasur plagë të tjera përveç atyre që janë shkaktuar nga predhat dhe se prej afërsisë së armës me viktimitë pra afërsisë së predhave që kanë përfunduar në trupin e viktimitë ka pasur edhe gërvishtje tjera por të cilat janë shkaktuar nga predhat, por jo që ka pasur ndonjë shenjë nga ndonjë konflikt paraprak. Tutje eksperti ka sqaruar se dëmtimet që i ndjeri ka pasur në fytyrë, janë shkaktuar në momentin që i njëjti është përplasur për dysheme pasi që është goditur me armë zjarri, që rrjedhimisht edhe në këtë rast ka përjashtuar çdo mundësi që këto shenja ti janë shkaktuar paraprakisht nga ndonjë përleshje.

Nga sqarimet e eksperteve të lartcekur janë hequr të gjitha dilemat që i ka ngritur Gjykata e Apelit dhe kësaj gjykate i ka mbetur vetë të determinoj faktin se kush ka shtënë i pari me armë.

Në rrethanat e krijuara që tani e kemi të konstatuar se nuk ka ndonjë armë të tretë që është përdorur në vendin e ngjarjes, po ashtu rrjedhën e shpejte të ngjarjes, ku gjithçka ka ndodhur për pak sekonda, marr parasysh faktin se është konstatuar se arma e të akuzuarit B.B. B.B. ka qenë shumë afër trupit të viktimitë dhe se i njëjti ka gjuajtur rafal dhe se vdekja e viktimitë ka qenë e menjëhershme, nuk ka asnjë logjikë që mund të shpie se i akuzuari B.B. ka shtënë i pari me armë, sepse sikur të ishte kështu i ndjeri s'kishte pasur asnjë mundësi që të arrin ta përdor armën, andaj edhe nga provat e administruara rezulton se ka qenë i ndjeri U. që e ka ftuar të akuzuarin B.B. që të dal tek dera e lokalit dhe me të dalë ka shtënë nga brenda jaknes se tij në drejtim të të akuzuarit B.B. e i cili ia ka kapur armën dhe duke rënë për toke me të, në ato momente i akuzuari B.B. e privon nga jeta tani të ndjerin.

#### Rrjedha e ngjarjes që e ka vërtetuar kjo gjykatë nga provat e administruara

Kjo gjykatë do të paraqet edhe kronologjinë se si ka ndodhur rasti, të cilin konstatim e ka nxjerrë kjo gjykatë në bazë të të gjitha provave të administruara dhe lidhshmërisë mes tyre, ashtu siç e përcakton nenin 360 i KPPRK-së.

Fillimisht konstatohet se tani i ndjeri U. kishte filluar të pinte pije alkoolike nga mëngjesi me dëshmitarin E.Sh. për shkak të lindjes së vajzës së tij, ndeja kishte filluar në qytetin e Prizrenit. Tutje i ndjeri U. bashkë me të lartcekurin E. kishin vazhduar ndejën e tyre në një kafe në Lagjen e Muhaxherëve ku kishin vazhduar me disa miq të tjerë të Urimit duke vazhduar te pinin pije alkoolike e të festonin.

Prej aty, kishin vendosur që ndeja e tyre të vazhdon në Restorant “Agoni” në fshatin Banull të Lipjanit. Në këtë restorant i ndjeri kishte shkuar me E.Q. S.A. e E.Sh. e edhe persona të tjerë të cilët ishin larguar prej aty, para se të ndodhte incidenti. Vlen të theksohet një fakt shumë me rëndësi se i ndjeri U.D. me shokët e tije kanë qenë edhe here te tjera ne këtë Restorant, kanë qenë mysafir të mirëpritur pasi që siç ka shpjeguar dëshmitari E.Q. kanë pasur raporte të mira me pronarin e lokalit tani të akuzuarin B.B. i cili herëve të tjera kur ka pasur më pak mysafir ka qëndruar me ta në tavolinë madje i ka qerasë edhe me pije që është indikacion i qartë për gjykatën se mes tyre nuk ka pasur asgjë të keqe. Tutje nga dëgjimi i çdo dëshmitari, rezulton se të dëmtuarit dhe viktimat në vazhdimësi kanë thyer gota dhe shishe e ku për këtë shkak pronari i lokalit tani i akuzuari B.B. ka shkuar disa here për të kërkuar nga ta që të qetësohen. Se sa të dehur kanë qenë tani të dëmtuarit vërtetohet edhe nga vet deklaratat e E.Q., S.A. e E.Sh. te cilat madje as nuk e kujtojnë rrjedhën e ngjarjes për shkak të nivelit të tyre të dehjes.

Në këto momente dikush nga këta persona në tavolinë ka ecur për rreth tavolinave të tjera në këmbë duke iu parë edhe arma dhe kur e ka parë këtë këngëtarja-dëshmitarja Xh. është shqetësuar duke konsideruar se ia kanë drejtuar armën dhe duke thënë a e patë se ke tu me vra dhe në ato momente e ka lënë muzikën dhe ka ikur në dhomën për këngëtarë dhe nga frika është alivanosur. Në këto momente të gjithë në lokal e kanë vërejtur se diqka nuk është në rregull dhe se duke parë faktin se situata në atë tavolinë vetëm po eskalon, i akuzuari B.B. si pronar i lokalit ka shkuar perseri tek tavolina dhe ka kërkuar nga tani i ndjeri U. që ta bëjnë pagesën dhe ta lirojnë lokalin. Fakti se i akuzuari B.B. nuk ka dashur as edhe një problem ta ketë me të dëmtuarin vëretohet nga vet dëshmia e dëshmitarit E.Q. i cili i ka thënë të akuzuarit B.B. se a ka nodnjë problem dhe se i akuzuari i është pergjurgur se asnjë problem nuk është vetem pagueni faturen dhe lirojeni lokalin.

Në ato momente E.Q. dhe i ndjeri U.D. kanë filluar të dalin jashtë.

As edhe njëri nga dëshmitarët nuk ka parë ndonjë konflikt mes ndonjerit nga të akuzuarit dhe tani të ndjerit, një fakt të tillë nuk e thot as vet i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit E.Q.

Tutje dëshmitari H. ka shpjeguar se e ka parë të ndjerin që kishte te futur doren ne xhepin e jaknes dhe verehej se e kishte armën në dorë gjë që vërtetohet edhe nga provat materiale, respektivisht nga vendi ku tani i ndjeri ka shkrepur me armën e tij, e që pastaj është në përputje të plotë edhe me deklarinimin e të akuzuarit B.B.. Tutje i akuzuari B.B. nuk ka dalur fillimisht jashtë lokalit me të ndjerin por ka qëndruar brenda, por ka qenë i ndjeri që është ndalur tek sokaki (tek dera e lokalit) dhe e ka ftuar të akuzuarin B.B. të dalë jashtë, ndërsa i akuzuari fillimisht kishte refuzuar, gjë që vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit A.S. dhe dëshmitares K. dhe me të dalë jashtë lokalit i akuzuri B.B., i ndjeri U nga xhepi i mbrendhsme i jaknes shkrep me armen e tij ne drejtim te te akuzuarit B.B. dhe i njejt i kapet per arme me të ndjerin U ku janë duke rënë për toke dhe menjëhere i akuzuari B.B. shtën rafal me armen e tij ne drejtim te tani te ndjerit U e ku me këtë rast perveç se i U.D. vdes menjehere, njëri nga plumbat e godit edhe te demtuarin A.S. i i cili ishte duke zbritur shkallve, ndersa i akuzuari B.B. godet me mjet te forte te demtuarin E. ne koke dhe pastaj merr nje stupc bejsbolli qe ishte mrapa shankut dhe e godet edhe te demtuarin S.A. kur ai ishte duke dalur nga lokali.

Se ngjarja ka ndodhur brenda pak sekondave vërtetohet fare lete nga ri-konstruimi i vendit te ngjarjes duke i dhene rendesi te posaçme deklarimit te tani demtuarit A.S. i cili ka sqaruar se prej momentit kur e ka parë të ndjerin U. tek dera duke e thire te akuzuarin B.B. qe te dalë jashtë dhe deri tek shkallët ku ka zbritur i demtuari A. ku e ka rrokur plumbi ishte nje periudhe kohore rreth 5-7 sekonda dhe e gjithë ngjarja ka ndodhur ne keto momente, ku nje fakt te tille e specifikon



edhe deshmitari E. i cili ka qene duke dalur jasht bashke me te ndjerin dhe vetem i ka degjuar te shtenat dhe ka ikur. Ne keto rethana per gjykatën është mese e qarte fakti se ka qene i ndjeri qe ka shtene pa pritmas ne drejtim te akuzuarit B.B. dhe pastaj i akuzuari B.B. e ka privuar te njejtin nga jeta.

Gjykata nuk është leshuar me tej ne arsyetimin lidhur me gjetjen fajtor te te akuzuarit B.B. sa i perket vepres penale te armbajtjes pa leje per faktin se i njejti është deklaruar fajtores.

Nga të gjitha provat e lartcekura lidhshmerisë dhe mos-shkëputjes së kronologjisë prej proves në provë, kjo gjykatë pa asnjë mëdyshje ka nxjerr përfundimet e saj lidhur me veprimet e të akuzuarit B.B. e te cilat i determonoj kjo gjykatë më sipër për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Në vazhdim të aktgjykimit, gjykata do ti jap arsytet mbi elementet e vepres penale per te cilat i akuzuari B.B. është gjetur fajtor dhe arsytet se pse kjo gjykate ka konsideruar se veprimet e tij i njejti i ka ndermarr per te zbrapsur sulmin e të ndjerit prej te akuzuarit B.B., por edhe faktin se pse kjo gjykatë ka konsideruar se i akuzuari B.B. i ka tejkalar kufijte e mbrojtës e nevojshme.

#### Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprave penale

Gjykata ka vlerësuar elementet e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën par 1.5 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të KPRK-së, për të cilën vepër është gjetur fajtor i akuzuari B.B. B.B., ashtu që dispozita e lartcekur specifikon si vijon: *Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë.*

Në rastin konkret, kjo gjykatë ka konstatuar se veprimet e të akuzuarit bëjnë pjesë në nenin 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, respektivisht përmbushin elementet e kësaj vepre penale marrë për bazë faktin se i akuzuari me qëllim të privimit nga jeta personit tjetër, kishte shtënë me armën e tij të zjarrit në tani të ndjerin U.D. i cili kishte ndëruar jetë në vendin e ngjarjes.

Në rastin konkret i akuzuari ka ndërmarr veprime në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë pasi që me qëllim të privimit nga jeta të personit tjetër, kishte shtënë në të ndjerin U.D., i cili siç është cekur edhe më lartë nga lëndimet e marra ka ndëruar jetë në vendin e ngjarjes.

Kjo gjykatë konstaton se i akuzuari, ka shtënë me armë zjarri në drejtim të ndjerin me qëllim që të njëjtin ta privoj nga jeta, dhe me atë rast me dashje eventuale ka rrezikuar jetën e një apo më shumë personave tjerë të cilët kanë qenë duke dalë nga lokali e ku ka plagosur edhe tani të dëmtuarin A.S., andaj kjo gjykatë ka vlerësuar se në tërësi janë përmbushur elementet e veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, për të cilën tani është gjetur fajtor i akuzuari B.B. B.B., për faktin se i akuzuari e ka privuar nga jeta tani të ndjerin e lartcekur dhe me atë rast me dashje eventuale ka vënë në rrezik edhe jetën e personave tjerë të cilët ishin duke dalë nga lokali, me ç' rast ka plagosur edhe të dëmtuarin A.S..

Tani nuk ishte kontestuese se i akuzuari kishte privuar nga jeta të ndjerin U.D., ndërsa sa i përket te plagosorit A.S. gjykata konstatoi se ne raport me te njëjtin i akuzuari nuk kishte dashje direktet qe ta godiste, por nga rrethanat faktike te rastit rezulton se i njëjti kishte dashje eventuale për arsytet si ne vijim:

Neni 21 paragrafi 3 i KPRK-së, përcakton si vijon: *Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimet ose i mosveprimet të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.*

Marr parasysh rrethanat faktike se aty kishte pasur shume njerëz në lokal dhe se duke dalë nga lokali po ashtu kishte pasur shumë njerëz e po ashtu vendi prej nga kanë dalë njerëzit ka qenë vend i ngushtë dhe ka pasur disa persona poshtë shkallëve, kur i akuzuari B.B. ka ndërmarr veprime për ta privuar nga jeta tani të ndjerin U. dhe ka gjuajtur me armë në drejtim të tij pa ndërpre, i njëjti ka qenë i vetëdijshëm se nga rrethanat faktike të rastit me veprimet e tij mund të shkaktoj edhe pasoja të tjera dhe ai e ka pranuar shkaktimin e pasojave të tjera, sepse fare lehte e ka ditur se me veprimet e tija do të shkaktoheshin edhe pasoja tjera marr për bazë grumbullin e njerëzve, me ç' rast është pajtuar me këtë pasojë ku ka goditur dhe ka plagosur edhe tani të dëmtuarin A.S. i cili nuk kishte të bënte fare me rastin dhe kishte rastisur aty vetëm duke zbritur shkallëve të lokalit.

Çështja kryesore dhe kryesore tani ishte për tu determinuar faktin se a kishte vepruar tani i akuzuari B.B. në kornizat e mbrojtës se nevojshme për të zbrapsur sulmin e të ndjerit në drejtim të tani të akzuarit B.B. apo kishte tejkaluar kornizat e mbrojtjes se nevojshme.

Në neni 12 paragrafi 1 të KPRK-së është përcaktuar si vijon: 1. *Vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale.*

Tutje paragrafi 2 i po të njëjtit nen specifikon: *Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.*

Ndërsa në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është përcaktuar si vijon: *Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.*

Kjo gjykatë ka analizuar teorinë por edhe praktikën gjyqësore për të nxjerre konkludimet, fillimisht po qe se i akuzuari ka vepruar në kuadër të Mbrojtës së nevojshme e pastaj për të dhënë arsye mbi të cilat gjykata ka vlerësuar se janë kaluar përmasat e mbrojtës se nevojshme. Kushtet që duhet të përmbushen me rastin e mbrojtjes (zbrapsjes së sulmit): Mbrojtja është çdo veprim i njeriut me të cilin dëmtohet apo rrezikohet ndonjë e mirë e sulmuesit. Zakonisht, me rastin e mbrojtjes sulmi zbrapsset prej vetes ose prej të mirave juridike vetjake. Mirëpo, mbrojtja e nevojshme ekziston edhe në rastet kur sulmi zbrapsset edhe nga personi i tretë ( e që në rastin konkret i akuzuari B.B. ka marr veprime që të zbraps sulmin e të ndjerit ndaj të akzuarit B.B.. Mbrojtja duhet të jetë e drejtuar kundër sulmuesit. Për t'u konsideruar që ekziston mbrojtja e nevojshme, veprimet e mbrojtjes duhet të jenë të drejtuara kundër sulmuesit, kundër asaj të mire juridike të sulmuesit, e cila është e nevojshme për zbrapsjen e sulmit (p.sh. kundër trupit, jetës, pasurisë etj.), e që në rastin konkret sulmi i të akzuarit B.B. ka qenë në drejtim të sulmuesit e sulmuesi ka qenë tani i ndjeri Urim i cili siç ka nxjerrë përfundimet gjykata ka qenë personi i parë që ka shkrepë me armën e tij në drejtim të tani akzuarit B.B.. Mbrojtja duhet të jetë domosdo e nevojshme për zbrapsjen e sulmit. Për t'u konsideruar një mbrojtje si mbrojtje e nevojshme, ajo duhet të jetë domosdo e nevojshme domosdo që personi të zbrapsë sulmin prej vetes apo prej tjetrit. Rrjedhimisht, një mbrojtje konsiderohet e nevojshme në rastet kur konstatohet se sulmi nuk ka mundur të zbrapsset pa iu shkakuar ndonjë dëmtim sulmues.

Mbrojtja duhet të jetë proporcionale me intensitetin e sulmit. Ky kusht duhet të vlerësohet në kontekstin e domosdoshmërisë së mbrojtjes. Për të qenë mbrojtja domosdo e nevojshme, ajo duhet të ekzistojë në proporcionalitet (përpjesëtueshmëri) midis intensitetit të sulmit dhe mbrojtjes. Me anë të kriterit që mbrojtja duhet të jetë proporcionale me intensitetin e sulmit, janë vënë kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Rrjedhimisht, sipas këtij kriteri, mbrojtja duhet të jetë e natyrës dhe e intensitetit të tillë që është e mjaftueshme për të zbrapsu sulmin.

Tejkalimi apo kapërcimi i mbrojtjes së nevojshme shprehet në rastet kur mbrojtja nuk është proporcionale me sulmin apo kur mbrojtja ndërmerret pasi të jetë zbrapsur ose të ketë pushuar së vepruari sulmi. Se kur nuk është mbrojtja proporcionale me intensitetin e sulmit, kjo gjykatë për gjatë hulumtimit të praktikës vendore dhe ndërkombëtare duke u shërbyer nga Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës ka nxjerrë një rast praktik që është i ngjashëm me rastin konkret.

*I akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë me tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, ngase është konstatuar që, duke e zbrapsur sulmin e atëçastshëm, me shkrepjen e parë nga revolva, i dëmtuari është rrëzuar përtokë, dhe dy shkrepjet e tjera të mëpastajme në trupin e të dëmtuarit janë cilësuar si tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme, ngase dy shkrepjet pas rrëzuarjes së të dëmtuarit janë bërë pasi është përballuar sulmi. (praktika gjyqësore).*

Në rastin konkret, kjo gjykatë ka nxjerre konstatimet se i ndjeri U.D. ka shtënë ne drejtim të tani të akuzuarit B.B. dhe se i akuzuari B.B. është kapur për arme me të ndjerin Urim dhe kanë filluar të rrëzohen bashkërisht për toke. Është i vërtetë fakti se menjëherë pas pak sekondave i akuzuari B.B. ka filluar të gjuaj me armë në drejtim të tani të ndjerit nga frika se i njëjti po e privon nga jeta tani të akuzuarin B.B., mirëpo kjo gjykatë vlerëson se i ndjeri U.D. ka arritur vetëm një here të gjuaj me armë dhe pastaj i akuzuari B. ka arritur që të kapet për armën e tij duke rënë për toke dhe pozita nga prapa anash ku ka qenë i akuzuari B.B. dhe se i njëjti pasi i ka parë të dy duke rënë përtokë ka mundur që sulmin ta zbrapsë qoftë në mënyrë tjetër qoftë duke shtënë vetëm një here apo dy here në të ndjerin për ta zbraps sulmin por jo në mënyrën si ka vepruar ai ku nga prapa dhe pasi që sulmi është ndalur së vepruari ka shtënë në të njëjtin, andaj gjykata përfundimisht vlerësoi se i akuzuari B.B. ka filluar të veproj në mbrojtje të nevojshme por marr për bazë pushimin e sulmit nga i ndjeri si dhe pozitën e viktimës në raport me të akuzuarin B.B. i njëjti ka tejkualuar kornizat e mbrojtës së nevojshme duke privuar të ndjerin nga jeta dhe se në vlerësimin e gjykatës i njëjti është dashur të ndalet pasi që sulmi ka filluar të pushoj, respektivisht duke mos shtënë me armë pa ndërprerë në te. Andaj kjo gjykatë përfundimisht ka vlerësuar se ka pasur disproporcion mes sulmit dhe mbrojtës dhe se i akuzuari B.B. ka tejkualuar kufijtë e mbrojtës së nevojshme dhe se gjykata e gjeti te njëjtin fajtor për veprën penale Vrasje e rëndë në tejkalim të mbrojtës së nevojshme nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të KPRK-së, pasi që në bindjen e kësaj gjykate janë përmbushur të gjitha elementet e këtij cilësimi juridik.

Andaj kjo gjykatë përfundimisht konstaton se me veprimet e lartcekura të të akuzuarit, janë përmbushur të gjitha elementet e veprave penale, Vrasje e rëndë në tejkalim të mbrojtës së nevojshme nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të KPRK-së.

Sa i përket veprës penal Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në nenin 374 par 1 të KPRK-së është specifikuar si vijon: *Kushdo që mban në pronësi, kontrollon*

*ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Në rastin konkret i akuzuari B.B. B.B., në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05L-022, ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar armën Ceska Zbrojovka” model 75 me numër serik 1548865.

Andaj marr parasysh faktin se i njëjti nuk ka pasur leje të posaçme për mbajtjen e kësaj arme, gjykata konstaton se me veprimet e lartcekura të të akuzuarit, janë përmbushur të gjitha elementet e veprave penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

### Konstatimi i Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, vlerësimit të tyre veç e veç, si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën ashtu siç e përcakton neni 360 paragrafi 2 i KPPRK-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: është vërtetuar se i akuzuari B.B. B.B. ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë në tejkallim të mbrojtës së nevojshme nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

### Vendimi i gjykatës për ta shpallur të akuzuarin fajtor.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si: Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – A.D., Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – E.Q., Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit – A.S., Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit – S.A., Dëshmia e dëshmitarit – S.S., Dëshmia e dëshmitarit – V.S., Dëshmia e dëshmitarit – K.G., Dëshmia e dëshmitarit – E.K., Dëshmia e dëshmitarit – E.Sh. Dëshmia e dëshmitarës – Xh.V., Dëshmia e dëshmitarit – F.J. Dëshmia e dëshmitarit – Sh.R., Dëshmia e dëshmitares K.F., dëshmia e dëshmitarit H.B. Deklarimi i ekspertit – Ilir Kukaj, Deklarimi i ekspertit – Arsim Gërxhaliu, Deklarimi i ekspertit – Milazim Tahirukaj, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me zingjirin e ruajtjes së dëshmimeve me skicë dhe foto dokumentacion i datës 14.02.2015, Raporti i ekspertizës balistike i datës 15.05.2015, Raporti i autopsisë për të ndjerin U.D. me numër MA 15-042, Ekspertiza mjekoligjore lidhur me natyrën e lëndimeve për të dëmtuarit A.S., E.Q. dhe S.A., Raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes së bashku me CD që janë bërë për gjatë rikonstruimit të vendit të ngjarjes, është fjala për dy ri-konsumime të vendit të ngjarjes e po ashtu duke analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, duke i analizuar fillimisht secilën veç e veç dhe pastaj të gjitha së bashku, erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën gjykata e ka shpallur fajtor. Po ashtu në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e posaçme që e dallojnë veprën penale Vrasje e rëndë në tejkallim të mbrojtës së nevojshme nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të KPRK-së nga veprat tjera penale, ku i njëjti këtë vepra penale e ka kryer me dashje, respektivisht ka marr aso veprime ku me datë 14.02.2015, rreth orës 02:00, në Restorant “Agoni” në fshatin B. të L., duke vepruar në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme, i akuzuari B.B. B.B. ka privuar nga jeta tani të ndjerin U.D. dhe ka rrezikuar jetën e të tjerëve, në atë mënyrë që deri sa tani i ndjeri U.D. i cili ishte duke festuar bashkë me shokë lindjen e vajzës në këtë lokal, ku i ndjeri me shokët e tij kishin konsumuar alkool dhe kishin thyer gota e shishe, fillimisht i akuzuari B.B. kishte shkuar të tavolina ku ka qëndruar tani i ndjeri U. me shokët dhe ka kërkuar që të dalë nga lokali, ashtu që me të dalë nga dera e lokalit fillimisht i ndjeri e fton të akuzuarin B.B. që i njëjti të dalë jashtë tek dera dhe me të dalë i akuzuari B.B.

tek dera, tani i ndjeri Urim e përdorë armën e tipit “Pjetro Bereta“ model 92 FS, kalibri 9x19 mm, me numër serik K187027 të cilën e ka pas brenda në xhepin e djathtë të xhaketës së tij, duke shtënë një herë në drejtim të akuzuarit B.B., kurse i akuzuari B.B. arrin t’ia kapë xhaketën në xhep ku e kishte dorën në arme duke e ndaluar që të shtinë prapë me armë, dhe deri sa i akuzuari B.B. dhe i ndjeri U. ishin të kapur për arme duke rënë për toke, i akuzuari B.B. B.B. me revolen e tij të tipit “Ceska Zbrojoka” model 75 e kalibrimit 9x19 mm, me numër serik 154865, në afërsi rreth një metër shtinë në drejtim të tani të ndjerit U. katër herë, duke e goditur në pjesët vitale të trupit, me ç’rast nga plagët e marra tani i ndjeri U. vdes në vendin e ngjarjes, ndërkaq në këtë rast i akuzuari B.B. B.B. duke vepruar në dashje eventuale rrezikohet edhe jeta e të dëmtuarit A.S., i cili është goditur me një predhë në krahun e djathtë, me ç’rast ka pësuar thyerje shumë pjesësh në kockën e krahut të djathtë si pasojë e plagës nga arma e zjarrit dhe në këtë rast i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se me veprimet e lartcekura të akuzuarit, i njëjti ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë në tejkalim të mbrojtës së nevojshme nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 12 paragrafi 3 të KPRK-së, dhe pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e shpalli fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Tutje nga vet deklarimi i pranimit të fajësisë nga vet i akuzuari B.B. B.B., kjo gjykatë erdhi në përfundim se në veprimet e akuzuarit formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën gjykata e ka shpallur fajtor si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi. Po ashtu në veprimet e akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e posaçme që e dallojnë veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së nga veprat tjera penale, ku i njëjti këtë vepra penale e ka kryer me dashje, respektivisht ka marr aso veprime ku me datë 14.02.2015, i akuzuari B.B. B.B. ka mbajtur një revole të tipit “Ceska Zbrojovka model 75”, e kalibrit 9x19mm, me numër serik 154865, me një karikator dhe 11 fishekë, të kalibrit 9 mm, pa lejen e organeve kompetente e në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L – 022, e cila armë është përdorë në datën, kohën dhe vendin sikurse është përshkruar në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se me veprimet e lartcekura të akuzuarit, i njëjti ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e shpalli fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform neni 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese gjeti: frikën që i akuzuari ka përjetuar në momentin kur ka shkrepur me armë në drejtim të tani të ndjerit, e po ashtu edhe kontributin e të ndjerit në këtë rast pasi që e gjithë ngjarja dhe problemet kanë filluar të ndodhin nga vet të dëmtuarit e pastaj se fundmi ka qenë vetë i ndjeri që ka filluar të shkrepë me armë.

Gjykata nuk gjeti rrethana tjera posaçërisht rënduese në matjen e dënimit sa i përket veprës nga dispozitivi I i aktgjykimit, ndërsa sa i përket veprës penale nga dispozitivi II i aktgjykimit gjykata morri për bazë faktin se pikërisht nga posedimi i armëve pa autorizim në kontest të përgjithshëm në shoqërinë tonë po vijmë deri te këto raste, andaj edhe dënimet duhen të jenë më të ashpëra. Sa i përket rrethanave rënduese, kjo gjykatë nuk gjeti rrethana posaçërisht rënduese sa i përket veprës penale nga dispozitivi I përveç atyre që janë të parapara me vetë cilësimin juridik të veprës

penale, e mira e mbrojtur që në rastin konkret ka qenë jeta e njeriut si dhe fakti se në rastin konkret është plagosur edhe i dëmtuari A.S., mirëpo këto rrethana gjykata nuk i trajtoi si rrethana veçanërisht rënduese, sepse të njëjtat veç se janë të parapara në cilësimin juridik për çka edhe dënimi është më i lartë dhe se praktika gjyqësore e ka determinuar faktin se nuk lejohet duplikimi i tyre andaj mbi këto shkaqe, kjo gjykatë nuk e gjeti rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit sa i përket veprës së parë penale.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rrethanave faktike të elaboruara sipër, të akuzuarit fillimisht i përcaktoi dënimin për secilën vepër veç e veç, ku për veprën nga dispozitivi I i përcaktoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vite, ndërsa për veprën penale nga dispozitivi II dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 4 (katër) muaj burgim, ndërsa duke aplikuar nenin 80 të KPRK-së, të njëjtin e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata u kishte dhënë mundësi palëve, respektivisht i kishte informuar për të drejtën e tyre për të propozuar caktimin e seancës nga neni 356 i KPPRK-se, ku do të trajtoheshin rrethanat për shqiptimin e dënimit, por palët kishin konsideruar se i kanë specifikuar të gjitha çështjet dhe nuk kishin propozuar një seancë të tillë dhe kishin kërkuar nga gjykata që të procedohet tutje.

Gjykata me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, mori për bazë edhe udhëzuesin e politikës ndëshkimore të lëshuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, që ka për qëllim unifikimin e politikës ndëshkimore, me theks të veçantë kritiken për dënime jo adekuate.

Duke ju referuar udhëzuesit të lartcekur, i njëjti ka specifikuar se gjykata në raport me matjen e dënimit duhet të ketë një pikënisje dhe pastaj varësisht nga rrethanat rënduese ose lehtësuese do të lëvizet në diskrecionin e gjykatës për të arritur në një dënim të drejtë. Në rastin konkret në matjen e dënimit, gjykata duke zbatuar udhëzuesin sqaron se tek vepra penale Vrasje e rëndë nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, është paraparë minimumi i dënimit prej 10 vite burgim, ndërsa maksimumi dënim me burgim të përjetshëm, ndërsa sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll të pa autorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK-së nuk është përcaktuar minimumi i dënimit që rrjedhimisht konsiderohet se është 30 dit burgim e deri në maksimum prej 5 vite burgim. Në rastin konkret gjykata vlerëson se pikënisja për këto vepra penale duhet të jetë mesatarja e këtij dënimi dhe marr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese pastaj gjykata lëviz në diskrecionin e saj për të arritur deri tek një dënim meritore dhe i drejtë. Gjykata konsideron se në rastin konkret në bindjen e kësaj gjykate kanë mbizotëruar rrethanat lehtësuese, andaj edhe gjykata lëvizi drejt minimumit të dënimit.

Gjykata vlerëson se zbatimi i udhëzuesit të lartcekur në matjen e dënimit është i domosdoshëm, për të shqiptuar një sanksion të drejtë penal, e mbi të gjitha për të krijuar siguri juridike tek qytetarët, si dhe idenë e qartë se si vihet në mënyrë të drejtë deri tek dënimi i merituar.

Marr parasysh faktin se kjo gjykatë e ka gjetur fajtor të akuzuarin B.B. duke tejkalluar kornizat e mbrojtjes e nevojshme, kjo gjykatë ka analizuar edhe nenin 12 paragrafi 4 të KPRK-së, ku është specifikuar si vijon: *Kryesi i cili i tejkallon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryesi tejkallon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi.*

Kjo gjykatë konstaton se i akuzuari ka vepruar nga frika, megjithatë duke marr për bazë rrethanat faktike në të cilat i njëjti ka vepruar, respektivisht pozitën e viktimës, kjo gjykatë ka marr për

bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ka shqiptuar minimumin e dënimit, por ka konsideruar se në rastin konkret rrethanat faktike të rastit nuk qojnë në atë intezitet që ndaj të njëjtit të shkohet nën-minimumin e dënimit e aç më pak në lirim nga dënimi dhe se në bindjen e kësaj gjykate me çdo dënim tjetër nuk do të arrihej qëllimi i dënimit.

Kjo gjykatë edhe njëherë rithekson faktin se për tej të gjitha rrethanave lehtësuese që kjo gjykatë i ka aplikuar me rastin e matjes së dënimit, marr për brazë rrethinat faktike të rastit sanksioni penal është në përputhje me kornizat ligjore.

Sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, kjo gjykatë duke marr për bazë edhe praktikën gjyqësore e po ashtu edhe rrethanat lehtësuese e renduese të elaboruar sipër përkitazi me këtë veprë penale, lëvizi drejt minimumit të dënimit, megjithatë duke marr parasysh faktin se pikërisht nga posedimi i armëve pa autorizim në kontest të përgjithshëm në shoqërinë tonë po vijnë deri te këto raste, e marr për bazë faktin se në rastin konkret i akuzuari e ka poseduar pa autorizim armën, ka kryer veprimtari të kundërligjshme e me ç' rast i akuzuari ka goditur dy persona, kjo gjykatë edhe pse ka lëvizur drejt minimumit të dënimit ka konsideruar se dënimi me burgim edhe për këtë veprë penale është i domosdoshëm.

Gjykata ka bindje se me këtë dënim, respektivisht me dënimin unik të përcaktuar si në dispozitivin e aktgjykimit, kryesi i veprës penale, në rastin konkret i akuzuari B.B. B.B., do ta kuptoj rëndësinë e veprave penale të cilat i ka kryer në ditën kritike dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryej veprë penale, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së. Gjykata ka bindjen se një dënim i tillë është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë të të akuzuarit dhe se gjykata vlerëson se me dënimin e lartcekur me burgim do të arrihet qëllimi i këtij dënimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi unik i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

#### Llogaritja e kohës së kaluar nën masën e ndalimit në dënimin e shqiptuar

Neni 83 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton si vijon: “Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë”. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, gjykata ka bërë llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit për të akuzuarin B.B. , ku koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 15.02.2015 e deri me datën 08.06.2023 do të llogaritet në dënimin e lartcekur me burgim, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Gjykata ka vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 paragrafi 1 i KPRK-së. Në këtë drejtim, gjykata e obligoi të akuzuarin që konform nenit 449 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPRK-së, të paguaj shumën prej **200€ (dyqind e pesëdhjetë euro)**, në emër të paushallit gjyqësor dhe këtë gjykata e vlerësoi për shkak të vajtje ardhjeve të shumta të të akuzuarit nga qendra e paraburgimit. Po ashtu, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të

Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me shpenzimet tjera eventuale gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas përllogaritjeve të kësaj gjykate.

### Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit e përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, gjykata konform nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së i ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil, ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### Vendimi mbi konfiskimin

Neni 374 paragrafi 3 i KPRK-së, specifikon si vijon: *Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.* Mbi këtë bazë, arma e zjarrit Ceska Zbrojovka” model 75 me numër serik 1548865, si dhe pistoleta “Pjetro Bereta“ model 92 FS, kalibri 9x19 mm, me numër serik K187027 janë konfiskuar nga gjykata, siç është përcaktuar edhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Arsyetimi sa i përket aktgjykimit lirues për të akuzuarin B.B..**

Meqenëse nga determinimi i rrjedhës se ngjarës që kjo gjykatë e ka vërtetuar – konstatuar për të akuzuarin B.B. tani rrjedha e veprimeve të të akuzuarit B.B. rrjedh të jetë më e thjeshtë pasi që për aq kohë sa është vërtetuar rrjedha e ngjarjes dhe janë specifikuar edhe veprimet e të gjithë pjesëmarrësve ma automatizëm kemi ardhur edhe deri tek nxjerrja e konstatimeve te veprimeve të të akuzuarit B.B.. Megjithatë arsyetimi përkitazi me këtë pjesë të aktgjykimit do të jetë më i shkurtër për faktin se në një pjesë të madhe të këtij aktgjykimi marr parasysh rrjedhën e ngjarjes, pa – shmangshëm janë argumentuar edhe veprimet e të akuzuarit B.B., andaj kjo gjykatë do të mundohet të mos përsëriten shumë fish sqarimet e sipër shënuara.

Kjo gjykatë ri-kujton edhe njëherë kërkesën e gjykatës së Apelit në mënyrë që të nxjerrën konstatimet e sakta. Gjukata Apelit kishte kërkuar nga kjo gjykatë si vijon: *se duhet të vërtetohet fakti se a ka shtënë i pari me armë i ndjeri pasi që edhe ai kishte armë, apo i akuzuari B.B., pasi që pa sqarimin e këtyre fakteve nuk mund të vërtetohet po që se i akuzuari B.B. B.B. veperoi me qëllim që ta privoj nga jeta tani të ndjerin U.D., apo për ta mbrojtur të akuzuarin B.B., e pastaj të vërtetohet po që se i akuzuari B.B. e ndihmoi të akuzuarin B.B. të kryej veprën penale apo nuk kreu fare vepër penale.*

Gjukata e Apelit po ashtu kishte ngritur çështjen e armëve të përdorura si dhe dëmtimeve dhe pozitës që ka pasur i ndjeri.

Siç është specifikuar më sipër nga provat e adminustrauro, pas dëgjimit të sërishem të ekspertit Ilir Kukaj është ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk janë përdorur tri, por vetëm dy armë dhe atë arma e tani të ndjerit U. i cili ka shtënë nga brenda-jashtë jaknes se tij dhe arma e të akuzuarit B.B. me të cilën i njeiti e ka privuar nga jeta tani të ndjerin. Tutje edhe njëhere ritheksojm faktin se deri tek pozita e krysur e të ndjerit ka ardhur për shkak se pasi që i ndjeri ka



gjuajtur me armë zjari në drejtim të të akuzuarit B.B., i akzuar ia ka kapur armen dhe kanë qenë duke rënë për toke dhe se i njejtë nuk ka asnjë lëndim para se të privohej nga jeta dhe se gjitha lëndimet sipërfaqësore janë nga shkaktuar nga predhat, ndërsa lëndimet në fytyrë nga ramja e tij në tokë pasi që e kanë goditur plumbat, kosntatim ky nga eksperti mjeko ligjor Dr.Arsim Gerxhaliu te cilit gjykata ia ka falur ne teresi besimin.

Nga dëgjimi i gjithë dëshmitarve, administrimit te provave materiale, deklarimeve të me hershme te te akuzuarve, analizimit edhe njere të ri-konstruimeve të vendit të ngjarjes siç është specifikuar edhe më lartë, gjykata konform dispozitave të nenit 360 të KPPRK-së ka arritur të konkludoj këtë rrjedhë të ngjarjes:

Fillimisht konstatohet se tani i ndjeri Urim kishte filluar të pinte pije alkoolike nga mëngjesi me dëshmitarin E.Sh. për shkak të lindjes së vajzës së tij, ndeja kishte filluar në qytetin e Prizrenit. Tutje i ndjeri U.bashkë me te lartcekurin E. kishin vazhduar ndejën e tyre në një kafe në Lagjen e Muhaxherëve ku kishin vazhduar me disa miq të tjerë të U. duke vazhduar te pinin pije alkoolike e të festonin.

Prej aty, kishin vendosur që ndeja e tyre të vazhdon në Restorant “Agoni” në fshatin Banull të Lipjanit. Në këtë restorant i ndjeri kishte shkuar me E.Q., S.A., e E.SH. e edhe persona të tjerë të cilët ishin larguar prej aty, para se të ndodhte incidenti. Vlen të theksohet një fakt shumë me rëndësi se i ndjeri U.D. me shokët e tije kanë qenë edhe here te tjera ne ketë Restorant, kanë qenë mysafir të mirëpritur pasi që siç ka shpjeguar dëshmitari E.Q. kanë pasur raporte të mira me pronarin e lokalit tani të akuzuarin B.B. i cili herëve të tjera kur ka pasur më pak mysafir ka qëndruar me ta në tavolinë madje i ka qerasë edhe me pije që është indikacion i qartë për gjykatën se mes tyre nuk ka pasur asgjë të keqe. Tutje nga dëgjimi i çdo dëshmitari, rezulton se të dëmtuarit dhe viktimat në vazhdimësi kanë thyer gota dhe shishe e ku për këtë shkak pronari i lokalit tani i akuzuari B.B. ka shkuar disa here për të kërkuar nga ta që të qetësohen. Se sa të dehur kanë qenë tani të dëmtuarit vërtetohet edhe nga vet deklaratat e E.Q., S.A. e E. Sh, te cilat madje as nuk e kujtojnë rrjedhën e ngjarjes për shkak të nivelit të tyre të dehjes.

Në këto momente dikush nga këta persona në tavolinë ka ecur për rreth tavolinave të tjera në këmbë duke iu parë edhe arma dhe kur e ka parë këtë këngëtarja-dëshmitarja Xhemile është shqetësuar duke konsideruar se ia kanë drejtuar armën dhe duke thënë a e patë se ke tu me vra dhe në ato momente e ka lënë muzikën dhe ka ikur në dhomën për këngëtarë dhe nga frika është alivanosur. Në këto momente te gjithë në lokal e kanë vërejtur se diqka nuk është në rregull dhe se duke parë faktin se situata në atë tavolinë vetëm po eskalon, i akuzuari B.B. si pronar i lokalit ka shkuar perseri tek tavolina dhe ka kerkuar nga tani i ndjeri Urim që ta bëjnë pagesën dhe ta lirojnë lokalin. Fakti se i akuzuari B.B. nuk ka dashtur as edhe një problem ta ketë me të dëmtuarin vëretohet nga vet dëshmia e dëshmitarit E.Q. i cili i ka thënë të akuzuarit B.B. se a ka nodnjë problem dhe se i akuzuari i eshte pergjgjur se asnje problem nuk eshte vetem pagueni faturen dhe lirojeni lokalin.

Në ato momente E.Q. dhe i ndjeri U.D. kan filluar te dalin jashtë.

As edhe njëri nga dëshmitarët nuk ka parë ndonjë konflikt mes ndonjerit nga të akuzuarit dhe tani të ndjerit, një fakt të tillë nuk e thot as vet i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit E.Q.

Tutje dëshmitari H. ka shpjeguar se e ka parë të ndjerin që kishte te futur doren ne xhepin e jaknes dhe verehej se e kishte armën në dorë gjë që vërtetohet edhe nga provat materiale, respektivisht nga vendi ku tani i ndjeri ka shkrepur me armën e tij, e që pastaj është në përputje të plotë edhe me deklarinimin e të akuzuarit B.B.. Tutje i akuzuari B.B. nuk ka dalur fillimisht jashtë lokalit me të ndjerin por ka qëndruar brenda, por ka qenë i ndjeri qe është ndalur tek sokaki (tek dera e lokalit) dhe e ka ftuar të akuzuarin B.B. të dalë jashtë, ndërsa i akuzuari fillimisht kishte refuzuar, gjë që vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit A.S.dhe dëshmitares K. dhe me të dalë jashtë lokalit i akuzuri B.B., i ndjeri U. nga xhepi i mbrendhsmes i jaknes shkrep me armen e tij

ne drejtim te te akuzuarit B.B. dhe i njeji kapet per arme me të ndjerin U. ku janë duke rënë për toke dhe menjëhere i akuzuari B.B. shtën rafal me armen e tij ne drejtim te tani te ndjerit U. e ku me këtë rast perveç se i U.D. vdes menjehere, njëri nga plumbat e godit edhe te demtuarin A. S. i cili ishte duke zbritur shkallve, ndersa i akuzuari B.B. godet me mjet te forte te demtuarin E. ne koke dhe pastaj merr nje stupc bejsbolli qe ishte mrapa shankut dhe e godet edhe te demtuarin S. A. kur ai ishte duke dalur nga lokali.

Se ngjarja ka ndodhur brenda pak sekondave vertetohet fare lete nga ri-konstruimi i vendit te ngjarjes duke i dhene rendesi te posaçme deklarimit te tani demtuarit A.S. i cili ka sqaruar se prej momentit kur e ka parë të ndjerin U. tek dera duke e thire te akuzuarin B.B. qe te dalë jashtë dhe deri tek shkallët ku ka zbritur i demtuari A. ku e ka rrokur plumbi eshte nje periudhe kohore rreth 5-7 sekonda dhe e gjithë ngjarja ka ndodhur ne keto momente, ku nje fakt te tille e specifikon edhe deshmitari E. i cili ka qene duke dalur jasht bashke me te ndjerin dhe vetem i ka degjuar te shtenat dhe ka ikur. Ne keto rethana per gjykatën eshte mese e qarte fakti se ka qene i ndjeri qe ka shtene pa pritmas ne drejtim te akuzuarit B.B. dhe pastaj i akuzuari B.B. e ka privuar te njejtin nga jeta.

Marr paraysh rjedhen e ngjarjes qe kjo gjykatë e ka vërtetuar permes dëshmive të dëshmitarëve, fillimisht rezulton se i ndjeri por edhe të demtuarit kanë pasur raporte shumë të mira mes vete e ku një fakt i tillë është sqaruar më gjërësisht per gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi e po ashtu te njejtit nuk kanë pasur problem as pasi që i akuzuari B.B. ka kerkuar nga ta te dalin nga lokali. Asnjeri nga dëshmitaret nuk ka parë ndonje perleshje fizike siç pretendon prokuroria, ndërsa nga dëshmitë e dëshmitarëve që kjo gjykatë i ka sqaruar më heret, respektvisht nga deklarimi i A.S., por edhe i dëshmitarës K. rezulton se madje i akuzuari B.B. as nuk ka dashur të dalë nga lokali me tani të ndjerin e lereme të këtë qëllim të perleshet apo ta privoj nga jeta të njejtin, por ka qenë vet i ndjeri që ka kerkuar nga ai që të dalë jashtë per deri sa ka qenë duke mbajtur dorën në armë përbrenda jaknes së tij gjë që është vërtetuar nga deklarimi i dëshmitarit H. Tutje aktakuza e ngarkon të akuzarin B.B. se ka mbajtur edhe armen pa leje, ndërsa siç është specifikuar më sipër për gjatë arsyetimit të këtij aktgjyrimi, nga provat e adminustrara rezulton të jenë përdorur vetëm dy armë. Tutje po që se i akuzuari B.B. të kishte armë me vete i njejtin në çdo rast do të përdorte armen e tij të zjarrit qoftë ndaj të ndjerit U. (për ta privuar nga jeta po që se ai do të ishte qëllimi siç pretendon prokuroria) qoftë me armën e tij do të vetëmbrohej nga i ndjeri Urim dhe se i njejtin po të kishte armë nuk do ti duhej pastaj të merte një stupc bejsbolli nga frika, por çdo veprim tjetër do ta kryente me armën e tij në dorë, andaj duke mos pasur dëshmitarë okular që e kanë parë të akuzuarin me armë në dorë, përveç dëshmitarit E. i cili ka qenë i frikësuar por edhe i dehur që thot se i akuzuari e ka goditur me armë, por që nuk determinohet se po që se i njejtin ka pasur armë apo nuk ka pasur apo ajo ka qenë arma e të ndjerit. Nga provat e administruara ka rezultuar se në vendin e ngjarjes janë përdorur dhe gjetur dy armë e një fakt ndryshe nuk argumentohet as nga ndonjë dëshmi tjetër, e po ashtu për deri sa i akuzuari B.B. ka kapur pastaj një stupc bejsbolli në dorë, kjo gjykatë nënkupton se ai nuk ka poseduar armë e po ashtu po që se do ta fshehte ndonjë armë eventuale i njejtin do te fshehte edhe provat tjera, respektvisht stupcin e bejsbollit por per te njejtin e ka pranuar qe e ka psoeduar por edhe qe e ka përdorur, andaj në këto rethana në mungesë të provave dhe arguementeve tjera gjykata ka nxjerrë përfundimin se i akuzuari B.B. nuk ka kryer vepër penale.

Nga provat e administruara, me as edhe një provë të vetme nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari B.B. ka kryer veprën penale të vrasjes në bashkë kryerje apo të ndihmës në vrasje e as veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Një fakt të tillë gjykata nuk ka mundur ta vërtetoj nga as edhe një dëshmitarë i vetëm e aç më pak të bëjë lidhshmëri mes provave ashtu siç e përcakton neni 360 i KPPRK-së, andaj në mungesë të provave të ofruara nga prokurori i shtetit për të

argumentuar përshkrimin faktik si në dispozitiviet e aktakuzës përkitazi me të akuzuarin B.B., gjykata konform nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPPRK-së, të njëjtin e liroji nga të gjitha pikat e akuzës.

### Konstatimi i gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si: Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – A.D., Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – E.Q., Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – A.S., Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit – S.A., Dëshmia e dëshmitarit – S.S. S.S., Dëshmia e dëshmitarit – V.S., Dëshmia e dëshmitarit – K.G., dëshmia e dëshmitarit – E.K., Dëshmia e dëshmitarit – E.Sh. Dëshmia e dëshmitares – Xh.V. Dëshmia e dëshmitarit – F.J., Dëshmia e dëshmitarit – Sh.R., Dëshmia e dëshmitares K.F., dëshmia e dëshmitarit H.B., Deklarimi i ekspertit – Ilir Kukaj, Deklarimi i ekspertit – A.G., Deklarimi i ekspertit – Milazim Tahirukaj, Raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes me zingjirin e ruajtjes se dëshmimeve me skic dhe foto dokumentacion i datës 14.02.2015, Raporti i ekspertizës balistike i datës 15.05.2015, Raporti i autopsisë për te ndjerin U.D. me numër MA 15-042, Ekspertiza mjekoligjore lidhur me natyrën e lëndimeve për te dëmtuarit A.S., E.Q. dhe S.A. Raporti i rikonstruimit të vendit te ngjarjes se bashku me CD qe janë ber për gjate rikonstruimit te vendit te ngjarjes, është fjala për dy ri-konsumime te vendit te ngjarjes e po ashtu duke analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, vlerësimi të tyre veç e veç si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, ashtu siç e përcakton neni 360 paragrafi 2 i KPPRK-së, gjykata ka nxjerrë përfundimin se nuk ka prova dhe lidhshmëri mes tyre që nxjerrin konkludimet se i akuzuari B.B. ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë me aktakuzës, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, respektivisht nuk është provuar se në bashkëkryerje, me dashje e kanë privuar nga jeta tani të ndjerin U.D. dhe kanë rrezikuar jetën e të tjerëve, në atë mënyrë që me datën 14 shkurt 2015, rreth orës 02.00, në restorantin "Agoni", në fshatin Banullë, komuna e Lipjanit, pas një mosmarrëveshjeje mes tyre dhe tani të ndjerit U. i cili kishte festuar bashkë me shokë, në atë lokal ku edhe kishin konsumuar alkool, me të dalë nga dera e lokalit , të njëjtit fillimisht fjalosen e pastaj i sulmojnë tani të ndjerin U dhe të dëmtuarin E.Q. dhe S.A. me mjete të forta dhe kondak të revoles ku tani i ndjeri e përdor armën e tij për ta evituar sulmin mirëpo i akuzuari B.B. e kap për dore, ndërsa i akuzuari B.B. me revolen e tij të tipit "Bereta", model 75, e kalibrit 9mm., me nr. serik 154865, në afërsi rreth një metër, shtinë në drejtim të tani të ndjerit katër herë në pjesë vitale të trupit me ç' rast nga plagët e marra tani i ndjeri vdes në vendin e ngjarjes, ndërkaq me këtë rast goditet edhe i dëmtuari A.B. i i cili pëson lëndime të rënda trupore , ku pas kësaj të pandehurit ikin nga vendi i ngjarjes, e po ashtu nuk është provuar se i njëjti ditën kritike ka pasur në posedim armën e tipit të pa njohur.

### Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Pasi që i akuzuari B.B. u lirua nga akuza, i njëjti është liruar edhe nga shpenzimet e procedurës dhe se ky vendim është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së

### Kërkesa pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit e përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi gjykata, konform nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së i ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil, ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

*Arsyetimi për veprimet e te akuzuarit B.B. në drejtim të E.Q. dhe S.A.*

Nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ka rezultuar edhe fakti se i dëmtuari E.Q. dhe i dëmtuari S.A. kanë pësuar lëndime të lehta trupore. Tutje nuk është kontestues as fakti se këto lëndime të lartcekurve ua ka shkaktuar tani i akuzuari B.B..

Gjykata e Apelit në vendimet e saja lidhur me faktin kur gjykata e shkallës së parë ishte lëshuar në gjendjen faktike për dëmtimet e të lartcekurve kishte specifikuar se prokuroria asnjëherë nuk e ka akuzuar askënd për këto veprime.

Duke analizuar aktakuzën e prokurorit të shtetit, rezulton se prokuroria asnjëherë asnjërin nga të akuzuarit e as të dy bashkë nuk i ka akuzuar për veprime në drejtim të të dëmtuarve E.Q. e S.A., por të njëjtit vetëm i ka përmendur në përshkrimin faktik ku të akuzuarit B.B. B.B. dhe B.B. i ka akuzuar për veprën penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje.

Prokuroria e shtetit do të duhej ta dinte se veprimet ndaj të dëmtuarve E. Q. dhe S.A. përbejnë vepër të veçantë penale me cilësim të veçantë juridik dhe nuk mund të inkorporoheshin në veprën penale Vrasje e rëndë pasi që veprimet e të akuzuarit B.B. në drejtim të E.Q. dhe S.A. ishin veprime të veçanta që përbëjnë vepër penale të veçantë dhe se veprimet të akuzuarve ndaj U.D.t siç i pretendonte prokuroria, nuk konsumojnë veprimet ndaj të dëmtuarve E.Q. dhe S.A.

Në bindjen e kësaj gjykate, po që se gjykata do të shpallte fajtor të akuzuarin B.B. për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor, për lëndimet ndaj E. Q. dhe S.A., atëherë nuk do të kishim të bënim me ri cilësim të veprës penale nga vepra penale e vrasjes në veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, por me shpalljen fajtor për vepër penale për të cilën i akuzuari asnjëherë nuk ishte akuzuar e që rrjedhimisht do të kishim tejkalim të akuzës.

Kjo gjykatë është e vetëdijshme se nuk ka ndonjë praktikë të unifikuar gjyqësore përkitazi me këtë çështje, por kjo gjykatë konstaton edhe një fakt se çdo veprim eventual i të akuzuarit B.B. në drejtim të veprës penale lëndimi i lehtë trupor tani është parashkruar, andaj kjo gjykatë nuk është lëshuar fare mbi këto veprime, veç se ka trajtuar objektin e akuzës dhe për veprat penale për të cilat i akuzuari B.B. është akuzuar, gjykata nuk e gjeti fajtor.

*Pretendimet e palëve në procedure qe gjykata nuk i morri për bazë*

Krejt në fund të këtij aktgjykimi, gjykata do ti trajtoj pretendimet e palëve që kjo gjykatë nuk i morri për bazë, respektivisht nuk ua fali besimin me rastin e marrjes se këtij aktgjykimi.

Gjykata në vijim do jap përgjigje të shkurta lidhur me pretendimet e prokurorit të shtetit si dhe Avokatit Berat Tmava, ndërsa sa i përket pretendimeve të Avokatit Skender Musa nuk do të argumentohen në këtë pjesë të aktgjykimit pasi që i mbrojturi i tij është liruar nga gjitha pikat e akuzës për arsyet e lartshënuara.

Prokurorja e shtetit ka pretenduar – argumentuar se nga provat e administruara, nga deklarimi i dëshmitarëve është vërtetuar se të akuzuarit fillimisht kanë filluar përleshje me të ndjerin e pastaj në mënyrë të organizuar e kanë nxjerrë jashtë me qëllim që ta privojnë nga jeta të ndjerin, ku i akuzuari B.B. ia ka mbajtur duart të ndjerit, ndërsa i akuzuari B.B. e ka privuar nga jeta. Po ashtu

shton se ata ishin organizuar me stupca dhe armë ku kishin goditur edhe shokët e të ndjerit me çka prokuroria e sheh si vrasje të organizuar. Tutje prokurorja e shtetit argumenton edhe shenjat në trup të të ndjerit që sipas te njëjtës shihet se ka pasur edhe goditje ne fytyre duke aluduar se i ndjeri edhe është goditur dhe pastaj është privuar nga jeta e po ashtu prokuroria konsideron se i ndjeri ka shtënë me armë për tu mbrojtur.

Fillimisht kjo gjykatë nuk ka arritur ta kuptoj as ku e ka argumentuar prokuroria e shtetit se nga provat e administruara rezulton se kishte përleshje mes të akuzuarave dhe të ndjerit. Një fakt të tillë nuk e ka thënë as edhe një dëshmitar i vetëm e madje as edhe të dëmtuarit tjerë që ishin me tani të ndjerin, andaj një pretendim i tillë nuk është thënë – pretenduar nga asnjë dëshmitar. Tutje prokuroria e shtetit aludon se i akuzuari B.B. ia kishte kapur duart tani të ndjerit. Një fakt i tillë në bindjen e kësaj gjykate është tërësisht i papranueshme dhe krijon ide imagjinare, sepse as edhe një provë nuk qon në idenë që i akuzuari B.B. ia ka kapur duart te ndjerit me qëllim që i akuzuari B.B. ta privoj nga jeta. Provat e propozuara nga vet prokuroria qojnë në kahjen e kundërt, është vet dëshmitari A.S. i propozuar nga vet prokuroria ka specifikuar se nuk ka pasur asnjë përleshje fizike a madje tek dera e daljes ka qenë i ndjeri Urim që ka insistuar që i akuzuari B.B. të dalë jashtë lokalit e ku i akuzuari kishte refuzuar por pas insistimit te te ndjerit kishte dalur jashtë dhe menjëherë kishte kersitur arma. Andaj një pretendim i tillë i prokurorisë është i pa mbështetshëm ne provat e propozuara nga vet prokuroria. Tutje prokuroria në njërën anë akuzon të akuzuarin B.B. se ia ka kapur duart të ndjerit për të ja mundësuar te akuzuarit B.B. qe ta privoj te njëjtin nga jeta e në anën tjetër specifikon se i akuzuari B.B. kishte edhe armë në dorë, sepse e akuzon edhe për armëmbajtje pa leje e në anën tjetër specifikon se ai kishte stupc bejsbollit në duar. Nga një argument i tillë shihet qartë se mbi çfarë narrative prokuroria e ka ndërtuar rastin. Tutje nuk janë të vërteta pretendimet e prokurorisë se të dëmtuarit tjerë janë sulmuar e pastaj është privuar nga jeta tani i ndjeri, sepse vet te dëmtuarit E.Q. e S.A. kanë specifikuar se ata janë sulmuar pasi që janë dëgjuar krismat e armës e që është argument i qartë se kjo ka ndodhur nga frika pasi që i ndjeri është privuar nga jeta.

Prokuroria e shtetit argumenton se i akuzuari është sulmuar paraprakisht dhe kjo vërtetohet nga ekspertiza mjeko ligjore por edhe nga fotografitë qe shihet se ka shenja te mëdha në fytyrë e që prokuroria aludon ti jenë shkaktuar nga të akuzuarit.

Gjykata rikujton faktin se një konstatim të tillë mbi lëndimet është i thirrur ta japë eksperti mjeko ligjor e që në rastin konkret Dr.Arsim Gërxhaliu ka qenë shumë konkret dhe i hapur në shqyrtimin gjyqësor duke argumentuar në mënyrë profesionale se dëmtimet trupore si gërvishtjet sipërfaqësore në trupin e të ndjerit janë shkaktuar nga plagët që i njëjti ka marrë nga predhat por jo nga ndonjë kontakt fizik tjetër. Dr.Arsim Gërxhaliu ka qenë shumë i qartë edhe kur ka shpjeguar faktin se dëmtimet në fytyrën e të ndjerit janë dëmtime që atij i janë shkaktuar pasi që ka rënë në dysheme pas vrasjes se tij, por jo nga ndonjë veprim tjetër, andaj ky argument i prokurorisë është i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetshëm në sqarimet e Dr.Arsim Gërxhaliut i cili i ka përjashtuar këto mundësi, e që shihet qartë se përshkrimin faktik i prokurorisë dhe argumentet e tyre nuk gjejnë mbështetje në provat e amnistuara.

Prokuroria po ashtu ka argumentuar se pozita e krysur e të ndjerit ka ardhur nga frika, pa marr për bazë fare provat e tjera nga të cilat rezulton se pozita e tij e krysur ka ardhur pasi që ai ka shkrepur me armë zjarri ku i akuzuari B.B. është kapur për armën e tij siç është argumentuar më sipër.

Prokuroria ka argumentuar se i ndjeri ka shtënë me armën e tij për tu vetëmbrojtur. Fillimisht kjo gjykatë ri-kujton edhe njëherë se nga provat e administruara rezulton se ka qenë vet i ndjeri që ka insistuar që i akuzuari B.B. të dalë jashtë, në anën tjetër nga dëshmia e dëshmitarit H. rezulton se duke dalë jashtë i ndjeri kishte futur dorën në xhepin e tij të jaknës ku mbante në dorë armën, ndërsa asnjë, as edhe një dëshmitar i vetëm nuk thotë se kishte ndonjë fërkim mes të

akuzuarve dhe të ndjerit duke dalë jashtë. Tutje vet dëshmitari E. dhe A. që kanë qenë tek dera kanë specifikuar se nuk kanë parë asnjë përlëshje por në moment ka krisur arma që lidhet me faktin se sa ka dalë i akuzuari B.B. nga dera e lokalit aty ka gjuajtur me armë tani i ndjeri, andaj nga asnjë provë nuk mund të aludohet se i ndjeri është sulmuar e pastaj ka shtënë me armë, ndërsa në anën tjetër thuhet se i akuzuari B.B. ia ka mbajtur duart që i akuzuari B.B. ta privoj nga jeta që ideja dhe kronologjia e prokurorisë ka shpëputje në ndërtimin e argumenteve dhe si siç është specifikuar edhe më sipër sikurse i akuzuari B.B. të kishte shtënë në të ndjerin i pari në asnjë mënyrë i njëjti nuk kishte mundur të reagoj marr parasysh distancën dhe shpejtësinë e plumbave.

Mbi argumentet e sipërshënuara, prokuroria nuk jep arsye të qarta mbi cilën provë cilin argument e mbështet për të nxjerrë konstatime të tilla, por vetëm i përgjithëson provat e amnistuara duke thënë se nga provat e administruara është vërtetuar teza e akuzës, andaj në këto rrethana e në mungesë të provave konkrete mbi faktet vendimtare, gjykata nuk i akceptoj pretendimet e prokurorit të shtetit.

Gjykata aktgjykimin e saj e mbështet në bazë të nenin 360 të KPPRK-së, në provat e administruara duke i ndërlidhur provat njëra me tjetrën për të nxjerrë përfundimet, ndërsa as edhe një dëshmi qoftë e vetme nuk nxjerr përfundimet e pretenduara ne përshkrimin faktik të aktakuzës.

Gjykata tutje nuk ua fali besimin as argumenteve të mbrojtësit të akuzuarit B.B. B.B. Avokatit Berat Tmava i cili ka specifikuar se i mbrojturi i tij ka vepruar në mbrojtje të nevojshme dhe se në rastin konkret kur i akuzuari vepron nën kornizat e mbrojtës se nevojshme përjashtohet kundërligjshmëria e që rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me vepër penale.

Kjo gjykatë edhe një here ri-thekson faktin se gjykata tani ka vërtetuar faktin se i akuzuari ka shtënë me armë në tani të ndjerin për të zpraps sulmin e të ndjerit, mirëpo po që se një i akuzuar ka vepruar në korniza të mbrojtës se nevojshme apo i ka tejkalluar ato do duhet argumentuar nga rrethanat faktike në çdo rast konkret.

Në bindjen e kësaj gjykate siç është argumentuar edhe më sipër, në rastin konkret, kjo gjykatë ka nxjerre konstatimet se i ndjeri U.D. ka shtënë me armën e tij nga xhepi i jaknes nga brenda jashtë, ne drejtim të tani të akuzuarit B.B. dhe se i akuzuari B.B. është kapur për arme me të ndjerin U. dhe kanë filluar të rrëzohen bashkërisht për toke. Është i vërtetë fakti se menjëherë pas pak sekondave i akuzuari B.B. ka filluar të gjuaj me armë në drejtim të tani të ndjerit nga frika se i njëjti po e privon nga jeta tani të akuzuarin B.B., mirëpo kjo gjykatë vlerëson se i ndjeri U.D. ka arritur vetëm një here të gjuaj me armë dhe pastaj i akuzuari B. ka arritur që të kapet për armën e tij duke rënë për toke dhe pozita nga prapa anash ku ka qenë i akuzuari B.B., i njëjti pasi i ka parë të dy pra edhe B.B.in edhe tani të ndjerin U. duke rënë përtokë ka mundur që sulmin ta zbrapsë qoftë në mënyrë tjetër qoftë duke shtënë vetëm një here apo dy here në të ndjerin për ta zpraps sulmin por jo në mënyrën si ka vepruar ai ku nga prapa dhe pasi që sulmi është ndalur së vepruari ka shtënë në të njëjtin, andaj gjykata përfundimisht vlerësoi se i akuzuari B.B. ka filluar të veproj në mbrojtje të nevojshme por marr për bazë pushimin e sulmit nga i ndjeri si dhe pozitën e viktimës me të akuzuarin B.B., i njëjti ka tejkalluar kornizat e mbrojtës se nevojshme duke privuar të ndjerin nga jeta dhe se në vlerësimin e gjykatës i njëjti ka gjuajtur me armë edhe pasi që ka pushuar rreziku.

Po ashtu siç është theksuar edhe më sipër, kjo gjykatë ka dhënë shembullin e praktikës gjyqësore të nxjerrë nga Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës në një rast të ngjashëm ku është

specifikuar se: *I akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë me tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, ngase është konstatuar që, duke e zbrapsur sulmin e atëçastshëm, me shkrepet e parë nga revolja, i dëmtuari është rrëzuar përtokë, dhe dy shkrepet e tjera të mëpastajme në trupin e të dëmtuarit janë cilësuar si tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme, ngase dy shkrepet pas rrëzuarjes së të dëmtuarit janë bërë pasi është përballuar sulmi. (praktika gjyqësore).*

Andaj mbi këto argumente, marr parasysh faktin se sulmi i të ndjerit kishte pushuar së vepruari dhe marr për bazë pozitën e të akzuarit B.B. me të dëmtuarit, gjykata nuk e akceptoj pretendimin e mbrojtës e i akuzuari ka vepruar në tërësi në kuadër të mbrojtës së nevojshme me çka nuk do të kishim vepër penale, por marr për bazë faktet e lartcekura, në bindjen e gjykatës, i akuzuari ka tejkaluar kornizat e mbrojtjes së nevojshme, andaj edhe te njëjtin e gjeti fajtor dhe e gjykoji si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 360, 363 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJKYATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.233/21 datë 07.08.2023**

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Ngadhjim Arrni**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.